



International  
Labour  
Organization

# ► Vlerësimi i Masave të Sigurimeve Shoqërore në Përgjigje të COVID-19

Mësime nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore gjatë fazës së parë të pandemisë





## ▶ **Vlerësimi i Masave të Sigurimeve Shoqërore në Përgjigje të COVID-19**

Mësime nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore gjatë fazës së parë të pandemisë

Copyright © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2021  
Botimi i parë 2021

Botimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës gëzojnë të drejtën e autorit sipas Protokollit 2 të Konventës Universale të së Drejtës së Autorit. Megjithatë, pjesë të shkurtra nga to mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi. Për të drejtën e riprodhimit ose përkthimit, aplikimi duhet të bëhet tek Byroja e Botimeve të ILO-s (Të Drejtat dhe Lejet), International Labour Office, CH -1211 Geneva 22, Switzerland, ose nëpërmjet postës elektronike: [rights@ilo.org](mailto:rights@ilo.org). Zyra Ndërkombëtare e Punës mirëpret aplikime të tilla.

Bibliotekat, institucionet dhe përdoruesit e tjerë të regjistruar në organizata që kanë të drejta riprodhimi, mund të bëjnë fotokopje në pajtim me licencën lëshuar atyre për këtë qëllim. Vizitoni [www.ifrro.org](http://www.ifrro.org) për të gjetur organizatën me të drejta riprodhimi në vendin tuaj.

---

ILO.2021. *Vlerësimi i Masave të Sigurimeve Shoqërore në Përgjigje të Covid-19: Mësime nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore gjatë fazës së parë të pandemisë*. Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë në ILO dhe Zyra Qëndrore për Evropën Lindore dhe Qëndrore (DWT/CO-Budapest). - Budapest: ILO, 2021

ISBN 9789220349656 (print)

ISBN 9789220349663 (web PDF)

Also available in English:

*Assessment of the Social Security Responses to Covid-19: Lessons from the Western Balkans and Eastern Europe during the first stage of pandemic.*

ISBN 9789220343494 (Web PDF)

Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë në ILO dhe Zyra Qëndrore për Evropën Lindore dhe Qëndrore

---

Dizenjot në Botimet e ILO-s, të cilat janë në përputhje me praktikat e Kombeve të Bashkuara, dhe paraqitja e materialit aty nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinionit të cfarëdolloj nga Zyra Ndërkombëtare e Punës në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, rajoni a territori ose të autoriteteve të tyre, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tyre.

Përgjegjësia për opinionet e shprehura në artikujt, studimet dhe kontributet e nënshkruara është vetëm e autoreve, dhe botimi nuk përbën miratimin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës për opinionet e shprehura aty.

Referenca për emra kompanish, produktesh dhe procesesh tregtare nuk nënkupton njohjen e tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, dhe çdo mospërmendje e ndonjë kompanie të veçantë, produkti ose procesi tregtar, nuk është shenjë e mosaprovimit.

Për më shumë informacione për publikimet e ILO apo ato dixhitale, vizitoni faqen tonë në internet: [www.ilo.org/publns](http://www.ilo.org/publns)

---

Foto e Kopertinës © AFP/Europress

## ► Tabela e Lëndës

---

Lista e tabelave, figurave dhe kutive	v
Monedhat	vi
► <b>Parathënie</b>	<b>vii</b>
► <b>Përmbledhje</b>	<b>ix</b>
► <b>1. Situata në ekonomi dhe në tregun e punës</b>	<b>1</b>
1.1. Trendet e COVID-19	1
1.2. Ndikimet në tregun e punës	2
Humbja e orëve të punës dhe e të ardhurave të krahut të punës	2
Treguesit e tregut të punës	3
1.3. Problemet aktuale në tregun e punës dhe sfidat në lidhje me sigurimet shoqërore	8
Ekonomia informale dhe puna e padeklaruar	8
Format jo standarde të punësimit dhe puna nëpërmjet platformave në internet	11
Punëtorët migrantë	12
► <b>2. Shqyrtimi i masave të sigurimeve shoqërore në përgjigje të situatës</b>	<b>13</b>
2.1. Përgjigja e politikave ndaj pandemisë COVID-19	13
Karakteristikat e recesionit të shkaktuar nga COVID-19	13
Prioritetet e masave në përgjigje të pandemisë në faza të ndryshme	14
Rolet e politikave të punësimit dhe sigurimeve shoqërore në përgjigjen e integruar ndaj krizës	14
2.2. Mbrojtja e shëndetit social	16
2.3. Masat për vazhdimësinë e biznesit dhe ruajtjen e punësimit	17
2.4. Mbështetja me të ardhura sipas pagesave afatshkurtra	20
Pagesat në rast sëmundjeje	20
Papunësia dhe pagesat përkatëse	20
Lloje të tjera të mbështetjes me të ardhura në para dhe ndihma sociale	22
Pagesa e lejes së pushimit për kujdesin ndaj fëmijëve	23
2.5. Mbështetje shtesë me të ardhura për pensionistët	24

► <b>3. Vlerësimi paraprak i masave të sigurimeve shoqërore në përgjigje të situatës</b>	<b>25</b>
3.1. Dimensioni i masave fiskale	25
3.2. Vlerësimi paraprak i ndikimit të masave në përgjigje të situatës	29
Tregu i punës dhe të ardhurat e krahut të punës	29
Të ardhurat e familjeve	30
3.3. Vlerësimi paraprak i politikave	32
Subvencionimi ose shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore	32
Subvencionimi i pagave	32
Mbështetja me të ardhura sipas përfitimeve afatshkurtra	33
Popullsia e pambrojtur në mënyrë të mjaftueshme nga përfitimet ekzistuese të sigurimeve shoqërore	33
Mbështetje shtesë me të ardhura për pensionistët	34
Mbështetja e sigurimeve shoqërore për një kthim të sigurt në punë	34
3.4. Problemet me financimin	36
► <b>4. Përfundime - drejt një sistemi gjithëpërfshirës dhe rezilient të sigurimeve shoqërore</b>	<b>39</b>
► <b>Referencat</b>	<b>41</b>
Faqet e internetit të Zyrave Kombëtare të Statistikave	41
Raportet dhe dokumentet për vendet e përmendura në raport	41
Publikime, raporte dhe baza të tjera të dhënash	43
► <b>Shtojcë. Reagimi i mbrojtjes sociale dhe vendeve të punës ndaj COVID-19</b>	<b>45</b>

## ► Lista e tabelave, figurave dhe kutive

### Tabelat

<b>Tabela 1.1.</b>	Humbjet në orë pune dhe humbjet e të ardhurave të krahut të punës sipas rajoneve, mbi baza tremujore 2020	2
<b>Tabela 1.2.</b>	Humbjet në orë pune në vendet e përzgjedhura të Ballkanit Perëndimor, tre tremujorët e parë të vitit 2020	3
<b>Tabela 1.3.</b>	Treguesit kryesorë të tregut të punës, tremujorët e dytë të vitit 2019 dhe 2020	3
<b>Tabela 2.1.</b>	Ratifikimi i Konventës Nr. 102 të ILO-s dhe instrumentet e ndërlidhura me të (janar 2021)	16
<b>Tabela 2.2.</b>	Shpenzimet shëndetësore sipas burimit të financimit, 2016–2017	17
<b>Tabela 2.3.</b>	Subvencionimi dhe shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore	18
<b>Tabela 2.4.</b>	Subvencionimi i pagave	19
<b>Tabela 2.5.</b>	Pagesat në rast sëmundjeje	20
<b>Tabela 2.6.</b>	Papunësia dhe pagesat përkatëse	21
<b>Tabela 2.7.</b>	Transfertat e parave jo kontributive	22
<b>Tabela 2.8.</b>	Mbështetja në natyrë	23
<b>Tabela 2.9.</b>	Pagesat shitesë në para për pensionistët	24
<b>Tabela 3.1.</b>	Masat fiskale në lidhje me COVID-19 gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 në vendet e zgjedhura	26
<b>Tabela 3.1.bis.</b>	Masat fiskale në lidhje me COVID-19 gjatë vitit 2020 në vendet e përzgjedhura	27
<b>Tabela 3.2.</b>	Vlera e stimulit fiskal sipas rajoneve, tre tremujorët e parë të vitit 2020	30
<b>Tabela 3.3.</b>	Ndryshimet në PBB dhe konsumimi në tremujorin e dytë të vitit 2020	30
<b>Tabela 3.4.</b>	Të ardhurat dhe shpenzimet familjare në tremujorin e dytë të vitit 2020, Ukrainë	31
<b>Tabela 3.5.</b>	Remitancat si përqindje e PBB-së, 2019	31
<b>Tabela 3.6.</b>	Reagimi i sigurimeve shoqërore dhe tregut të punës në faza të ndryshme të pandemisë	35
<b>Tabela 3.7.</b>	Parashikimi i FMN-së për treguesit kryesorë fiskalë, 2019-2025	36

### Figurat

<b>Figura 1.1.</b>	Statistikat e rasteve dhe vdekjeve të shkaktuara nga COVID-19, Mars-Dhjetor 2020	1
<b>Figura 1.2.</b>	Përqindja e punësimit informal në rradhët e popullsisë së punësuar, 2019	8
<b>Figura B1.1.</b>	Numri mujor i të papunëve të regjistruar rishtasi, 2020 (Janar = 100)	5
<b>Figura B1.2.</b>	Numri mujor i të papunëve të regjistruar, 2020 (Janar = 100)	6
<b>Figura B1.3.</b>	Numri mujor i përfituesve të pagesës së papunësisë, 2020 (Janar = 100)	7
<b>Figura B2.1.</b>	Mbulimi me sigurime shoqërore sipas statusit të tregut të punës, Shqipëri 2019	10
<b>Figura B2.2.</b>	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe moshës, Shqipëri 2019	11

**Kutitë**

<b>Kuti 1.</b>	Trendet e të papunëve të regjistruar në vendet e përzgjedhura në vitin 2020	5
<b>Kuti 2.</b>	Mbulimi me sigurime shoqërore për të vetëpunësuarit dhe punonjësit në punësim informal, Shqipëri	9

**► Monedhat**

Vendi	Monedha	Kodi	Kursi i këmbimit i datës 20.01.2021 (1 Euro)
Shqipëri	Lekë	ALL	123 ALL
Bosnjë dhe Hercegovinë	Marka e konvertueshme e Bosnjës dhe Hercegovinës	BAM	1.96 BAM
Moldavi	Leu moldav	MDL	21.0 MDL
Mali i Zi	Euro	EUR	1.00 EUR
Maqedonia e Veriut	Denari maqedonas	MKD	61.6 MKD
Serbi	Dinari serb	RSD	118 RSD
Ukrainë	Hryvnia ukrainase	UAH	34.2 UAH



# Parathënie

---

Që nga shpërthimi i saj në fillim të vitit 2020, pandemia COVID-19 është kthyer me shpejtësi në një krizë ekonomike globale të pashembullt. Kjo pandemi ka ndikuar thellësisht në botën e punës. Në përgjigje të COVID-19, shtetet e ndryshme kanë kryer ndërhyrje të menjëhershme në sistemin shëndetësor publik si dhe kanë marrë masa me karakter ekonomik për të zbutur ndikimet e pafavorshme të saj dhe për të stimuluar ekonominë. Sidoqoftë, mbyllja e përgjithshme e vendeve të punës për shkak të izolimit ka çuar në humbje të konsiderueshme të të ardhurave të krahut të punës për shkak të nivelit më të lartë të pasivitetit dhe papunësisë.

Në këtë kontekst, ILO ndërmorri kryerjen e një vlerësimi në lidhje me mënyrën e reagimit të sistemit të sigurimeve shoqërore ndaj COVID-19 në vendet e përzgjedhura në Evropën Qendrore dhe Lindore. Objektivi i këtij raporti është rishikimi në mënyrë krahasimore i masave të marra në rang kombëtar sa i takon sigurimeve shoqërore si përgjigje ndaj krizës së shkaktuar nga COVID-19, analizimi i efektivitetit të tyre dhe i pasojave afatgjata, si dhe diskutimi në lidhje me sfidat e ardhshme për përmirësimin e sistemit të sigurimeve shoqërore. Ky raport përfshin shtatë vende në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Lindore: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Moldavinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Ukrainën. Raporti analizon kryesisht përfitimet në para që synojnë popullsinë në moshë pune dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Megjithëse numri i raporteve kërkimore në lidhje me reagimin e sistemit të sigurimeve shoqërore ndaj pandemisë COVID-19 është i madh, mendojmë se vlerësimi i ndikimit të plotë të këtyre masave në aspekte të tilla si të ardhurat, punësimi, pabarazia dhe varfëria është ende i parakohshëm. Kriza e shkaktuar nga COVID-19 nuk ka përfunduar ende. Prandaj raporti aktual përqendrohet në fazën e parë të pandemisë COVID-19 nga muaji mars deri në muajin qershor 2020 bazuar në të dhënat sasiore në dispozicion, të plotësuar edhe me informacionin për politikat dhe faktet sasiore të mbledhura nga ekspertët kombëtarë. Pavarësisht lehtësimit gradual të karantinës dhe të masave izoluese, vërshimi i rasteve të infeksionit gjatë kohëve të fundit përbën një shqetësim të madh. Ne do të monitorojmë nga afër situatën në nivelet rajonale dhe globale dhe do të përditësojmë analizën tonë pas vënies në dispozicion të të dhënave dhe informacionit të mëtejshëm.

Kriza ka nxjerrë në dritë edhe njëherë nevojën që ILO dhe organet e saj trepalëshe - qeveritë, punëtorët dhe punëdhënësit - të adresojnë së bashku çështjen e COVID-19 në botën e punës përmes dialogut efektiv social dhe të rrisin koordinimin me Ministrinë e Financave në lidhje me mënyrat që duhen përdorur për të garantuar investime më të shumta dhe më të mira për mbrojtjen sociale (në përputhje me Rekomandimin e ILO-s Nr. 202 për Dyshemetë e Mbrojtjes Sociale në veçanti). Problemi kryesor ka të bëjë me gjetjen e ekulibrit dhe sekuencës së duhur të ndërhyrjeve të politikave me karakter shëndetësor, ekonomik dhe social dhe të mënyrave për rritjen e hapësirës fiskale për politikat prioritare, përtej rialokimit të shpenzimeve.

Raporti është organizuar si më poshtë. Pas një shqyrtimi të shkurtër të situatës së shkaktuar nga COVID-19 dhe të të dhënave ekonomike, ne kalojmë në shqyrtimin e sistemit të sigurimeve shoqërore dhe të masave përkatëse të zbatuara për të adresuar pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë COVID-19 gjatë periudhës së parë të izolimit në tremujorin e dytë të vitit 2020. Ky rishikim pasohet nga një vlerësim paraprak i efekteve të masave të ndërmarra për t'iu përgjigjur pandemisë COVID-19 në lidhje me tregun e punës dhe të ardhurat familjare. Raporti përmbillet me një përmbledhje të mësimave të nxjerra deri më tani dhe me një shtjellim të perspektivave të ardhshme. Shtojca përmban një përmbledhje të detajuar të masave të marra nga sistemi i sigurimeve shoqërore për t'iu përgjigjur kësaj situatë në shtatë vendet e mbuluara nga raporti.

Ky raport u përgatit nga Kenichi Hirose, Specialist i Lartë për Mbrojtjen Sociale, Zyra e ILO-s për Evropën Qendrore dhe Lindore me kontributin e shquar të Krzysztof Hagemeyer, Konsulent i ILO-s.

Raporti në fjalë u hartua duke u bazuar në kontributet e vlefshme të shumë bashkëpunëtorëve. Shprehim mirënjohjen tonë për ekspertët e mëposhtëm kombëtarë: Klea Ibrahim (Shqipëri), Nikolina Obradović (Bosnjë dhe Hercegovinë), Laura Grecu (Moldavi), Uglješa Janković (Mali i Zi), Jadranka Msić (Maqedonia e Veriut), Ivana Poljak (Serbi) dhe Natalia Poliak (Ukrainë) për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit për vendin përkatës. Falënderimet shkojnë edhe për Koordinatorët Kombëtarë të ILO-s në këto vende për ndihmën e ofruar gjatë përgatitjes së këtij raporti. Në këtë raport përfundimtar janë përfshirë edhe komentet nga Departamenti i Mbrojtjes Sociale pranë ILO-s dhe ekspertët e Zyrës së ILO-s për Evropën Qendrore dhe Lindore.

Ne besojmë se ky raport do të shërbejë si një referencë e vlefshme për hartimin e politikave efektive në përgjigje të pandemisë COVID-19 dhe për ndërtimin e një sistemi sa më adekuat, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të sigurimeve shoqërore në të ardhmen.

Shkurt 2021

Shahrashoub Razavi

Drejtor  
Departamenti i Mbrojtjes Sociale  
*Gjenevë*

Markus Pilgrim

Drejtor  
Zyra e ILO-s për Evropën Qendrore dhe Lindore  
*Budapest*

# Përmbledhje

---

## Ndikimi i pandemisë në ekonomi dhe në tregun e punës

Pandemia COVID-19 ka ndikuar thellësisht në tregun e punës, duke çuar në humbje të konsiderueshme të të ardhurave të krahut të punës. Gratë dhe punonjësit me pagë më të ulët u prekën në mënyrë disproporcionale, duke rritur kështu pabarazitë si në aspektin gjinor ashtu edhe në aspektin e të ardhurave.

Humbja e orëve të punës në Evropën Jugore në vitin 2020 u vlerësua në masën 12.3 përqind (e barasvlershme me 6 milion punonjës me kohë të plotë), që është dukshëm një shifër shumë më e lartë se mesatarja botërore dhe rajonale, ndërsa humbja në Evropën Lindore ishte 7.4 përqind (e barasvlershme me 8 milion punonjës me kohë të plotë), shifër kjo më e ulët se mesatarja botërore dhe rajonale.

Në të shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Evropën Lindore, si niveli i personave ekonomikisht aktiv ashtu dhe niveli i punësimit pësuan rënie për të dy gjinitë, ndërsa ndryshimet në normat e papunësisë ishin relativisht të vogla. Disa vende kanë vërejtur ulje të punësimit informal, dhe rritje të lehta të numrit të të punësuarve në sektorin formal. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 në shumicën e vendeve u vu re një rritje e konsiderueshme e numrit të personave të papunë të regjistruar, sepse regjistrimi në shërbimet publike të punësimit është kusht për përfitimin e pagesës së papunësisë dhe të formave të tjera të mbështetjes me të ardhura.

## Reagimi i sistemit të sigurimeve shoqërore ndaj pandemisë COVID-19: vlerësim paraprak

Për të përballuar krizën aktuale, është shumë e rëndësishme që të sigurohet qasja tek shërbimet shëndetësore, të ruhen shërbimet thelbësore, të mbrohen vendet e punës, të ofrohet ndihmesë për të siguruar vazhdimësinë e bizneseve dhe të sigurohen të ardhura për personat e prekur nga kriza gjatë gjithë kësaj periudhe të vështirë. Dalja nga kjo krizë kërkon një reagim të integruar të politikave duke përfshirë politikat që kanë të bëjnë me aspektet fiskale, monetare, me tregun e punës dhe sigurimet shoqërore.

Në rang global, qeveritë e vendeve të ndryshme kanë bërë shpenzime shtesë për masat e lidhura me COVID-19 dhe kanë akumuluar detyrime kontingjente në formën e injektimit të kapitalit, huave, si dhe garancive të ndryshme për ndërmarrjet ose të tjerët. Shkalla e ndërhyrjeve fiskale ndryshon nga njeri vend në tjetrin. Masat fiskale të shtatë vendeve në shqyrtim ishin përgjithësisht në nivele më të ulëta se masat e vendeve me të ardhura të larta në Evropën Perëndimore ose vendet e reja anëtare të BE-së në Evropën Qendrore dhe Lindore. Ata u përqendruan kryesisht tek shpenzimet shtesë direkte të synuara për ndërmarrjet dhe familjet, por Moldavia, Serbia dhe Ukraina alokuan një pjesë relativisht të madhe të shpenzimeve për sistemet e nënfinancuara të kujdesit shëndetësor. Sipas vlerësimeve të ILO-s, vlera e stimulit fiskal gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2020 ishte e barasvlershme me 23.0 përqind të orëve të humbura të punës për Evropën Jugore dhe 54.0 përqind për Evropën Lindore.

Vëzhgimet e mëposhtme në lidhje me efektivitetin e masave kryesore të ndërmarra nga të shtatë vendet sa i takon sigurimeve shoqërore dhe punësimit bazohen në rezultatet e dala nga vlerësimi paraprak i impaktit.

- **Mbrojtja e shëndetit social.** Të gjitha vendet nën shqyrtim kanë marrë masa që lehtësojnë qasjen tek shërbimet e kujdesit shëndetësor për trajtimin dhe testimin e COVID-19 për të gjithë banorët. Përveç kësaj, siç u përmend edhe më lart, disa vende e kanë alokuar një sasi relativisht të madhe të shpenzimeve të tyre për sistemet e kujdesit shëndetësor.

- ▶ **Subvencionimi i pagave.** Subvencionimi i përkohshëm i pagave, megjithëse në masën e pagës minimale për një periudhë të kufizuar kohe, ishte relativisht i suksesshëm për parandalimin e largimeve nga puna dhe kompensimin e rreth 25-50 përqind të të ardhurave të humbura të krahut të punës gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Nëse vazhdon pandemia dhe nëse situata në tregun e punës nuk do të përmirësohet, atëherë mund të lindë përsëri nevoja për të tilla subvencionime të përkohshme të pagave.
- ▶ **Subvencionimi ose shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore.** Duke pasur parasysh normat e kontributeve përgjithësisht të larta, ndikimi i masës lehtësuese për pagesën e kontributeve mund të jetë i rëndësishëm për ndërmarrjet. Megjithëse reduktimi i përkohshëm i kontributeve të sigurimeve shoqërore plotësonte nevojën e menjëhershme të ndërmarrjeve për likuiditet me qëllim vazhdimin e ushtrimit të aktivitetit të tyre si dhe për të mbajtur punonjësit, kjo masë ndikoi drejtpërdrejt në financimin e skemave të sigurimeve shoqërore.
- ▶ **Pagesat në rast sëmundjeje/ për arsye shëndetësore gjatë izolimit ose karantinës.** Përdorimi i pagesës në rast sëmundjeje për punonjësit që nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të mbylljes së biznesit ose për shkak të karantinës së detyrueshme nuk është ndjekur plotësisht nga vendet e shqyrtuara. Në të gjitha vendet, punëdhënësit janë përgjegjës për pagesën e disa prej ditëve të para të pushimit për arsye shëndetësore të punonjësit. Ndoshta, ky rregull mund të jetë edhe arsyeja përse pagesat në rast sëmundjeje u mbuluan nga subvencionet e pagave.
- ▶ **Papunësia dhe pagesat përkatëse.** Në kohë recesioni, pagesa e papunësisë luan rol jetik duke siguruar mbështetje me të ardhura për punonjësit që kanë dalë të papunë pa dëshirën e tyre. Pandemia forcoi nevojën e kahershme për të zgjeruar mbulimin me pagesën e papunësisë dhe për të rritur nivelin e përfitimit nga kjo pagesë. Të shtatë vendet nën shqyrtim kanë rritur ndjeshëm pagesat e papunësisë dhe kanë mbuluar kategori më të shumta të punonjësve.
- ▶ Gjatë krizës aktuale është vënë re një incidencë e lartë e papunësisë së pjesshme si rezultat i reduktimit të orëve të punës ose pushimeve të pavullnetshme të papaguara. Sidoqoftë, pagesat e papunësisë në shumicën e vendeve përfitohen vetëm nëse bëhet fjalë për papunësi absolute. Kjo krijon nevojën për të shtrirë pagesat ekzistuese të papunësisë edhe tek rastet e papunësisë së pjesshme për të kompensuar humbjet në të ardhura për shkak të orëve të reduktuara të punës.
- ▶ Masat e marra në lidhje me sigurimet shoqërore dhe subvencionimin e pagave gjatë periudhës së COVID-19 kanë shërbyer si një nxitje për punonjësit që kanë humbur vendet e punës për t'u regjistruar në shërbimet publike të punësimit dhe për punëdhënësit për të regjistruar sa më shumë punonjës si të punësuar formal. Kjo tregon se paketat stimuluese të mirë-ideuara mund të kontribuojnë (të paktën përkohësisht) edhe në formalizimin e ekonomisë informale.
- ▶ **Mbështetje të tjera me të ardhura në para dhe ndihmë sociale.** Pagesat nga ndihma sociale u rritën përkohësisht, kushtet e pranueshmërisë u lehtësuan si dhe u dhanë pagesa shtesë të njëhershme në para. Serbia dhe Maqedonia e Veriut ofruan ndihmë të njëhershme me të ardhura me karakter universal. Përveç transferimit të parave, u ofruan edhe përfitime të tjera në natyrë në formën e shtyrjes së pagesës së shërbimeve komunale ose të kuponëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve specifike.
- ▶ **Pagesat në rastet e lejes së pushimit për t'u kujdesur për fëmijët.** Disa prej vendeve zbatuan dhënien e lejes së përkohshme të veçantë për punonjësit që duhej të kujdeseshin për fëmijët e tyre në shtëpi. Dispozitat ekzistuese sa i takon lejes për t'u kujdesur për fëmijët në ligjin e punës ose ligjin e sigurimeve shoqërore nuk janë të mjaftueshme për rastet kur shkollat dhe institucionet e kujdesit për fëmijët janë të mbyllura me muaj të tërë. Prandaj, ekziston nevoja për përmirësimin e kësaj dispozite.
- ▶ **Mbështetje shtesë me të ardhura për pensionistët.** Në të gjitha vendet, u krye indeksimi i mëtejshëm i pensioneve si dhe rritja e pensioneve minimale. Mali i Zi, Serbia dhe Ukraina ofruan pagesa shtesë të njëhershme për pensionistët. Pothuajse për të gjithë të moshuarit, pensionet janë burimi i vetëm i të ardhurave. Garantimi i nivelit sa më adekuat të këtyre përfitimeve si dhe rregullimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme është vendimtar. Në funksion të kufizimeve të ngushta financiare, mbështetja ad hoc për pensionet duhet të synojë pensionistët me të ardhura të ulëta.

## Sfidat e sistemeve ekzistuese të sigurimeve shoqërore

Në të shtatë vendet nën shqyrtim, politikat e sigurimeve shoqërore përbënin një nga pjesët thelbësore të masave të integruara për t'iu përgjigjur krizës së shkaktuar nga COVID-19 gjatë fazës së parë të pandemisë. Sidoqoftë, kriza ka nxjerrë në dritë edhe mangësitë në sistemet ekzistuese të sigurimeve shoqërore.

Megjithëse sistemet ekzistuese të sigurimeve shoqërore reagues mirë për të mbrojtur anëtarët kontribues, kryesisht të përbërë nga punonjës të rregullt me kohë të plotë në punësim formal dhe të vetëpunësuar, ata nuk rezultuan kaq të suksesshme për një numër në rritje të punonjësve të cilët ishin të përjashtuar ose të mbuluar në mënyrë të pamjaftueshme nga sistemet ekzistuese kontributive të sigurimeve shoqërore. Grupet e punonjësve që nuk mbrohen në mënyrë adekuate nga sistemet ekzistuese të sigurimeve shoqërore përfshijnë punonjësit në ekonominë informale dhe punonjësit e përfshirë në forma jostandarde të punësimit, përfshirë ata në ekonominë e platformave. Edhe punëtorët migrantë, përfshirë të riatdhesuarit nga vendet e destinacionit, janë prekur nga kjo situatë dhe shumë prej tyre humbën të drejtën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore që gëzonin kur punonin jashtë vendit.

Të gjitha vendet kanë zbatuar masat për rritjen e përfitimeve ligjore (pagesat e papunësisë, pagesat në rast sëmundjeje, ndihmën sociale dhe pensionet) dhe për kryerjen e pagesave shtesë të përkohshme ose të njehershme të paktën për grupet e veçanta. Ky fakt tregon që vendet nën shqyrtim i shohin këto nivele përfitimesh si joadekuate dhe që duhen paguar vetëm për një periudhë të kufizuar kohore.

Masat stimuluese dhe masat në lidhje me sigurimet shoqërore kanë vënë në presion të konsiderueshëm buxhetet qeveritare dhe kanë ndikuar në qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemeve të sigurimeve shoqërore, në veçanti të sistemeve pensionale tashmë të brishta. Megjithëse tani për tani ruajtja e politikave fiskale elastike dhe mbështetëse është absolutisht e domosdoshme, qeveritë me kalimin e kohës do të përballen me dilemën në lidhje me mënyrën e frenimit të deficitit fiskal dhe mbajtjes së borxhit publik nën kontroll. Në këtë kontekst, sfida kryesore e qeverisë është të sigurojë hapësirë fiskale për të ruajtur dhe përmirësuar sistemet e sigurimeve shoqërore gjatë krizës, fazës së rimëkëmbjes dhe më gjerë.

## Drejt një sistemi sa më gjithëpërfshirës dhe rezilient të sigurimeve shoqërore

Kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka nxjerrë në pah rëndësinë e investimeve proaktive për të ndërtuar sisteme gjithëpërfshirëse dhe reziliente të sigurimeve shoqërore që mund të reagojnë shpejt dhe në mënyrë efektive ndaj goditjeve sa herë që ato shfaqen. Ajo gjithashtu ka evidentuar edhe rolin vendimtar të ndërhyrjeve të Shtetit përballë një ngjarjeje të pashembullt emergjente.

Rekomandimet e mëposhtme në lidhje me politikat janë rezultat i vlerësimit tonë paraprak të situatës:

- Sigurimet shoqërore janë shtyllë kryesore kur bëhet fjalë për reagimin e integruar të politikave. Kështu që masat e sigurimeve shoqërore duhet të koordinohen ngushtë me një gamë të gjerë politikash, në veçanti me politikat për tregun e punës dhe politikat fiskale për të mbështetur mbrojtjen e punësimit dhe vazhdimësinë e biznesit.
- Sistemet e sigurimeve shoqërore duhet të garantojnë në mënyrë efektive qasjen tek kujdesi shëndetësor dhe sigurinë e të ardhurave. Qasja tek kujdesi shëndetësor duhet të garantohet për të gjithë popullsinë. Në të njëjtën kohë, për të siguruar shërbimet e nevojshme të kujdesit shëndetësor duhet të alokohen burime të mjaftueshme. Siguria e të ardhurave duhet të garantohet në të gjitha situatat që kanë të bëjnë me humbjen e të ardhurave, përfshirë orët e reduktuara të punës pa dëshirën dhe vullnetin e punonjësve, papunësinë, sëmundjen (përfshirë karantinën) dhe rritjen e përgjegjësive familjare. Siguria e të ardhurave jo vetëm që duhet të parandalojë varfërinë, por të zëvendësojë edhe të ardhurat e humbura në masën e duhur dhe të pranueshme (në varësi të një maksimumi të caktuar).

- ▶ Mbulimi me sigurime shoqërore duhet të shtrihet tek punonjësit e angazhuar në të gjitha llojet e punësimit, duke përfshirë edhe format jostandarde të punësimit duke marrë parasysh heterogjenitetin e tyre të madh dhe lëvizshmërinë e lartë të tregut të punës. Përputhshmëria dhe zbatimi duhet të përmirësohen nëpërmjet inkurajimit të formalizimit të punonjësve në ekonominë informale dhe përmirësimit të mbledhjes së kontributeve krahasuar me nënraportimin e pagave kontributive.
- ▶ Përfitimet nga programet jo kontributive duhet të integrohen në mënyrë efektive për të plotësuar mungesën e mbulimit me përfitime nga skemat kontributive. Gjithashtu, kriza nxorri në dritë edhe nevojën për të parë mundësinë e rregullimit të arkitekturës ekzistuese të sigurimeve shoqërore dhe gjetjen e një kombinimi më të përshtatshëm të sistemeve kontributive me ato jo kontributive.
- ▶ Garantimi i dialogut social të mirëinformuar si një mekanizëm i rëndësishëm dhe efektiv për formulimin e masave për t'iu përgjigjur krizës së shkaktuar nga COVID-19 me anën e sigurimeve shoqërore është i rëndësishëm. Dakordimi dhe mbështetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme për pandeminë mund të arrihet vetëm nëse ekziston konsensusi shoqëror në mbarë vendin bazuar në perceptimin e plotë të implikimeve të masave dhe përmes angazhimit të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve përkatës.

Në një kohë kur bota e punës po përballet me një sfidë të paprecedentë, është e domosdoshme të veprohet me urgjencë për të shfrytëzuar mundësitë dhe për të ndërtuar një sistem të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe funksional të sigurimeve shoqërore, të udhëhequr nga Konventa për Standardet Minimale të Sigurimeve Shoqërore Nr. 102, Rekomandimi për Dyshemetë e Mbrojtjes Sociale Nr. 202 dhe standarde të tjera ndërkombëtare të sigurimeve shoqërore.

# 1. Situata në ekonomi dhe në tregun e punës


Ky kapitull risjell edhe njëherë në vëmendje shkurtimisht situatën e COVID-19 dhe paraqet zhvillimin e treguesve kryesorë të ekonomisë dhe të tregut të punës aktualisht në dispozicion gjatë fazës së parë të pandemisë COVID-19.

## ► 1.1. Trendet e COVID-19


Gjatë valës së parë të pandemisë COVID-19 në pranverën e vitit 2020, vendet në rajon ishin përgjithësisht më pak të prekura nga pandemia. Numri i rasteve të infektiveve dhe rasteve të vdekjeve në këto vende ishte shumë më i ulët se në vendet e Evropës Perëndimore. Sidoqoftë, siç përshkruhet edhe në figurën 1.1, duke filluar nga muaji korrik i vitit 2020 vendet në Evropën Qendrore dhe Lindore kanë përditësuar në mënyrë të vazhdueshme shifra më të larta të rasteve ditore dhe të vdekjeve. Situata epidemiologjike në zhvillim e rasteve të infeksioneve ngriti shqetësimin se pandemia mund të vazhdonte, edhe nëse nuk do të përkeqësohej, gjatë periudhës së dimrit dhe një pjese të madhe të vitit 2021.

► Figura 1.1. Statistikat e rasteve të infeksioneve dhe vdekjeve të shkaktuara nga COVID-19, Mars-Dhjetor, 2020

Raste të raportuara me COVID-19 për 100,000 persona (gjatë 14 ditëve të fundit)



Vdekje të raportuara nga COVID-19 për 1 milion persona (gjatë 14 ditëve të fundit)



**Burimi:** Të dhëna nga Qendra Evropiane për Kontrollin e Sëmundjeve.

<https://www.ecdc.europa.eu/en/publications-data/download-todays-data-geographic-distribution-covid-19-cases-worldwide>.

## ► 1.2. Ndikimet në tregun e punës

Pandemia COVID-19 pati ndikim të rëndë ekonomik për të gjitha vendet. Parashikimet e ndryshme ekonomike flasin për një recesion të thellë dhe një rimëkëmbje potencialisht të ngadaltë dhe të ndërprerë.<sup>1</sup>

### Humbja e orëve të punës dhe e të ardhurave të krahut të punës

Për të matur ndikimin e COVID-19 në të ardhurat e krahut të punës, duhen analizuar ndryshimet në orët e punës. Sipas Monitorimit të fundit të ILO-s, humbja në orë pune u rrit ndjeshëm në tremujorin e dytë të vitit 2020. Siç tregohet në Tabelën 1.1, globalisht humbja e orëve të punës në tremujorin e dytë të vitit 2020 u vlerësua në masën 18.2 përqind, e cila është e barasvlershme me 525 milion punonjës me kohë të plotë. Humbja pasuese e të ardhurave të krahut të punës në vitin 2020 vlerësohet në masën 8.3 përqind, e cila arrin në 3.7 trilionë dollarë ose 4.4 përqind të PBB-së globale. Humbja e orëve të punës në Evropën Jugore<sup>2</sup> ishte dukshëm më e lartë se mesatarja botërore dhe rajonale, ndërsa humbja në Evropën Lindore ishte më e ulët se mesatarja botërore dhe rajonale. Të dhënat e tremujorëve të tretë dhe të katërt të vitit 2020 dhe shifrat e parashikuara për vitin 2021 flasin për një stabilizim gradual, por ndikimi i konsiderueshëm në vendet e punës dhe në të ardhura ka ende gjasa të vazhdojë.

Edhe sipas Raportit Global të ILO-s për Pagat, në gjysmën e parë të vitit 2020 është vënë re një presion mbi nivelin e pagave si rezultat i krizës së shkaktuar nga COVID-19. Gratë dhe punonjësit me pagë më të ulët u prekën në mënyrë disproporcionale, duke rritur kështu pabarazitë gjinore dhe pabarazitë në të ardhura.<sup>3</sup> Për vendet e përzgjedhura evropiane, raporti vlerëson se fatura e pagave të humbura si rezultat i reduktimit të orëve të punës në tremujorët e parë dhe të dytë të vitit 2020 ishte 6.9 përqind për gratë krahasuar me 4.7 përqind për burrat. Gjithashtu, për vendet e përzgjedhura evropiane, raporti vlerëson se, pa subvencionimin e pagave, 50 përqind e punëtorëve me pagë më të ulët do të kishin humbur rreth 17.3 përqind të pagave të tyre, shifër kjo shumë më e lartë se rënia e vlerësuar prej 6.5 përqind për të gjithë punonjësit.

► **Tabela 1.1. Humbjet në orë pune dhe humbjet e të ardhurave të krahut të punës sipas rajoneve, mbi baza tremujore për vitin 2020**

	Orët e humbura të punës (%)					Numri ekuivalent i vendeve të punës me kohë të plotë ('000) 48 orë në javë					Humbja e të ardhurave të krahut të punës (% e të ardhurave të krahut të punës)
	TM1	TM2	TM3	TM4	2020	TM1	TM2	TM	TM4	2020	2020
<b>Bota</b>	5.2	18.2	7.2	4.6	8.8	150,000	525,000	205,000	130,000	255,000	8.3
<b>Evropa dhe Azia Qendrore</b>	3.9	17.2	6.8	8.9	9.2	13,000	55,000	22,000	29,000	30,000	8.7
<b>Evropa Jugore</b>	6.7	23.9	7.0	11.8	12.3	3,000	12,000	3,000	6,000	6,000	n.a.

**Burimi:** Monitorimi i ILO-s: COVID-19 dhe bota e punës. Botimi i 7-të (25 janar 2021).

1, FMN (2020a), Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare. (2020) Shih edhe vlerësimin e KB për ndikimin social-ekonomik të COVID-19. E gjeni në: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/coronavirus/socio-economic-impact-of-covid-19.html>.

2. Përfshirë Italinë dhe Spanjën, të cilat janë ndër vendet më të goditura gjatë valës së parë të pandemisë.

3. Për më tepër, gratë preken në mënyrë disproporcionale edhe nga detyrimet shtesë për kujdesin ndaj fëmijëve. Ka raporte që flasin për një rritje të ndjeshme të rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës së izolimit për shkak të pandemisë.



Të dhënat e tjera të përmbledhura në Tabelën 1.2 për vendet e përzgjedhura të Ballkanit Perëndimor janë gjeneruar nga studimet e vlerësimit të shpejtë të kryera nga Zyra e ILO-s për Evropën Qendrore dhe Lindore në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në lidhje me ndikimet e situatës në punësim dhe mënyrën e reagimit të politikave.

► **Tabela 1.2. Humbjet në orë pune në vendet e përzgjedhura të Ballkanit Perëndimor, tre tremujorët e parë të vitit 2020**

	Orët e humbura të punës (%)			Numri ekuivalent i vendeve të punës me kohë të plotë ('000)			
				48 orë në javë		40 orë në javë	
	TM1	TM2	TM3	TM2	TM3	TM2	TM3
Ballkani Perëndimor	2.9	17.3	12.0	970	680	1,170	810
Bosnja dhe Hercegovina	3.6	20.3	16.2	180	140	220	170
Maqedonia e Veriut	5.8	14.0	10.6	100	70	110	90
Serbia	1.7	16.8	11.0	48	320	580	380

Burimi: Zyra e ILO-s për Evropën Qendrore dhe Lindore (2020a). COVID-19 dhe Bota e Punës: Vlerësimi i Shpejtë i Ndikimeve në Punësim dhe i Reagimit të Politikave.

## Treguesit e tregut të punës

Tabela 1.3 paraqet treguesit kryesorë të tregut të punës gjatë tremujorëve të dytë në vitin 2019 dhe 2020 bazuar në Anketat e Forcave të Punës të kryera nga zyrat statistikore kombëtare të të shtatë vendeve në shqyrtim.

► **Tabela 1.3. Treguesit kryesorë të tregut të punës, tremujori i dytë i vitit 2019 dhe 2020**

		Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina			Moldavia	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia	Ukraina
			Totali	FB&H	RS					
<b>Shkalla e personave ekonomikisht aktivë (%)</b>										
2019	Totali	60.6	42.1	39.1	47.8	43.4	57.8	57.1	54.8	56.3
2020		58.8	47.1	45.3	51.0	39.9	53.4	56.5	52.0	54.3
2019	Gra	53.1	32.9	29.3	40.1	38.8	49.6	46.7	47.3	49.2
2020		51.9	36.0	32.4	43.3	35.6	40.7	46.2	44.7	47.4
2019	Burra	68.2	51.7	49.7	55.3	48.6	66.3	67.5	62.9	64.8
2020		65.8	58.9	59.0	59.2	44.8	59.9	66.8	59.8	62.6
<b>Shkalla e punësimit (%)</b>										
2019	Totali	53.6	35.5	31.9	42.2	41.4	49.5	47.1	49.2	51.7
2020		51.7	39.6	37.7	43.7	38.2	45.2	47.1	48.2	49.0
2019	Gra	47.1	26.7	23.0	34.2	37.6	41.7	37.2	42.1	45.4
2020		45.8	29.1	25.2	36.9	34.3	39.8	38.5	41.3	43.0
2019	Burra	60.3	44.6	41.6	50.0	45.8	57.7	57.0	56.8	59.3
2020		57.9	50.7	50.8	51.0	42.6	50.8	55.6	55.7	56.1
<b>Shkalla e papunësisë (%)</b>										
2019	Totali	11.5	15.7	18.4	11.7	4.5	14.3	17.5	10.3	7.8
2020		11.9	16.0	16.8	14.2	4.2	15.2	16.7	7.3	9.8
2019	Gra	11.4	18.8	21.7	14.7	3.1	16.1	20.3	11.0	7.9
2020		11.9	19.1	22.1	14.7	3.5	15.3	16.7	7.6	9.2
2019	Burra	11.6	13.6	16.3	9.5	5.7	13.0	15.5	9.7	8.5
2020		12.0	13.9	13.8	13.9	4.9	15.2	16.8	7.0	10.4

Shënime: FB&H = Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

Burimi: Zyrat Kombëtare të Statistikave.

Duke krahasuar tremujorin e dytë të vitit 2020 me të njëjtin tremujor të vitit 2019, si niveli i personave ekonomik aktiv ashtu edhe niveli i punësimit kanë pësuar rënie për të dy gjinitë në të shtatë vendet, ndërsa ndryshimet në nivelet e papunësisë ishin relativisht të vogla. Vetëm Ukraina kishte një rritje prej 2.2 pikë përqindje në nivelin e papunësisë. Duhet të përmendim se nivelet e papunësisë kanë pësuar një rënie të lehtë për burrat në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, për burrat në Moldavi, gratë në Maqedoninë e Veriut dhe për të dy gjinitë në Serbi. Në Serbi, për shembull, kjo ka ndodhur pasi individët të cilët nuk mund të kërkonin punë ose nuk ishin në gjendje të fillonin të punonin për shkak të masave të karantinës nuk janë konsideruar si persona të papunë sipas përkufizimit të ILO-s por si persona ekonomikisht joaktivë.

Edhe Anketat e Forcave të Punës në vendet e përzgjedhura konfirmojnë një ulje të ndjeshme të orëve të punës në tremujorin e dytë të vitit 2020 për shkak të izolimit. Vëzhgimet kryesore nga Moldavia, Maqedonia e Veriut dhe Serbia përmbledhen si më poshtë.<sup>4</sup>

- Në Moldavi, 24.4 përqind e popullsisë së punësuar deklaruan se e kishin ndjerë ndikimin e pandemisë COVID-19 në punën e tyre gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Midis personave të punësuar të prekur, 60.7 përqind nuk punuan fare ose nuk u paraqitën në punë, 25.6 përqind punuan në distancë. Përveç kësaj, 90.1 përqind e tyre punuan më pak se 40 orë në javë (krahasuar me 86.1 përqind në tremujorin e parë të vitit 2020). Pjesa e personave që kishin një punë por nuk punonin fare u rrit nga 2.5 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2019, 4.9 përqind në tremujorin e parë të vitit 2020 në 20 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2020. Arsyet kryesore për numrin më të ulët të orëve të punës dhe për mungesën e përkohshme në punë përfshijnë: papunësinë teknike, mbylljen e vendit të punës, pushimin me pagesë dhe pa pagesë, etj. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2019, numri i personave që morën lejen vjetore u rrit 4 herë, numri i personave që punuan nga shtëpia u rrit me më shumë se 3.3 herë, dhe numri i personave me pushim të papaguar dhe teknikisht të papunë u rrit me 90 përqind.
- Moldavia dhe Serbia raportojnë nën-shfrytëzimin e përbërë të krahut të punës, i cili kombinon të papunët, të nënpunësit sa i takon kohës dhe forcat e mundshme të punës (persona të disponueshëm për punë por që nuk kërkojnë punë, d.m.th. punëtorë të dekurajuar). Të dy vendet evidentuan një rritje të konsiderueshme të nënshfrytëzimit të fuqisë punëtore. Shkalla e nënpërdorimit të përbërë të krahut të punës në Moldavi u rrit nga 9.9 përqind në vitin 2019 në 13.5 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2020. Në Serbi, nënshfrytëzimi i krahut të punës u rrit në mënyrë marginale nga 19.5 përqind në tremujorin e parë të vitit 2019 në 19.9 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2020. Numri i të nënpunësuarve u rrit si rezultat i orëve të reduktuara të punës duke përfshirë pushimet e papaguara, një rritje të konsiderueshme të punëtorëve të dekurajuar dhe detyrimet shtesë për kujdesin ndaj fëmijëve për prindërit.
- Në Maqedoninë e Veriut, gati 62 përqind e të gjithë punëdhënësve dhe ndërmarrjeve jo-punëdhënëse janë ndër sektorët e goditur rëndë, shumë prej të cilëve shfaqin shkallë të ndryshme informaliteti. Shumica e punonjësve që kanë humbur vendin e tyre të punës gjatë kësaj krize janë të angazhuar në forma jostandarde të punësimit ose në punësim informal, me pak ose aspak qasje tek pagesa e papunësisë. Në tremujorin e dytë të vitit 2020, përqindja e të punësuarve që mungonin në punë u rrit në 11.4 përqind kryesisht për shkak të zvogëlimit të vëllimit të punës për arsye teknike ose ekonomike. Edhe pjesa e të punësuarve që punuan nga shtëpia u rrit në 12.1 përqind.

Kutia 1 paraqet trendin e të papunëve të regjistruar në vitin 2020. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 në shumicën e vendeve është vënë re një rritje e konsiderueshme në numrin e të papunëve të regjistruar. Në mënyrë të ngjashme, disa vende, përfshirë Serbinë dhe Ukrainën, raportojnë ulje sa i takon punësimit informal, ndërsa një rritje të lehtë në numrin e të punësuarve formalë. Këto mund të shoqërohen me faktin se regjistrimi pranë shërbimeve publike të punësimit është kusht për marrjen e pagesës së papunësisë, ndihmës sociale dhe llojeve të tjera të mbështetjes me të ardhura dhe për përfitimin e mbështetjes

4. Edhe Anketat e Ndërmarrjeve në vendet e përzgjedhura, të kryera nga organizatat e punëdhënësve në bashkëpunim me ILO-n dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, konfirmojnë se pandemia ka prekur rëndë më shumë se 80 përqind të ndërmarrjeve të anketuara, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe mikro në sektorë të veçantë.


nga paketat stimuluuese për punëdhënësit dhe punonjësit në bazë të numrit të punonjësve formalë në ndërmarrje. Këto kushte shërbyen si stimuj për punonjësit që kishin humbur vendet e punës për t'u regjistruar pranë shërbimeve publike të punësimit dhe për punëdhënësit për të regjistruar më shumë punonjës si të punësuar formalë. Kjo tregon se pagesat e papunësisë dhe ndihma sociale jo vetëm që kontribuojnë në sigurinë e të ardhurave dhe vazhdimësinë e biznesit por kontribuojnë edhe në zyrta-rizimin e ekonomisë informale.

► **Kutia 1. Trendet e të papunëve të regjistruar në vendet e përzgjedhura në vitin 2020**

Kjo Kutia paraqet analizën e ndryshimit mujor në numrin e personave të papunë të regjistruar në vitin 2020 bazuar në të dhënat e siguruar nga shërbimet publike të punësimit të Bosnjë dhe Hercegovinës, Serbisë dhe Ukrainës. Këto të dhëna janë plotësuar edhe me të dhënat tremujore të Shqipërisë.

Duhet të theksohet se dallime të konsiderueshme janë vërejtur midis të papunëve të regjistruar dhe numrit të personave të papunë sipas udhëzimit <sup>5</sup> të ILO-s. Për më tepër, këto ndryshime ndryshojnë dukshëm nga njëri vend në tjetrin. Vlerësimet e përafërta tregojnë se raporti midis të papunëve të regjistruar dhe numrit të personave të papunë sipas anketave të forcave të punës në vitin 2019 ishte 23 përqind në Ukrainë, 43 përqind në Shqipëri dhe 166 përqind në Serbi. Vlerësimi për Bosnjë dhe Hercegovinën ishte i pamundur, por të dhënat e viteve të shkuara tregojnë se numri i të papunëve të regjistruar e tejkalon numrin e të papunëve sipas përkufizimit <sup>6</sup> të ILO-s. Për këtë arsye, e kemi kufizuar analizën tonë tek të dhënat në lidhje me të papunët e regjistruar.

► **Figura B1.1. Numri mujor i të papunëve të regjistruar rishtasi, 2020 (Jan. = 100)**



**Burimi:** Llogaritjet e kryera nga vetë ILO bazuar në të dhënat e siguruar nga zyrat kombëtare të punësimit.  
**Shënime:** FB&H = Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.


5. Sipas Rezolutës në lidhje me statistikat e punës, punësimit dhe nënshfrytëzimit të krahut të punës të miratuar nga Konferenca e 19-të Ndërkombëtare e Statisticienëve të Punës në vitin 2013, personat e papunë përkufizohen si të gjithë ata persona në moshë pune që nuk ishin në punë, kryenin aktivitete për të kërkuar punë gjatë një periudhe të specifikuar kohe dhe ishin aktualisht në dispozicion për të filluar punë në momentin që iu jepet një mundësi pune.

6. Arsyeja kryesore është se këto vende regjistrojnë edhe një numër të caktuar personash të klasifikuar joaktivë sipas përkufizimit të ILO-s. Një shpjegim i mundshëm është se regjistrimi pranë shërbimit publik të punësimit është një nga kërkesat për aplikimin e përfitimeve të ndihmës sociale.

Figura B1.1 paraqet numrin mujor të personave të papunë të regjistruar rishtasi. Ukraina dhe Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës evidentuan një rritje të ndjeshme në muajin prill, ku ky numër u dyfishua krahasuar me muajin janar. Nga ana tjetër, numri i të papunëve të regjistruar rishtasi në Serbi dhe Republika Srpska të Bosnjë dhe Hercegovinës u ul gjatë muajit prill por pas një periudhe kohore, duke filluar nga muaji qershor e tutje ky numër u kthye në nivelin e muajit janar. Në Shqipëri, numri i të papunëve të regjistruar rishtasi në tremujorin e dytë të vitit 2020 u rrit me 50 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë kohore të vitit 2019.

Figura B1.2 pasqyron numrin mujor të personave të papunë të regjistruar. Në veçanti, Ukraina shfaq një rritje të ndjeshme me 44 përqind nga muaji prill në muajin korrik, dhe pas një rënije graduale ajo shfaq një trend në rritje gjatë muajve nëntor dhe dhjetor. Në Shqipëri, numri i të papunëve të regjistruar në tremujorin e dytë të vitit 2020 u rrit me 26 përqind nga tremujori i parë i vitit 2020. Numri në Serbi dhe në dy njësitë e Bosnjë dhe Hercegovinës shfaqti një rritje të moderuar në tremujorin e dytë dhe mbetet e qëndrueshme pas kësaj.

► Figura B1.2. Numri mujor i të papunëve të regjistruar, 2020 (Jan. = 100)




**Burimi:** Llogaritjet e kryera nga vetë ILO bazuar në të dhënat e siguruar nga zyrat kombëtare të punësimit.

**Shënime:** FB&H = Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

Siç tregohet në Figurën B1.3, numri i përfituesve të pagesës së papunësisë u rrit ndjeshëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 në të gjitha vendet përveç Serbisë. Rritja nga niveli i muajit janar ishte 59 përqind për Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, 46 përqind për Republikën Srpska dhe 39 përqind për Ukrainën. Në Ukrainë dhe në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës, numri i përfituesve u ul gradualisht në tremujorin e tretë, por u kthye në një trend në rritje në muajt nëntor dhe dhjetor. Në Republikën Srpska, numri i përfituesve ka pësuar një rritje të vazhdueshme dhe në muajin nëntor arriti të jetë 68 përqind më i lartë se gjatë muajit janar. Në Shqipëri, në tremujorin e parë të vitit 2020 nga të papunët e regjistruar vetëm 4.4 përqind morën pagesën e papunësisë dhe 34 përqind morën ndihmën sociale me para në dorë (e quajtur ndihma ekonomike). Numri i përfituesve të pagesave të papunësisë u rrit me 23 përqind dhe numri i përfituesve të ndihmës ekonomike u rrit me 15 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2020.

► Figura B1.3. Numri mujor i përfituesve të pagesës së papunësisë, 2020 (Jan. = 100)



**Burimi:** Llogaritjet e kryera nga vetë ILO bazuar në të dhënat e siguruar nga zyrat kombëtare të punësimit.  
**Shënime:** FB&H = Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

Përqindja e përfituesve të pagesave të papunësisë në rradhët e të papunëve të regjistruar për tremujorin e dytë të vitit 2020 varion nga 86 përqind në Ukrainë, 6.8 përqind në Serbi, 6.2 përqind në Republika Srpska, 5.8 përqind në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe 4.3 përqind në Shqipëri. Siç u përmend më lart, ekziston një mospërputhje e konsiderueshme midis të papunëve të regjistruar dhe numrit të të papunëve sipas përkufizimit të ILO-s. Një vlerësim në vija të përgjithshme tregon se, sa i përket të papunëve në kuptimin e përkufizimit të ILO-s, pjesa e përfituesve të pagesave të papunësisë në tremujorin e dytë të vitit 2020 do të ishte rreth 20 përqind në Ukrainë, 10 përqind në Serbi dhe Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës, 7 përqind në Republikën Srpska dhe 2 përqind në Shqipëri (ndërsa në Shqipëri 13 përqind ishin përfitues të ndihmës sociale).

## ► 1.3. Problemet aktuale në tregun e punës dhe sfidat në lidhje me sigurimet shoqërore


Në mbështetje të diskutimeve në lidhje me politikat në fushën e punësimit dhe të sigurimeve shoqërore gjatë periudhës së pandemisë, po iu paraqesim shkurtimisht një analizë paraprake të disa prej tipareve të përbashkëta dhe problemeve më të fundit të vërejtura në tregun e punës në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe implikimet e tyre sa i takon mbulimit me sigurime shoqërore.

### Ekonomia informale dhe puna e padeklaruar

Në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropën Lindore, edhe pse shumica e punonjësve janë punonjës të rregullt me kohë të plotë në sektorin formal të punësimit, edhe punonjësit në ekonominë informale përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm. Ekonomia informale është shkaktuar nga faktorë kompleksë ekonomikë, socialë, institucionalë dhe kulturorë që ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Rekomandimi i ILO-s për Kalimin nga Ekonomia Informale në atë Formale, 2015 (Nr. 204) e përkufizon “ekonominë informale” (e njohur gjithashtu edhe si ekonomia “gri” ose “hije”) si të gjitha aktivitetet ekonomike të kryera nga punonjësit dhe njësitë ekonomike që janë - në ligj ose në praktikë - të pambuluar ose pamjaftueshmërisht të mbuluar nga rregullimet formale. Puna e kryer në ekonominë informale shoqërohet shpesh me paga të ulta dhe kushte të pasigurta pune. Sipas përkufizimit, këtyre punëtorëve u mungon përfaqësimi, e drejta e organizimit në shoqata dhe e drejta për tu mbuluar me sigurime shoqërore.

Figura 1.2 tregon dimensionin e vlerësuar të punësimit informal bazuar në Anketat e Forcave të Punës. Disa studime të tjera dalin me vlerësime të ndryshme, zakonisht vlerësime që variojnë nga 30 përqind deri në 50 përqind të popullsisë së punësuar.

► Figura 1.2. Përqindja e punësimit informal në rradhët e popullsisë së punësuar, 2019



Burimi: Skedat informative të ILO-s për ekonominë informale në vendet nën shqyrtim. [http://www.ilo.org/budapest/WCMS\\_751321/lang--en/index.htm](http://www.ilo.org/budapest/WCMS_751321/lang--en/index.htm).

Një problem tjetër madhor në lidhje me ekonominë informale përfshin punonjësit dhe njësitë ekonomike që veprojnë brenda fushës shtrirjes formale të ligjit, por ligji nuk zbatohet në mënyrë efektive ose thjesht nuk zbatohet në praktikë. Një rast tipik përfshin punën e padeklaruar, ku njësitë ekonomike me dashje shmangin tatimet, ligjet dhe normativat shoqërore dhe të punës. Pagesa informale e pagave me para në dorë zakonisht njihet si «paga në zarf». Në këtë drejtim, Komisioni Evropian e përkufizon punën e padeklaruar si «çdo aktivitet i paguar që është i ligjshëm për sa i përket natyrës së tij por nuk deklarohet tek autoritetet publike, duke marrë parasysh ndryshimet në sistemin rregullator të Shteteve Anëtare të BE-së».

Puna e padeklaruar i referohet një situatë formale punësimi në të cilën punonjësit dhe punëdhënësit deklarojnë të ardhura më të ulëta se sa ato reale për të maksimizuar të ardhurat e tyre të disponueshme ose fitimin. Për sigurimet shoqërore, puna e padeklaruar nënkupton mashtrim dhe evazion të kontributeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore. Në një rast tipik të nëndeklarimit të pagës, një punonjës dhe punëdhënësi i tij/saj raportojnë vetëm nivelin e kontributit minimal të përcaktuar me ligj, ndërsa pjesa e mbetur e pagës së tyre paguhet drejtpërdrejt dhe në mënyrë informale nga punëdhënësi tek punonjësi. Kjo siguron të paktën një nivel të caktuar përfitimi nëse punonjësi e plotëson periudhën e kontributit të kërkuar. Nëndeklarimi i të ardhurave kërcënon kështu qëndrueshmërinë e sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe mjaftueshmërinë e përfitimeve nga sigurimet shoqërore. Kjo mund të çojë në një rrjedhje të konsiderueshme të fondeve të sistemeve të sigurimeve shoqërore.


Mbizotërimi i ekonomisë informale dhe praktika e përhapur e punës së padeklaruar përbëjnë sfida serioze për shtrirjen e mbulimit me sigurime shoqërore. Hirose dhe Hetteš (2016) raportojnë vlerësimet e mëposhtme për Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Moldavinë. Në vitin 2008 në Bosnjë dhe Hercegovinë, 32.8 përqind e popullsisë së punësuar punonte në ekonominë informale dhe 10.7 përqind e PBB-së nuk ishte raportuar. Kontributet e papaguara të sigurimeve shoqërore ishin në masën 4.7 përqind të PBB-së dhe tatimi mbi të ardhurat e papaguara arriti në 0.5 përqind të PBB-së. Në vitin 2015 në Moldavi, puna kryesore për 34.8 përqind të popullsisë së punësuar ishte informale. Në vitin 2010 të ardhurat e padeklaruar për shkak të punësimit informal dhe nënraportimit ishin të barabarta me 12.9 përqind të PBB-së. Kontributet e papaguara të sigurimeve shoqërore nga të ardhurat e padeklaruar ishin të barabarta me 5.2 përqind të PBB-së (4.1 përqind për sigurimet shoqërore dhe 1.1 përqind për sigurimet shëndetësore).

## ► Kutia 2. Mbulimi me sigurime shoqërore për të vetëpunësuarit dhe punonjësit në punësim informal, Shqipëri

Sistemet ekzistuese të sigurimeve shoqërore janë përballur me një trend në rënie të mbulimit kontributiv në rradhët e popullatës në moshë pune. Kjo ka ardhur për shkak të niveleve të ulëta të aktivitetit ekonomik dhe niveleve të ulëta të punësimit, veçanërisht në grupe të caktuara të popullsisë, dhe niveleve të larta të informalitetit dhe aktivitetit të përhapur ekonomik të padeklaruar që ka çuar në mosrespektim të ligjit për sigurimet shoqërore.

Figura B2.1 paraqet mbulimin me sigurime shoqërore në Shqipëri sipas gjendjes së tregut të punës në vitin 2019. Në përgjithësi, nga popullsia në moshë pune, 20 deri në 64 vjeç, numri i kontribuesve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore përbënte 44.5 përqind të tyre. Pjesa e mbetur e popullsisë prej 55.5 përqind në marrëdhënie pune nuk kontribuon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Siç tregon Figura B2.1, ndërsa mbulimi për punonjësit formalë është i plotë, ai bie në masën 42 përqind për të vetëpunësuarit, dhe praktikisht zero për anëtarët kontribues të familjes që përbëhen kryesisht nga punonjës në ekonominë informale.

► Figura B2.1. Mbulimi me sigurime shoqërore sipas statusit të tregut të punës, Shqipëri 2019



**Burimi:** Llogaritjet e kryera nga vetë ILO bazuar në të dhënat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit të Statistikave në Shqipëri.

Figura B2.2 përshkruan statusin e tregut të punës të popullatës shqiptare sipas gjinisë dhe grupmoshave dhe çon në vëzhgimet e mëposhtme:

Pjesëmarrja në forcën e punës e të rinjve të moshës 15-24 vjeç është më pak se 40 përqind ndërsa pjesa tjetër janë duke ndjekur shkollimin, duke u marrë me përgjegjësi shtëpiake dhe familjare, ose janë të dekurajuar për të kërkuar punë. Pavarësisht shkallës së ulët të pjesëmarrjes në forcën e punës, kjo grupmoshë karakterizohet nga një shkallë e lartë papunësie dhe përqindje e ulët e të punësuarve.


Në moshën kryesore të punës nga 25 deri në 54 vjeç, gratë shfaqin nivele më të ulëta të pjesëmarrjes në forcën e punës dhe përqindje më të ulët në rradhët e të punësuarve sesa burrat kryesisht për shkak të detyrimeve familjare. Pjesa e anëtarëve kontribues të familjes për gratë është dy herë më shumë se sa për burrat në këtë grup moshë.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës bie ndjeshëm për personat e moshës 65 vjeç për shkak të së drejtës për pension. Shkalla e pjesëmarrjes së grave fillon të bjerë që në grupmoshën 55-64 vjeç, kryesisht për shkak të pensioneve kalimtare më të hershme. Përqindja e të papunëve është e lartë në këtë grupmoshë për të dy gjinitë, veçanërisht për gratë.

Kështu, për të rritur pjesëmarrjen dhe punësimin e përgjithshëm të fuqisë punëtore, është e rëndësishme të sigurohet mbështetja e të rinjve për të mundësuar kalimin e tyre nga arsimi në punë, ndarja e përgjegjësi të punës dhe detyrimeve familjare midis burrave dhe grave, dhe krijimi i një mjedisi në tregun e punës ku personat më të moshuar të jenë të gatshëm dhe të aftë për të vazhduar punën.



**Figura B2.2. Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës sipas gjinisë dhe moshës, Shqipëri 2019**



**Burimi:** Llogaritjet e kryera nga vetë ILO bazuar në të dhënat e siguruar nga Instituti i Statistikave në Shqipëri.

## Format jo standarde të punësimit dhe puna nëpërmjet platformave në internet

Një problem në zhvillim e sipër me të cilin po përballet tregu i punës në rajon është diversifikimi në rritje i mënyrës së organizimit të punës, i ilustruar përmes rënies së «punësimit standard» (domethënë, punës me kohë të plotë, të pacaktuar, si dhe pjesë e një marrëdhënie varësie midis një punonjësi dhe një punëdhënësi), dhe numrit në rritje të punëtorëve në «forma jo standarde të punësimit», duke përfshirë punësimin e përkohshëm (me kohë të caktuar) dhe të rastit, punën me kohë të pjesshme dhe në dispozicion, punësimin e përkohshëm me agjenci ose marrëdhëniet e punës të maskuara si vetëpunësim.<sup>7</sup>

Punonjësit në forma jo standarde të punësimit zakonisht nuk mbulojnë nga sigurimet shoqërore të detyrueshme, ose mbulojnë vetëm pjesërisht. Në shumë vende, punonjësit e përkohshëm dhe ata me kohë të pjesshme janë të detyruar të mbulojnë me skemat e sigurimeve shoqërore. Sidoqoftë, ndryshimet e shpeshta të punëve dhe vendeve të punës kanë gjeneruar periudha kontributive të fragmentuara, duke bërë të pamundur përmbushjen e kushteve të kërkuara të pranueshmërisë. Në disa raste, mbulimi me sigurime shoqërore nuk është i detyrueshëm për punë të caktuara, si mini-punët ose kontratat me zero orë me paga nën nivelin minimal. Individët e vetëpunësuar (pa punonjës në varësi të tyre) paraqesin probleme specifike sa i takon mbulimit me sigurime shoqërore. Kur personat e vetë-punësuar mbulojnë në mënyrë të detyrueshme nga skemat e sigurimeve shoqërore, ata duhet të paguajnë kontribute si për

7. Sipas të dhënave të Eurostat të vitit 2018, në të 28 vendet anëtare të BE-së, 18.5 përqind e popullsisë së punësuar ishin të punësuar me kohë të pjesshme dhe 14.2 përqind ishin të vetëpunësuar, ndërsa 14.1 përqind e të punësuarve punonin me kontrata të përkohshme. Është e rëndësishme që të nënvizojmë që format jo standarde të punësimit janë një zgjedhje e pavullnetshme për një pjesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore. Punësimi i përkohshëm i pavullnetshëm ishte i barabartë me 7.4 përqind të të gjithë punësimit në BE, dhe puna e pavullnetshme me kohë të pjesshme përbënte një të katërtën e të gjithë punës me kohë të pjesshme.

punëdhënësit ashtu edhe për punonjësit. Në disa raste, kontratat biznes me biznes përdoren si mënyrë për të shmangur kontratat e punës dhe detyrimet si punëdhënës.

Sipas burimeve të ndryshme, format jo standarde të punësimit po shtohen dhe përbëjnë një përqindje në rritje të marrëdhënieve të punës në Evropën Qendrore dhe Lindore. Siç theksohet në një studim të kohëve të fundit, punësimi informal dhe puna e padeklaruar shpesh mbivendosen me format jo standarde të punës ose vetëpunësimit. Në Maqedoninë e Veriut, për shembull, pothuajse 40 përqind e mbi 180,000 punonjësve në punësim jo standard janë në punësim informal.

Përveç kësaj, një zhvillim i rëndësishëm i kohëve të fundit është edhe rritja e numrit të punonjësve në «ekonominë e platformave», domethënë puna e ndërmjetësuar përmes platformave në internet. Punonjësit në ekonominë e platformave nuk mbrohen në mënyrën e duhur nga ligji i punës dhe ligji për sigurimet shoqërore për shkak të natyrës së punës së tyre që bazohet kryesisht në kryerjen e detyrave të caktuara, edhe pse ata kanë shumë tipare të përbashkëta me punonjësit e punësuar.

Ka shumë fakte që provojnë se Evropa Qendrore dhe Lindore është rajon lider me një ekonomi të konsiderueshme të platformave digjitale. Për shembull, është vlerësuar se, në vitin 2018, të paktën 3 përqind e fuqisë punëtore në Ukrainë ka qenë e angazhuar në një lloj pune që kryhet në internet. Këto ndryshime kanë sjellë më shumë paqëndrueshmëri dhe karriera të fragmentuara punësimi për shumë punonjës.

## Punëtorët migrantë

Në kontekstin e globalizimit dhe zgjerimit të lëvizjes së lirë të krahut të punës në Evropë, vendet në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropën Lindore janë kthyer në vendet e origjinës, si dhe në destinacion dhe vend tranzit për një numër në rritje të punëtorëve migrantë. Sidoqoftë, punëtorët migrantë përballen me disavantazhe të shumta, duke përfshirë të drejtat e kufizuara ligjore, diskriminimin dhe mungesën e sigurimeve shoqërore.

Gjatë viteve të fundit, vendet në Evropën Qendrore dhe Lindore, veçanërisht Moldavia dhe Ukraina, kanë ndjekur në mënyrë aktive lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe për sigurimet shoqërore me Evropën dhe vendet e tjera.<sup>8</sup>

Për shkak të natyrës së marrëveshjeve për sigurimet shoqërore, ato mbulojnë kryesisht punëtorët migrantë «të rregullt» (d.m.th. migrantët me kontrata zyrtare dhe të ligjshme pune). Përkundër këtij kushti, marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe për sigurimet shoqërore kanë rezultuar të jenë një instrument ligjor efektiv për të garantuar barazinë e trajtimit dhe mirëmbajtjes së të drejtave për sigurime shoqërore për punëtorët migrantë dhe familjet e tyre.

Ndërsa flukset migratore ndërkombëtare po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe të larmishme, punëtorët migrantë ndërkombëtarë sot janë një grup shumë i larmishëm, që përfshin punëtorët sezonalë, punëtorët me kontratë të përkohshme, punëtorët migrantë të kualifikuar, si dhe punëtorët me status të parregullt. Kjo përbën një sfidë të madhe për sistemet e sigurimeve shoqërore për të garantuar të drejtat për sigurime shoqërore për të gjitha llojet e migrantëve.

<sup>8</sup> Numri i marrëveshjeve dypalëshe të shtatë vendeve në shqyrtim janë: Shqipëria 2, Bosnja dhe Hercegovina 9, Moldavia 14, Mali i Zi 14, Maqedonia e Veriut 18, Serbia 17 dhe Ukraina 16.

## 2. Shqyrtimi i masave të sigurimeve shoqërore në përgjigje të situatës

---

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të mënyrës së reagimit të politikave ndaj pandemisë COVID-19 dhe shqyrton sistemin e sigurimeve shoqërore dhe masat përkatëse të zbatuara për të adresuar pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë gjatë izolimit të parë në tremujorin e dytë të vitit 2020.

### ► 2.1. Përgjigja e politikave ndaj pandemisë COVID-19

---

#### Karakteristikat e recesionit të shkaktuar nga COVID-19

Krahasuar me krizat e mëparshme ekonomike, recesioni ekonomik i shkaktuar nga pandemia COVID-19 ka disa karakteristika të dallueshme. Për formulimin e masave sa më efektive për t'iu përgjigjur kësaj pandemie, rekomandohet marrja parasysh e karakteristikave specifike shoqërore dhe ekonomike të saj.

COVID-19 është një sëmundje infektive e shkaktuar nga SARS-CoV-2 (sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes koronavirus 2), e cila përhapet nga njeriu tek njeriu kryesisht përmes kontaktit të shpeshtë fizik me një person të infektuar dhe përmes kontaktit me sipërfaqe dhe objekte të ndotura. Studimet kanë treguar se koronavirusi i ri mund të jetë më ngjytës, të përhapet më shpejt dhe të shkaktojë sëmundje më të rënda sesa viruset e gripit. Periudha e inkubacionit për COVID-19 është, mesatarisht, 5-6 ditë dhe mund të zgjasë deri në 14 ditë. Për më tepër, personat e infektuar që nuk kanë simptoma mund ta transmetojnë virusin tek të tjerët. Aktualisht, në muajin nëntor të vitit 2020, nuk ka ende një vaksinë për të parandaluar COVID-19 ose trajtime efektive për COVID-19. Në këtë situatë, mbrojtja më e mirë kundër përhapjes së virusit është shmangia e ekspozimit ndaj virusit.

COVID-19 së pari u shfaq si një goditje e ofertës për ekonominë globale. Për shkak të izolimit, mbyllja e përkohshme e bizneseve, veçanërisht në sektorin e shërbimeve, solli një ndërprerje të papritur të aktivitetit ekonomik dhe një shkëputje të zinxhirit global të furnizimit. Sidoqoftë, ndryshe nga katastrofat natyrore, infrastruktura kryesore dhe impiantet e prodhimit nuk u dëmtuan fizikisht nga koronavirusi dhe kapaciteti i ofertës mbeti i paprekur. Ata thjesht u nënshfrytëzuan për shkak të kufizimeve të lëvizjes dhe aktivitetit.

Goditja negative e ofertës shkaktoi edhe tkurrjen e kërkesës agregate. Kufizimet sa i takon tubimeve publike dhe shoqërore, si dhe udhëtimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kanë çuar në një avullim të kërkesës thelbësore të familjeve dhe firmave. Ndërsa pandemia vazhdon, këto goditje u transformuan në një rënie thelbësore të kërkesës agregate, veçanërisht për mallrat dhe shërbimet diskrecionale përmes sjelljes së kontrolluar të konsumatorëve. Këto goditje ekonomike si në anën e ofertës ashtu edhe në atë të kërkesës të shkaktuara nga kufizimi i kontakteve ballë për ballë rezultuan në humbje të konsiderueshme të punësimit dhe të ardhurave dhe në zgjerimin e mëtejshëm të pabarazisë.

## Prioritetet e masave në përgjigje të pandemisë në faza të ndryshme

Analiza e mësipërme na shërben për krijimin e kuadrit vijues strategjik të masave të ndërmarra në përgjigje të pandemisë që korrespondojnë me fazat e ndryshme të pandemisë.

Në fazën fillestare të shpërthimit të pandemisë, parandalimi i përhapjes së infeksionit është me rëndësi të madhe, duke i dhënë përparësi mbrojtjes së jetës së njerëzve. Për këtë qëllim, qeveritë duhet të marrin masa urgjente që përfshijnë shërbimet e intensifikuara shëndetësore emergjente, distancimin shoqëror dhe izolimin. Në të njëjtën kohë, qeveritë duhet të ndërmarrin masa të forta për të mbështetur jetesën e njerëzve të prekur nga izolimi me qëllim parandalimin e mbylljes së panevojshme të bizneseve dhe humbjen e vendeve të punës dhe mbrojtjen e popullatave të cënueshme. Për punëdhënësit kjo do të ndihmojë në mbajtjen e punëtorëve të aftë gjatë mbylljes së përkohshme dhe do të mundësojë rinisjen e shpejtë të aktivitetit sapo të hiqen masat kufizuese.

Nëse frenohet rritja e fortë e infeksioneve të koronavirusit dhe lehtësohen masat izoluese në mënyrë graduale, sfida kryesore lidhet me rifillimin e aktiviteteve ekonomike duke parandaluar përsëritjen e pandemisë. Duhet të kihet parasysh se rreziku i infeksionit vazhdon të ekzistojë deri në momentin e vënies në dispozicion të vaksinës ose të kurës për shërimin e këtij infeksioni. Prandaj, garantimi i shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës duhet të jetë vendimtar për ringjalljen e tregut të punës. Në momentin e rihapjes së vendit të punës dhe kthimit të punëtorëve në punë, është e domosdoshme të organizohet puna duke patur parasysh distancimin shoqëror, përfshirjen e COVID-19 në procesin e vlerësimit të riskut në vendin e punës dhe sigurimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse.<sup>9</sup>

Siç u pa më parë, pas gati dy muaj izolimi nga muaji mars në muajin maj të vitit 2020, bizneset u rihapën dhe aktivitetet ekonomike filluan të zhvillohen në mënyrë graduale. Sidoqoftë, vala e dytë e infeksionit duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2020 në Evropë i ka detyruar shumë vende që të zbatojnë karantinimin duke përfshirë edhe rimarrjen e masave për izolimin e popullatës. Ngritje-uljet e vazhdueshme dhe të përsëritura të rasteve të infeksionit krijojnë ndjenjën e pasigurisë dhe ankthit. Nëse pandemia do të vazhdojë të ndikojë në shëndetin publik dhe në aktivitetin ekonomik, kjo do të kishte efekte të tjera të dëmshme në shoqëri dhe ekonomi.

Në dhjetor të vitit 2020, autoritetet shëndetësore të Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar dhe Komisionit Evropian, ndër të tjera, miratuan vaksinat e para për COVID-19. Në të gjithë botën janë parashikuar programet e vaksinimit në shkallë të gjerë duke filluar nga gjysma e parë e vitit 2021. Arritja e imunizimit të një pjese të madhe të popullsisë është një hap i madh përpara për mbajtjen nën kontroll të koronavirusit, i cili është një parakusht për rikuperimin në shkallë të plotë me anën e masave konvencionale. Ne duhet të monitorojmë nga afër progresin e programeve të vaksinimit me shpresën që koronavirusi do të vihet nën kontroll së shpejti.

## Rolet e politikave për punësimin dhe sigurimet shoqërore në përgjigjen e integruar ndaj krizës

Në këtë krizë aktuale, është e rëndësishme të garantohet qasja tek shërbimet shëndetësore, të mirëmbahen shërbimet thelbësore, të mbrohen vendet e punës, të lehtësohet vazhdimësia e bizneseve dhe të sigurohen të ardhurat e personave që preken nga kriza gjatë gjithë kësaj fatkeqësie. Dalja nga kjo krizë

<sup>9</sup> ILO promovon dhjetë pikat e mëposhtme të veprimit për kthimin e sigurt në punë:

(1) Formimi i një ekipi të përbashkët për të planifikuar dhe organizuar kthimin në punë; (2) Marrja e vendimit në lidhje me kohën e hapjes së aktivitetit, personat që do të kthehen në punë dhe mënyrën se si do të realizohet një gjë e tillë; (3) Marrja e masave inxhinierike, organizative dhe administrative përmes (i) shmangies së ndërveprimit fizik, (ii) ventilimit, (iii) shmangies së përqendrimit në një ambient të punëtorëve, dhe (iv) trajnimit dhe informimit; (4) Pastrimi dhe dezinfektimi i vazhdueshëm; (5) Promovimi i higjienës personale; (6) Sigurimi i pajisjeve mbrojtëse personale dhe informimi i punëtorëve; (7) Mbikëqyrja shëndetësore; (8) Marrja parasysh e rreziqeve të tjera, përfshirë ato psikosociale; (9) Rishikimi i planeve të gatishmërisë në rast emergjencash; dhe (10) Rishikimi dhe përditësimi i masave parandaluese dhe kontrolluese me evoluimin e situatës. Burimi: ILO (2020c).

kërkon një përgjigje të integruar të politikave që përfshin politikat fiskale, monetare, politikat për tregun e punës dhe sigurimet shoqërore.

Nga perspektiva e botës së punës, si politikat e punësimit, ashtu edhe politikat e sigurimeve shoqërore luajnë një rol kritik në mbrojtjen e punonjësve dhe familjeve të tyre nga efektet e pafavorshme të krizës në shëndet, punësim dhe jetesë. Diskutimi i këtyre dy politikave publike pa i ndarë nga njëra tjetra do të shërbente për të demonstruar mënyrën se si ato mund të harmonizohen dhe koordinohen më mirë me qëllim kthimin e tyre në politika reciprokisht mbështetëse.<sup>10</sup>

Duke patur parasysh këto pikëpamje, në këtë raport ne shqyrtojmë tre llojet e mëposhtme të masave, ndërsa përqendrohemi kryesisht tek sigurimet shoqërore.

Grupi i parë i masave përfshin subvencionimin ose shtyrjen e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore (përfshirë taksat e korporatave dhe përgjegjësinë e punëdhënësve për pagesa të tilla si pagesa për disa prej ditëve të para të sëmundjes), por mund të shtrihet edhe tek subvencionet e pagave brenda kornizës së paketës stimuluese. Këto masa janë projektuar për të siguruar likuiditet për vazhdimësinë e biznesit, për të ruajtur vendet e punës, për të zvogëluar humbjet dhe për të garantuar mospërkeqësimin e kapaciteteve të mundshme të ofertës së kompanive.

Grupi i dytë i masave konsiston në përfitime afatshkurtra në para për personat që preken nga kriza. Normalisht, ato përfshijnë pagesat e papunësisë, pagesat në rast sëmundjeje (përfshirë përfitimet për shkak të lëndimit në punë) dhe ndihmën sociale. Këto njihen si stabilizues automatikë të cilët ofrojnë pagesa në para për humbjen e vendeve të punës dhe të ardhurave gjatë rënies ekonomike. Në përgjigje të krizës së shkaktuar nga COVID-19, disa vende kanë filluar të zbatojnë programe të posaçme për transferimin e parave për personat që janë prekur nga masat izoluese. Përveç kësaj, edhe pagesat për lejen e marrë për t'u kujdesur për fëmijët janë të rëndësishme për të mbështetur ata punonjës të cilëve iu duhej të kujdeseshin për fëmijët në shtëpi pasi çerdhet, kopshtet dhe shkollat ishin mbyllur për shkak të izolimit.

Grupi i tretë i masave mbulon pagesat shtesë e deri tek përfitimet afatgjata. Zakonisht, këto përfshijnë pagesën e njëhershme, indeksimin e jashtëzakonshëm, ose rritjen e nivelit minimal të garancisë.

Vlen të theksohet ekzistenca në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore e sistemeve të sigurimeve shoqërore, të cilat ofrojnë përfitime gjithëpërfshirëse për qytetarët në rastet kur përballen me rreziqet kryesore gjatë ciklit të jetës. Ekzistenca e dispozitave ligjore dhe e strukturës institucionale të sigurimeve shoqërore nuk garanton qëndrueshmëri sa i takon ofrimin të përfitimeve adekuate nga sistemi. Sidoqoftë, sistemet ekzistuese i ndihmuan qeveritë për të reaguar në kohë dhe në mënyrë fleksibile për të mbështetur punonjësit dhe familjet e tyre të prekura nga kriza e shkaktuar nga Covid-19 pa pasur nevojë për miratimin e ligjeve dhe rregulloreve të reja. Kjo epërsi mund të kuptohet më mirë nëse do ta krahasonim, për shembull, me shumë vende të Amerikës Latine të cilat u përballën me sfida serioze gjatë zbatimit të programeve të reja për transferimin e parave për familjet e varfra të prekura nga COVID-19.<sup>11</sup> Siç tregohet në Tabelën 2.1, të gjitha vendet në shqyrtim përveç Moldavisë kanë ratifikuar edhe Konventën e ILO-s, Nr.102 për Standardet Minimale të Sigurimeve Shoqërore.<sup>12</sup>

10 Në raportin e tij për Studimin e Përgjithshëm në lidhje me instrumentet e sigurimeve shoqërore në vitin 2011, Komiteti i Ekspertëve të ILO-s për Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve thekson nevojën për një koordinim më të mirë midis politikave të punësimit dhe sigurimeve shoqërore dhe bën thirrje për monitorim dhe mbikëqyrje efektive të përdorimit të subvencioneve të sigurimeve shoqërore për të stimuluar punësimin. Shih ILO (2011).

11 Shih Blofield et al. (2020).

12 Konventat kryesore të ILO-s për sigurimet shoqërore përfshijnë:  
K.102: Konventa për Sigurimet Shoqërore (Standardet Minimale), 1952 (Nr. 102);  
K.121: Konventa për Pagesat në rast Lëndimi në Punë, 1964 (Nr. 121);  
K.128: Konventa për Pagesat e Invaliditetit, Pleqërisë dhe të Mbijetuarve, 1967 (Nr. 128);  
K.130: Konventa për Pagesat për Kujdesin Mjekësor dhe Sëmundjet, 1969 (Nr.130);  
K.168: Konventa për Nxitjen e Punësimit dhe Mbrojtjen nga Papunësia, 1988 (Nr. 168);  
K.183: Konventa për Mbrojtjen e Amësisë, 2000 (Nr. 183); dhe  
R.202: Rekomandimi për Dyshemetë e Mbrojtjes Sociale, 2012 (Nr. 202).

► **Tabela 2.1. Ratifikimi i Konventës Nr. 102 të ILO-s dhe instrumenteve të ndërlidhura me të (duke filluar nga muaji Janar 2021)**

VENDI	DATA E RATIFIKIMIT E K.102	DEGA									KONVENTAT PËRKATËSE TË ILO-S		
		Kujdesi mjekësor	SËMUNDJA	PAPUNËSIA	PLEQËRIA	LËNDIM NË PUNË	FAMILJA	AMËSIA	INVALIDITETI	TË MBIJETUARIT	K.121	K.168	K.183
Shqipëria	18/01/2006	✓	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓		04/08/2006	18/08/2004
Bosnja dhe Hercegovina	02/06/1993	✓	✓	✓	✓	(C.121)		✓		✓	02/06/1993		18/01/2010
Moldavia													28/08/2006
Mali i Zi	03/06/2006	✓	✓	✓	✓	(C.121)		✓		✓	03/06/2006		19/04/2012
Maqedonia e Veriut	17/11/1991	✓	✓	✓	✓	(C.121)		✓		✓	17/11/1991		03/10/2012
Serbia	24/11/2000	✓	✓	✓	✓	(C.121)		✓		✓	24/11/2000		31/08/2010
Ukraina	06/06/2016	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓			

Burimi: NORMLEX. <http://www.ilo.org/dyn/normlex>.

Në pjesën e mbetur të këtij kapitulli, ne rishikojmë dhe shqyrtojmë në mënyrë krahasimore masat e ndërmarra nga të shtatë vendet nën shqyrtim gjatë gjysmës së parë të vitit 2020.<sup>13</sup> Të gjitha këto masa i gjeni të detajuara në shtojcë në formatin e një dokumenti dinamik në përditësim e sipër “Përgjigja e Mbrojtjes Sociale dhe e Vendeve të Punës ndaj COVID-19: Një Përmbledhje në Kohë Reale e Masave Kombëtare” (Gentilini, U et al. (2020)).

## ► 2.2. Mbrojtja e shëndetit social

Tanimë të shtatë vendet kanë arritur të sigurojnë një mbulim mjaft të gjerë të popullsisë me kujdes shëndetësor. Në Ukrainë sistemi shëndetësor kombëtar financohet nga taksat, dhe në pjesën tjetër të vendeve nën shqyrtim shërbimet e kujdesit shëndetësor financohen përmes sigurimeve shëndetësore shoqërore. Krahasuar me degët e tjera të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime për sigurimin e të ardhurave, mbulimi me sigurime shëndetësore në këto vende shkon përtej punonjësve në ekonominë formale, kryesisht për shkak të subvencionimit nga ana e shtetit të kategorive të caktuara të popullsisë ekonomiksht joaktive, siç janë anëtarët e familjes në ngarkim të dikujt tjetër, përfituesit e ndihmës sociale, dhe të papunët e regjistruar. Gjithsesi, nga ky mbulim janë ende të përjashtuar disa grupe, si personat e punësuar vetëm në mënyrë informale, të papunët e paregjistruar dhe popullsia rome në disa prej vendeve.

Siç tregohet në Tabelën 2.2, këto vende shpenzojnë nga 6 deri në 9 përqind të PBB-së për shëndetin, nga të cilat 41 deri në 75 përqind janë shpenzime publike (buxheti i qeverisë dhe sigurimet shoqërore) dhe pjesa tjetër janë shpenzime direkte (nga xhepi) të familjeve. Ndërsa shumica e shpenzimeve shëndetësore në Malin e Zi, Bosnjë Hercegovinë, në Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Moldavi financohet nga

13. Për monitorimin global të reagimit të mbrojtjes sociale, duhet t’i referoheni vëmendjes së kushtuar nga ILO për mbrojtjen sociale. Në veçanti, ILO (2020d) për pagesat në rast sëmundjeje, ILO (2020e) për rëndësinë e përgjithshme të ndërhyrjeve të mbrojtjes sociale, ILO (2020f) për mbrojtjen e papunësisë, ILO (2020g) për mbrojtjen e punëtorëve migrantë dhe ILO (2020h) për arritjen e barazisë gjinore në kuadrin e përgjigjes ndaj pandemisë. E gjeni në: <https://www.social-protection.org/gimi/ShowWiki.action?id=62&lang=EN>.

burimet publike, në Shqipëri, Ukrainë, Moldavi dhe Serbi është evidentuar kryerja e pagesave të mëdha direkte (nga xhepi) (dhe praktika e pagesave informale). Në veçanti, përqindja e pagesave direkte (nga xhepi) e tejkalon pjesën e fondeve publike në Shqipëri dhe Ukrainë. Pagesat direkte (nga xhepi) janë burime të vështirësive financiare dhe pengesa kryesore për qasjen tek kujdesi shëndetësor, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta. Roli i sigurimeve shëndetësore private është minimal.

Në Ukrainë, për shembull, një nga format më të zakonshme të pagesës direkte (nga xhepi) përfshin ilaçet e përshkruara për shërbimin ambulator dhe spitalor të pacientëve, të cilat duhet t'u ofrohen atyre pa pagesë, së bashku me veshjet dhe sendet e tjera njëpërdorimshe të ofruara në momentin e pranimit në spital, si dhe pagesat informale për punonjësit e kujdesit shëndetësor. Në vitin 2017, ndërsa burimet publike mbuluan pothuajse të gjitha shpenzimet në lidhje me kujdesin spitalor, kujdesin ditor, parandalimin dhe shëndetin publik dhe administratën shëndetësore, familjeve iu desh të paguanin pothuajse të gjitha kostot në lidhje me produktet farmaceutike dhe produktet e tjera mjekësore dhe gati 40 përqind të kostove të kujdesit ambulator. Përveç pagesës së ilaçeve dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pacientëve u kërkohet të bëjnë pagesa informale për të marrë kujdes shëndetësor në institucionet shëndetësore.<sup>14</sup>

Që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19, të gjitha vendet kanë marrë masa për të lehtësuar qasjen tek shërbimet e kujdesit shëndetësor. Për shembull, të dy entitetet e Bosnjë dhe Hercegovinës, si dhe Serbia e kanë zgjeruar qasjen tek kujdesi mjekësor falas për trajtimin dhe testimin e COVID-19 për të gjithë banorët.

► **Tabela 2.2. Shpenzimet shëndetësore sipas burimit të financimit, 2016–2017**

	Shpenzimet aktuale shëndetësore si % e PBB-së	Burimi i financimit (% e shpenzimeve aktuale shëndetësore)	
		Shpenzimet qeveritare	Pagesat direkte (nga xhepi)
Shqipëria	6.7	41.0	58.0
Bosnja dhe Hercegovina	8.9	70.5	29.1
Mali i Zi	7.6	75.0	24.1
Maqedonia e Veriut	6.1	67.4	31.9
Moldavia	7.0	50.6	43.6
Serbia	8.4	56.7	41.8
Ukraina	7.0	44.0	52.3

Burimi: Baza e të Dhënave e OBSH-së për Shpenzimet Shëndetësore dhe Treguesit e Zhvillimit Botëror.

## ► 2.3. Masat për vazhdimësinë e biznesit dhe ruajtjen e punësimit

Siç tregohet në Tabelën 2.3,<sup>15</sup> shumica e vendeve nën shqyrtim kanë ofruar subvencione për kontributet e sigurimeve shoqërore për punonjësit (përfshirë të vetëpunësuarit) e prekur nga masat izoluese. Mali i Zi, Serbia dhe Ukraina lejuan shtyrjen e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore si dhe të taksave. Shqipëria nuk ka zbatuar asnjë prej këtyre masave.

<sup>14</sup> Për të përmirësuar efikasitetin dhe barazinë e alokimit të burimeve publike, që nga viti 2016 Ukraina ka zbatuar një reformë shëndetësore transformuese, duke përfshirë prezantimin e paketës së përfitimeve të kujdesit shëndetësor të garantuar nga Qeveria dhe krijimin e Shërbimit Kombëtar të Shëndetit të Ukrainës i cili luan rolin e blerësit të vetëm të kujdesit shëndetësor. Shikoni Hirose (2019).

<sup>15</sup> Në Bosnjë dhe Hercegovinë, sigurimet shoqërore janë përgjegjësi më vete e entiteteve përbërëse të saj - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika Srpska dhe qarku Brčko. Qarku Brčko zbaton skemën e vet të sigurimeve shëndetësore por nuk ka ende një skemë funksionale të vetën për pensionet. Banorët duhet të zgjedhin të bëhen pjesë e njërit prej fondeve të pensionit të dy entiteteve të tjera.

► **Tabela 2.3. Subvencionimi dhe shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore**

Vendi	Shkalla e kontributit	Përshkrimi i masave
Shqipëria	Sig. Shoq.: 15% (Punëdhënësi) + 9.5% (Punonjësi) Sig. Shën.: 3.4% (Punëdhënësi + Punonjësi)	Nuk ka marrë asnjë masë për subvencionimin apo shtyrjen e kontributeve.
Bosnja dhe Hercegovina	FB&H Sig. Shoq.: 6% (Punëdhënësi) + 17% (Punonjësi) Sig. Shën.: 4% (Punonjësi) + 12.5% (Punëdhënësi)	Kompanitë që kishin (i) të paktën një rënie prej 20% të xhiros gjatë periudhës së izolimit, dhe (ii) asnjë vonesë tatimore kishin të drejtë të merrnin subvencione nga buxheti i entitetit për kontributet e sigurimeve shoqërore të punonjësve në masën 244.85 BAM për muajt prill, maj dhe qershor.
	RS Sig. Shoq.: 18.5% (Punonjësi) Sig. Shën.: 12% (Punëdhënësi)	Për kompanitë e prekura nga masat izoluese, Fondi i solidaritetit i RS-së subvencionoi kontributet e sigurimeve shoqërore për gjysmën e dytë të muajit mars dhe pagën minimale bruto për muajt prill dhe maj.  Pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore u shty për një muaj. Pagesa e taksave (duke mos përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore) u shty nga fundi i muajit mars në fund të muajit qershorit.
Moldavia	Sig. Shoq.: 23% (Punëdhënësi) + 6% (Punonjësi) Sig. Shën.: 4.5% (Punëdhënësi) + 4.5% (Punonjësi)	Nga muaji mars deri në muajin shtator, kompanitë e prekura nga pandemia kishin të drejtë të merrnin subvencionim nga 60% deri në 100% të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat në lidhje me punonjësit që ishin teknikisht të papunë.  Të vetëpunësuarit kishin të drejtë të përfitonin subvencionimin e një shume të barasvlershme me kontributin e sigurimeve shoqërore (10,747 MDL) për periudhën e pasivitetit.
Mali i Zi	Sig. Shën.: 2.3% (Punëdhënësi) + 8.5% (Punonjësi) Sig. Shoq.: 6% (Punëdhënësi) + 15.5% (Punonjësi)	Shtyrja e tatimit mbi të ardhurat dhe e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore deri në 90 ditë.
Maqedonia e Veriut	Sig. Shën.: 7.5% Sig. Shoq.: 20.5%	Kompanitë e prekura nga pandemia kishin të drejtë të merrnin një subvencion prej 50% të kontributeve të sigurimeve shoqërore gjatë muajve prill, maj dhe qershor nëse nuk e përdorin këtë mbështetje financiare për pagat (14,500 MKD për punonjës).
Serbia	Sig. Shën.: 5.15% (Punëdhënësi) + 5.15% (Punonjësi) Sig. Shoq.: 12.75% (Punëdhënësi) + 14.75% (Punonjësi)	Kompanitë në sektorin privat kishin të drejtë të përfitonin nga shtyrja e pagesave të tatimit mbi pagën dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore për pagat për muajt mars, prill dhe maj 2020 (në emër të punëmarrësit dhe në emër të punëdhënësit) deri në datë 4 janar 2021. Detyrimet e shtyrja tatimore do të duhet të paguheshin për një periudhë jo më shumë se 24 mujore, me këste mujore dhe pa interes për shlyerjen me vonesë të tyre.
Ukraina	Sig. Shoq.: 22% (Punëdhënësi)	Nuk është dhënë asnjë subvencion për kompanitë.  Disa kategori të të vetëpunësuarve u përjashtuan nga pagesa e kontributeve shoqërore (këto periudha njihen si periudha kontributive në nivelin minimal për llogaritjen e përfitimeve) nga muaji mars në muajin maj.

**Burimi:** Informacion nga korrespondentët e vendeve përkatëse të plotësuara me profilet kombëtare të Shoqatës Ndërkombëtare për Sigurimet Shoqërore (SHNSSH) dhe burime të tjera.

**Shënime:** FB&H = Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

Subvencionimi i përkohshëm i pagave është një masë e zbatuar në të gjitha vendet nën shqyrtim për të parandaluar pushimet nga puna dhe për të ndihmuar ndërmarrjet për të mbajtur punonjësit e tyre. Niveli i subvencionit ishte përgjithësisht në nivelin e pagës minimale. Kushti për marrjen e subvencionit



të pagave ishte që punëdhënësit nuk lejoheshin që të zgjidhnin kontratat e punës me punonjësit për të cilët u ishte dhënë rimbursimi për kompensimin e pagës. Tabela 2.4 bën një prezantim të këtyre masave të zbatuara në të shtatë vendet.

► Tabela 2.4. Subvencionimi i pagave

Vendi	Përshkrimi i masave
Shqipëria	Subvencionimi i pagës minimale prej 26,000 lekë nga muaji prill deri në muajin qershor dhe dhënia e ndihmës financiare të njëhershme në vlerën 40,000 lekë për punëtorët në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të prekura nga masat izoluese.
Bosnja dhe Hercegovina	FB&H Subvencionimi i pagës minimale nga muaji mars deri në muajin maj. Niveli, kohëzgjatja dhe kriteret e kualifikueshmërisë për marrjen e këtij subvencioni ndryshojnë nga njëri kanton në tjetrin.
	RS Subvencione për mbulimin e kostos së kontributeve të sigurimeve shoqërore (bazuar në pagën minimale) për muajin mars dhe pagat minimale bruto për muajt prill dhe maj.
Moldavia	Duke filluar nga muaji prill, të gjithë punonjësit e institucioneve mjekësore publike, të cilët ishin infektuar me COVID-19 gjatë ushtrimit të detyrave të tyre përfituan një ndihmë të vetme financiare në vlerën 16,000 MDL.
Mali i Zi	Subvencionimi është në masën 100% të pagës minimale bruto për bizneset të cilëve iu është ndërprerë puna dhe për sektorin e turizmit, 50% për sektorët e tjerë të prekur, 70% për punonjësit me leje me pagesë dhe punonjësit në karantinë ose izolim. Nëse një punëtor i papunë i regjistruar është punësuar rishtasi në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, 70% e pagës minimale bruto është e garantuar për gjashtë muaj.
Maqedonia e Veriut	Punonjësit e sektorit shëndetësor dhe personat e tjerë të përfshirë drejtpërdrejt në shërbimet për trajtimin e infeksionit të koronavirusit morën shtesa pagash prej 20% nga paga bazë për dy muaj. Mbështetje financiare për punëdhënësit për sigurimin e pagës maksimale prej 14,500 denarë maqedonas për çdo punonjës për muajt prill dhe maj nëse nuk marrin subvencionin prej 50% të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Kompanitë nga industria e hotelierisë, turizmit dhe transportit mund të marrin si mbështetje financiare për pagën ashtu edhe subvencionimin e 50% të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Mbështetje financiare prej 14,500 denarë maqedonas për artistët dhe klubet sportive për muajt prill dhe maj 2020.
Serbia	Punonjësit në ndërmarrjet e vogla, mikro dhe të mesme, të vetëpunësuarit dhe fermerët kishin të drejtë të merrnin subvencione në masën 100% të pagës minimale neto për muajt maj, qershor dhe korrik dhe më pas 60% të pagës minimale neto për muajt gusht dhe shtator. Punëdhënësit që morën subvencionet e pagës së dytë për periudhën gusht-shtator nuk u lejuan të pushojnë nga puna më shumë se 10% të të punësuarve brenda 3 muajve pas marrjes së subvencionit të pagës. Për punonjësit në ndërmarrjet e mëdha, të cilëve iu kishte përfunduar kontrata, u garantua 50% e pagës minimale për muajt maj, qershor dhe korrik, e cila më pas u shtri edhe në muajt gusht dhe shtator.
Ukraina	Shtesa pagash për punonjësit mjekësorë dhe të tjerë (deri në 300%) nga data 1 prill, 2020, punonjësit e mbrojtjes sociale që ofrojnë shërbime sociale në mënyrë të drejtpërdrejtë (deri në 100%) dhe punonjësit e ndërmarrjeve dhe organizatave shtetërore, autoritetet publike të cilat kanë kontakte të drejtpërdrejta me popullatën (deri në 50%) nga data 29 prill, 2020 për periudhën e karantinës dhe brenda 30 ditëve pas përfundimit të karantinës.

**Burimi:** Informacion nga korrespondentët kombëtarë.

**Shënime:** FB&H = Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

## ► 2.4. Mbështetja me të ardhura sipas pagesave afatshkurtra

Masat që mbështesin bizneset dhe subvencionojnë kostot e krahut të tyre të punës për të ruajtur vendet e punës janë të një rëndësie thelbësore, pa harruar edhe masat të cilat ofrojnë mbështetje me të ardhura për ata persona që kanë humbur ose iu janë pakësuar të ardhurat për shkak të pandemisë.

### Pagesat në rast sëmundjeje/ për arsye shëndetësore

Siç është përmbledhur edhe në Tabelën 2.5, pagesat në rast sëmundjeje në të gjitha vendet nën shqyrtim burojnë nga kontributet e sigurimeve shoqërore. Normat e zëvendësimit varen nga periudha e kontributit.

Në kontekstin e pandemisë, punëdhënësit mund të ofrojnë pagesa në rast sëmundjeje për kompensimin e pagave të punonjësve të tyre që nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të mbylljes së biznesit ose karantinës së detyrueshme. Sidoqoftë, duket se kjo alternativë nuk është zbatuar gjerësisht nga vendet e shqyrtuara. Kemi arritur të gjejmë raporte vetëm nga Mali i Zi dhe Ukraina. Mali i Zi iu ka paguar punëtorëve në vetë-izolim dhe karantinë 70 përqind të pagës minimale. Ndërsa në Ukrainë të gjithë personat e karantinuar apo të vetë-izoluar u dëmshpërblyen me pagesën e parashikuar për rastet e sëmundjeve. Për disa grupe (kryesisht punonjës mjekësorë) niveli i përfitimit u rrit dhe kostoja u financua nga buxheti i shtetit.

► **Tabela 2.5. Pagesat në rast sëmundjeje**

	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina		Moldavia	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia	Ukraina
		FB&H	RS					
Niveli i përfitimit (si % e fitimeve të mëparshme)	70 ose 80%	80–100%	70–90%	60, 70 ose 90%	70%	70%	65%	50, 60, 70 ose 100%
Përgjegjësia e punëdhënësve	14 ditët e para	42 ditët e para	30 ditët e para	5 ditët e para (por jo më shumë se 15 ditë në vit)	60 ditët e para	30 ditët e para	30 ditët e para	5 ditët e para
Ndonjë ulje e përgjegjësisë së punëdhënësve?	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo

**Burimi:** Informacion nga korrespondentët kombëtarë dhe Profilet Kombëtare të Shoqatës Ndërkombëtare për Sigurimet Shoqërore (SHNSSH).

**Shënime:** FB&H = Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

### Papunësia dhe pagesat përkatëse

Pavarësisht përpjekjeve për të ruajtur punësimin, situata e tregut të punës në të gjitha vendet u përkeqësua. Të gjitha vendet morën masa për të rritur pagesat e papunësisë duke rritur nivelin e përfitimeve dhe duke zbutur kushtet e kualifikueshmërisë me qëllim mbulimin e një game më të gjerë punonjësish. Tabela 2.6 bën një përmbledhje të masave të marra në të shtatë vendet.

► Tabela 2.6. Papunësia dhe pagesat përkatëse

Vendi	Periudha minimale e kontributit	Niveli dhe kohëzgjatja e përfitimit	Përshkrimi i masave
Shqipëria	12 muaj	50% e pagës minimale për maksimumi 12 muaj	Gjatë pandemisë pagesat e papunësisë u dyfishuan, domethënë shuma është e barabartë me 100% të pagës minimale.
Bosnja dhe Hercegovina	FB&H	8 muaj	40% e pagës së fundit nga 3 deri në 24 muaj
	RS	8 muaj	40% e pagës së fundit nga 1 deri në 12 muaj
Moldavia	12 muaj në 24 muajt e fundit	50% e pagës së fundit (40% nëse është vullnetare) nga 5 deri në 9 muaj	Pagesa minimale e papunësisë u rrit në vlerën 2,775 MDL (paga minimale në sektorin privat) gjatë gjendjes së jashtëzakonshme (nga data 17 mars deri më 15 maj, 2020).
Mali i Zi	12 muaj gjatë 18 muajve të fundit	40% e pagës minimale nga 3 deri në 12 muaj	Mbështetje e njëhershme me të ardhura prej 50 EUR për të papunët e regjistruar që nuk e përfitojnë pagesën e papunësisë ose që nuk marrin asnjë kompensim financiar ose material. Mbështetje financiare në vlerën 50 euro për 8,583 familje që marrin mbështetje financiare.
Maqedonia e Veriut	9 muaj rresht ose 12 muaj gjatë 18 muajve të fundit	50% e pagës së fundit për maksimumi 12 muaj	Pagesat e papunësisë për personat që kanë humbur vendet e punës nga data 11 mars deri më 30 prill, pavarësisht nga periudha e kontributit, janë deri në masën 50% të pagës së fundit, por jo më shumë se 80% të pagës mesatare.
Serbia	12 muaj në 18 muajt e fundit	50% e pagës së fundit nga 3 deri në 24 muaj	Nuk ka pasur rritje të pagesave të papunësisë ose lloje të tjera të mbështetjes për personat e dalë të papunë rishtasi gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe pas saj.
Ukraina	Asnjë kontribut minimal	50-70% e pagës së fundit për maksimumi 12 muaj	Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, pagesa minimale e papunësisë u rrit nga 650 UAH në 1,000 UAH (paguar nga data 12 mars 2020 dhe do të jetë e vlefshme për 30 ditë pas përfundimit të karantinës). Çdo vit pagesa minimale rishikohet nga Fondi, dhe nuk ka informacion në lidhje me uljen. Pagesat e pjesshme të papunësisë u janë paguar punonjësve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të kompensuar orët e reduktuara të punës. Shuma është 2/3 e normës së tarifës së pagës (shuma e pagës për orë), por jo më shumë se paga minimale për vitin 2020 (4,723 UAH).

**Burimi:** Informacion nga korrespondentët kombëtarë.

**Shënime:** Të gjitha skemat kërkojnë nga përfituesit që të regjistrohen në Shërbimin e Punësimi dhe të jenë të aftë dhe të gatshëm për të punuar.  
FB&H = Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

## Lloje të tjera të mbështetjes me të ardhura në para dhe ndihma sociale

Informacioni i përmbledhur në Tabelën 2.7 flet për një rritje të përkohshme të përfitimeve nga ndihma sociale, për lehtësimin e kushteve të kualifikueshmërisë si dhe kryerjen e pagesave shtesë në para. Është vërejtur se disa prej vendeve nën shqyrtim kanë ofruar ndihmë të njëhershme me të ardhura me karakter universal. Në Serbi, ndihma e njëhershme emergjente prej 100 Euro u është ofruar të gjithë qytetarëve të moshës 18 vjeç e sipër. Në Maqedoninë e Veriut për personat me të ardhura të ulëta dhe për popullatën e të rinjve të moshës 16 deri në 26 vjeç në arsim me kohë të plotë iu është ofruar një ndihmë e ngjashme e njëhershme (rreth 50 Euro).

► **Tabela 2.7. Transfertat e parave jokontributive**

Vendi	Përshkrimi i masave
Shqipëria	U dyfishua shuma e ndihmës ekonomike. Ndihmë financiare e njëhershme prej 16,000 lekë për person për të gjithë aplikantët e ndihmës ekonomike që nuk kanë marrë asnjë pagesë deri në muajin prill 2020.
Bosnja dhe Hercegovina	FB&H Nuk ka patur transferim të ri të parave.
	RS Nuk ka patur transferim të ri të parave.
Moldavia	Nuk ka patur transferim të ri të parave. Të ardhurat bazë minimale të garantuara u rritën nga 1,107 MDL në 1,300 MDL dhe niveli i tyre për fëmijët u rrit nga 50% (553 MDL) në 75% (975 MDL) të shumës bazë. Proçedura e aplikimit për ndihmën sociale u thjeshtua.
Mali i Zi	E drejta për pagesën për fëmijët u shtri tek ato familje, anëtarët e të cilave kishin humbur punën për shkak të pandemisë dhe izolimit. Mbështetje e njëhershme prej 50 Euro për përfituesit e ndihmës sociale që nuk kualifikohen për përfitime të tjera.
Maqedonia e Veriut	Baza për testin e të ardhurave për përfitimin e ndihmës sociale u ndryshua, duke marrë parasysh të ardhurat totale të familjes gjatë muajit të fundit dhe jo gjatë tre muajve të fundit. Edhe kushtet e tjera kualifikuese u lehtësuan. Shumës së ndihmës sociale iu shtuan edhe 1,000 denarë maqedonas për të mbuluar shpenzimet e energjisë elektrike. Mbështetje e njëhershme prej 3,000 denarë maqedonas në kartën bankare të debitit për të punësuarit, paga totale e të cilëve gjatë periudhës janar-prill ishte më pak se 60,000 denarë, për të rinjtë (16-26 vjeç) në arsim me kohë të plotë. Mbështetje e njëhershme prej 9,000 denarë maqedonas në kartën bankare të debitit për përfituesit e ndihmës sociale dhe të papunët me të ardhura neto më të ulëta se 60,000 denarë maqedonas. Mbështetje e njëhershme në masën 40% të pagës së fundit neto për punonjësit mjekësorë në institucionet që merren me testimin, trajtimin diagnostik dhe mjekësor të Covid-19. Ndihmë shtesë për pagesën e energjisë elektrike prej 1000 denarësh për muajt mars dhe prill për përfituesit e ndihmës sociale.
Serbia	E drejta e përfitimit të ndihmës sociale për përfituesit ekzistues (që skadon pas datës 15 mars 2020) u zgjat për tre muaj. Ndihmë universale emergjente e njëhershme në para prej 100 EUR për të gjithë qytetarët e moshës 18 vjeç e sipër.
Ukraina	Transferimi i përkohshëm i parave (i barabartë me minimumin e jetesës) për të mbështetur fëmijët (deri në 10 vjeç) e të vetë-punësuarve. Shuma është 1,779 UAH për fëmijët nën 6 vjeç, dhe 2,218 UAH për fëmijët e moshës 6 deri në 10 vjeç. Ndihma sociale u është dhënë personave që kanë humbur vendin e punës gjatë periudhës së izolimit. Përfitimi u rrit nga 2,800 UAH në 3,020 UAH. Mbështetje me para në vlerën 1.000 UAH për rreth 600,000 përfitues të ndihmës sociale dhe për personat pa asnjë përfitim shoqëror.

**Burimi:** Informacion nga korrespondentët kombëtarë.

**Shënime:** FB&H = Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

Përveç transferimit të parave, u ofruan edhe përfitime në natyrë në formën e shtyrjes së pagesës së shërbimeve komunale ose kuponëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve specifike. Këto përfitime i gjeni të përmbledhura në Tabelën 2.8.

► **Tabela 2.8. Mbështetja në natyrë**

Vendi	Përshkrimi i masave
Shqipëria	Shpërndarja e mallrave bazë, përfshirë ilaçet, tek personat në nevojë: përfituesit e ndihmës sociale, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, personat e pastrehë. Shtyrja e pagesës së shërbimeve komunale për grupet e përzgjedhura të qiramarrësve.
Bosnja dhe Hercegovina	Shtyrja e pagesës së shërbimeve komunale për grupe të përzgjedhura të qiramarrësve në disa bashki.
Moldavia	Disa qeveri vendore dhe OJQ kanë shpërndarë pako me ushqime dhe ilaçe për personat me aftësi të kufizuara, pensionistët dhe grupet e tjera të cënueshme. Të gjithë personave iu ofrua mundësia e shtyrjes së pagesës për shërbimet komunale publike pa kamatë shtesë.
Mali i Zi	Dhurimi ndërkombëtar i ventilatorëve, pajisjeve mjekësore, materialeve për testet PCR dhe i pajisjeve mbrojtëse personale për punonjësit e kujdesit shëndetësor të Qendrës Operative të Emergjencës.
Maqedonia e Veriut	Qiratë në banesat sociale u shtynë për disa grupe të caktuara qytetarësh. Kupona prej 6,000 denarësh maqedonas për turizmin vendas dhe karta bankare debiti prej 3,000 denarësh maqedonas për furnizimin me ushqim të të punësuarve me të ardhura totale nën vlerën 60,000 denarë maqedonas nga muaji janar deri në muajin prill. Paketa ushqimore dhe sanitare të shpërndara për grupet e cënueshme.
Serbia	Pensionistëve iu dha mundësia e shtyrjes së pagesës së shërbimeve komunale publike dhe pagesave të qirasë, si dhe një zbritje prej 5% nga faturat e energjisë elektrike. Të gjithë qytetarëve u është dhënë mundësia e shtyrjes së pagesës së faturave të energjisë pa kamatë shtesë. Paketa ushqimore dhe sanitare të shpërndara për grupet e cënueshme.
Ukraina	U rritën subvencionet për strehimin (50% rritje e subvencionit për energji elektrike, gaz dhe ujë). Përfituesve të subvencioneve për strehimin iu dha mundësia për shtyrjen e pagesës së strehimit dhe shërbimeve komunale për një periudhë tremujore.

**Burimi:** Informacion nga korrespondentët kombëtarë.

## Pagesa e lejes së pushimit për kujdesin ndaj fëmijëve

Gjatë periudhës së izolimit, prindërit e fëmijëve të vegjël duhej të qëndronin në shtëpi për t'u kujdesur për ta. Disa prej vendeve nën shqyrtim filluan të zbatonin dhënien e lejes së përkohshme të posaçme për kujdesin ndaj fëmijëve. Në Malin e Zi, prindërit e fëmijëve të moshës nën 11 vjeç kishin të drejtë të merrnin lejen me pagesë dhe punëdhënësit e tyre mund të merrnin një subvencion në vlerën 70 përqind të pagës minimale. Po kështu edhe në Maqedoninë e Veriut prindërit e fëmijëve nën 10 vjeç kishin të drejtë të merrnin një pushim të tillë. Qeveria serbe rekomandoi që punëdhënësit duhet t'u jepnin leje me pagesë prindërve të fëmijëve të moshës 12 vjeç ose më pak.

## ► 2.5. Mbështetja shtesë me të ardhura për pensionistët

Tabela 2.9 paraqet masat për pensionistët. Masat e marra nga Shqipëria ishin indeksimi i mëtejshëm i përfitimeve dhe rritja e pensioneve minimale. Mali i Zi dhe Ukraina rritën pensionet minimale dhe paguan shuma shtesë të njëhershme për pensionistët përfitimet e të cilëve ishin nën nivele të caktuara. Në Serbi, të gjithë pensionistët, pavarësisht nga niveli i pensionit, morën një pagesë shtesë të njëhershme. Në Maqedoninë e Veriut, pagesat e pensioneve janë bërë më herët. Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës fillimisht planifikoi pezullimin e indeksimit. Në fund, indeksimi u shty për në muajin shtator në vend të muajit prill.

► Tabela 2.9. Pagesat shtesë në para për pensionistët

Vendi	Përshkrimi i masave
Shqipëria	Indeksimi i pensioneve me 2.3% dhe rritje më të mëdha të pensioneve minimale.
Bosnia and Herzegovina	FBiH Pas vendimit fillestar për të mos rritur pensionet për shkak të emergjencës, indeksimi i rregullt i pensionit prej 2.8% hyri në fuqi në muajin shtator të vitit 2020. Edhe vlera e pikës së pensionit të përgjithshëm në formulën e pensionit u rrit me 4.5%.
	RS Indeksimi i rregullt i pensionit prej 3.11% nga muaji janar. (Qarku Brčko ofron një pagesë shtesë për pensionistët që banojnë në Qarkun Brčko një herë në vit. Shuma varion nga 50 BAM dhe 150 BAM në varësi të nivelit të pensionit. Në vitin 2020 pagesa u bë më herët se zakonisht.)
Moldavia	Asnjë lloj mbështetjeje shtesë. Nga muaji korrik, filloi të zbatohet dhënia e një pagese të re për familjarët e stafit mjekësor që ndërruan jetë për shkak të aktivitetit të lidhur me COVID-19.
Mali i Zi	Rritja e pensionit minimal nga 125 EUR në 145 EUR. Shtesë e njëhershme prej 50 EUR për pensionistët që marrin pension të ulët deri në 128.82 EUR.
Maqedonia e Veriut	Data e pagesës së pensioneve u afrua për një javë (nga data 4 ose 5 e muajit vijues në datë 28 të muajit aktual).
Serbia	Shtesë e njëhershme prej 35 EUR e paguar për të gjithë pensionistët.
Ukraina	Mbështetje e njëhershme me para në masën 1,000 UAH për 10 milion pensionistë që marrin pensione me vlerë 5,000 UAH ose më pak. Pagesa mujore prej 500 UAH për të gjithë pensionistët mbi 80 vjeç që marrin më pak se 9,205 UAH.

**Burimi:** Informacion nga korrespondentët e vendeve përkatëse.

**Shënime:** FBiH = Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

# 3. Vlerësimi paraprak i masave të sigurimeve shoqërore në përgjigje të situatës

Megjithëse është akoma e parakohshme të vlerësohet ndikimi i plotë i masave të ndërmarra në përgjigje të COVID-19, ky kapitull përpiqet të vlerësojë efektet e këtyre masave në tregun e punës dhe të ardhurat e familjeve. Analiza jonë shqyrton shkallën e efektivitetit të këtyre masave sa i takon mbrojtjes së tregut të punës dhe ruajtjes së punësimit si dhe zbutjes së ndikimit negativ të pandemisë në të ardhurat e familjes.

## ► 3.1. Dimensioni i masave fiskale

Siç paraqitet edhe në Tabelën 3.1, sipas vlerësimit të FMN-së, në gjysmën e parë të vitit 2020 qeveritë e vendeve të ndryshme në mbarë botën shpenzuan 5.9 përqind të PBB-së për financimin e masave në përgjigje të COVID-19. Pjesa më e madhe e këtij shpenzimi shtesë synonte ndërmarrjet dhe familjet jashtë sektorit të shëndetësisë. Përveç kësaj, edhe shpenzimet e përshpejtuara dhe të ardhurat e shtyra arritën në masën 1.0 përqind të PBB-së. Këto masa fiskale rrisin drejtpërdrejt defiçitet e qeverisë dhe borxhin publik.

Për më tepër, në nivel global qeveritë e vendeve të ndryshme krijuan edhe një 6.0 përqind tjetër të PBB-së me detyrime, shumica e tyre kontingjente, në formën e injektimit të kapitalit, kredive, si dhe garancive të ndryshme për ndërmarrjet ose operacionet e tjera quasi-fiskale. Në periudhën afatshkurtër, këto masa nuk ndikojnë tek defiçitet, por në planin afatgjatë disa prej tyre e rrisin borxhin në mënyrë të menjëhershme dhe ulin vlerën neto.

Shkalla e ndërhyrjeve fiskale ndryshon nga vendi në vend. Në vendet me të ardhura të larta në Evropën Perëndimore, shpenzimet shtesë direkte shkonin nga rreth 5 përqind të PBB-së (Franca dhe Italia) në 9.2 përqind të PBB-së (MB), kryesisht të shënjestruara për sektorin jo shëndetësor. Shtetet e reja anëtare të BE-së shpenzuan më pak se vendet me të ardhura të larta. Shpenzimet fiskale shtesë variojnë nga 2.2 përqind (Rumania) në 7.9 përqind (Sllovenia).

Ndër vendet në shqyrtim, masat fiskale u përqendruan kryesisht tek shpenzimet shtesë direkte për ndërmarrjet dhe familjet. Sa i përket PBB-së, Mali i Zi i rriti shpenzimet fiskale me 8.0 përqind (2.3 përqind shtesë e të ardhurave të shtyra), Serbia me 5.6 përqind (plus 2.8 përqind e të ardhurave të shtyra), Bosnja dhe Hercegovina me 5.2 përqind, Ukraina me 3.4 përqind, Moldavia me 2.2 përqind, Maqedonia e Veriut me 2.0 përqind dhe Shqipëria me 1.2 përqind. Duhet të nënvizojmë se Moldavia, Serbia dhe Ukraina alokuan një pjesë relativisht të madhe të shpenzimeve të tyre për sistemet e nënfinancuara të kujdesit shëndetësor. Sipas të dhënave në dispozicion, shkalla e mbështetjes së likuiditetit ishte 1.7 përqind në Shqipëri, 1.5 përqind në Maqedoni, 1.4 përqind në Serbi dhe 0.4 përqind në Moldavi. Një informacion i

hollësishëm në lidhje me masën fiskale të zbatuar në vendet e përzgjedhura gjendet në Aneksin bashkëngjitur këtij raporti.

► **Tabela 3.1. Masat fiskale në lidhje me COVID-19 gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 në vendet e përzgjedhura (% e PBB)**

	Shpenzimet shtesë ose të ardhurat e humbura / të përealizuara (A)			Shpenzime të përshpejtuara / të ardhura të shtyra (B) Injeksione të kapitalit, hua, blerje asetesh ose supozimet për borxhin	Mbështetja e likuiditetit (C)				Totali A + B + C (totali i të dhënave në dispozicion)
	Nën-totali	Sektori shëndetësor	Nën-totali Sektori jo shëndetësor		Sub-total	Detyrimet kontigjente	Contingent liabilities		
							Garancitë	Operacione quasi-fiskale	
<b>Vendet e përzgjedhura të G20</b>									
Franca	5.2	0.6	4.6	2.5	15.7	0.9	14.8	n.a.	10.7
Gjermania	8.3	0.7	7.7	n.a.	30.8	6.0	24.8	n.a.	23.5
Italia	4.9	0.4	4.5	0.4	33.0	0.2	32.8	n.a.	39.2
Japonia	11.3	1.0	10.3	4.9	23.7	n.a.	3.0	20.7	38.4
Mbretëria e Bashkuar	9.2	1.5	7.6	0.2	16.6	0.0	16.5	n.a.	39.9
Shtetet e Bashkuara	11.8	1.5	10.3	0.1	2.5	0.3	2.2	n.a.	25.9
<b>Vendet e reja anëtare të BE-së të përzgjedhura</b>									
Çekia	4.4	1.0	3.3	0.7	15.5	0.0	15.4	n.a.	20.5
Slovacia	2.5	0.2	2.3	1.4	4.5	0.0	4.5	n.a.	8.3
Slovenia	7.9	0.2	7.7	n.a.	6.6	1.3	5.1	0.2	14.6
Bullgaria	2.7	0.7	2.0	0.5	4.0	1.4	n.a.	2.6	7.2
Kroacia	5.2	0.1	5.0	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	5.2
Hungaria	4.1	1.2	2.9	n.a.	4.4	n.a.	4.4	n.a.	8.5
Polonia	6.7	0.4	6.3	n.a.	5.0	1.8	3.3	n.a.	11.7
Rumania	2.2	1.1	1.0	n.a.	3.2	0.2	3.0	n.a.	5.4
<b>Vendet nën shqyrtim</b>									
Shqipëria	1.2	0.2	1.1	n.a.	1.7	n.a.	1.7	n.a.	2.9
Bosnja dhe Hercegovina	5.2	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	5.2
Moldavia	2.2	1.2	1.1	n.a.	0.4	0.3	0.0	n.a.	2.6
Mali i Zi	8.0	0.4	7.6	2.3	0.0	n.a.	0.0	n.a.	10.3
Maqedonia e Veriut	2.0	0.1	2.0	n.a.	1.5	n.a.	n.a.	1.5	3.5



Serbia	5.6	1.3	4.3	2.8	1.4	n.a	1.0	0.4	9.8
Ukraina	3.4	0.9	2.5	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	3.4
<b>Vlerësimi global</b>									
Në nivel global	5.9	0.6	5.1	1.0	6.0	0.5	4.1	1.4	12.9

Burimi: FMN. Databaza e Monitorit Fiskal të Masave Fiskale të Vendeve në Përgjigje të Pandemisë COVID-19. FMN (2020b)

Siç paraqitet në Tabelën 3.1 bis, është vlerësuar se, për masat fiskale në përgjigje të COVID-19, është alokuar 14.6 përqind e PBB-së globale, përfshirë shpenzimet shtesë dhe detyrimet e mundshme të përlogaritura në format e injektimit të kapitalit, huave, si dhe garancive të ndryshme për ndërmarrjet ose të tjerët. Shkalla dhe përparësitë e ndërhyrjeve fiskale ndryshojnë shumë nga njëri vend në tjetrin. Masat fiskale të vendeve me të ardhura të larta të G7 janë në përgjithësi më shumë se 20 përqind. Shtetet e reja anëtare të BE-së shpenzuan më pak se vendet me të ardhura të larta. Masat fiskale të vendeve në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Azinë Qendrore ishin përgjithësisht më të ulëta se nivelet e këtyre masave në vendet me të ardhura të larta ose në vendet e reja anëtare të BE-së. Ata u përqendruan kryesisht tek shpenzimet shtesë direkte për ndërmarrjet dhe familjet, por disa vende (p.sh. Moldavia, Serbia, Ukraina dhe Taxhikistani) alokuan një pjesë relativisht të madhe të shpenzimeve për sistemet e nënfinancuara të kujdesit shëndetësor.

► **Tabela 3.1 bis Masat fiskale në lidhje me COVID-19 gjatë vitit 2020 në vendet e përzgjedhura (% e PBB)**

	Shpenzimet shtesë ose të ardhurat e humbura/ të përcaktuara (A)			Shpenzime të përshpejtuara / të ardhura të shtyra (B) Injeksi- one të kapitalit, hua, blerje asetesh ose supozimet për borxhin	Mbështetja e likuiditetit (C)				Totali A + B + C (totali i të dhënave në dispozicion)
	Nëntotali	Sektori shëndetësor	Sektori jo shëndetësor		Detyrimet kontigjente		Garancitë	Operacionet quasi-fiskale	
<b>G7 dhe BE</b>									
Kanadaja	14.6	2.4	12.3	3.9	4.0	0.2	3.8		22.5
Franca	7.7	0.8	6.9	2.4	15.8	0.9	14.8		25.9
Gjermania	11.0	1.2	9.8		27.8	3.0	24.8		38.9
Italia	6.8	0.6	6.2	0.4	35.5	0.2	35.3		42.7
Japonia	15.6	1.8	13.8	4.8	28.4		2.9	25.5	48.9
Mbretëria e Bashkuar	16.3	5.3	10.9	0.3	16.1	0.0	16.1		32.7
Shtetet e Bashkuara	16.7	2.3	14.4	0.1	2.4	0.3	2.2		19.2
<b>Shtetet e reja anëtare të BE-së</b>									
Kroacia	2.6	0.3	2.3		2.9	1.3	1.6		5.5

<b>Republika Çeke</b>	5.4	1.2	4.3	0.6	15.5	0.0	15.5		21.6
<b>Estonia</b>	3.5	0.9	2.6		4.3	3.2	1.1		7.8
<b>Hungaria</b>	4.0	1.2	2.8		4.4		4.4		8.4
<b>Letonia</b>	7.9	0.7	7.2	0.0	3.0	0.7	2.3	0.0	10.9
<b>Lituania</b>	4.7	1.0	3.7	4.5	3.5	0.7	2.9		12.7
<b>Polonia</b>	7.7	0.4	7.3		5.4	2.2	3.2		13.1
<b>Rumania</b>	2.3	1.2	1.0		3.2	0.2	3.0		5.5
<b>Republika Sllovaqe</b>	3.8	0.1	3.6	0.5	4.4	0.0	4.4		8.8
<b>Sllovenia</b>	5.3	0.9	4.5	0.3	6.6	1.9	4.7		12.2
<b>Evropa Qendrore dhe Lindore</b>									
<b>Shqipëria</b>	1.2	0.2	0.9		1.7		1.7		2.9
<b>Bosnja dhe Hercegovina</b>	5.1								5.1
<b>Moldavia</b>	2.2	1.2	1.1		0.4	0.3	0.0		2.6
<b>Republika e Malit të Zi</b>	8.0	0.5	7.6	2.3			0.0		10.3
<b>Maqedonia e Veriut</b>	2.9	0.1	2.8		2.9			2.9	5.8
<b>Serbia</b>	5.6	1.3	4.3	2.8	1.4		1.0	0.4	9.8
<b>Ukraina</b>	3.4	0.9	2.5						3.4
<b>Evropa Lindore dhe Azia Qendrore</b>									
<b>Armenia</b>	1.0	0.3	0.7	0.0	1.1	1.1	0.0	0.0	2.0
<b>Azerbajxhani</b>	2.2	0.5	1.6		3.4	2.7	0.7	0.0	5.6
<b>Kazakistani</b>	2.4				3.1	1.9		1.2	5.5
<b>Republika e Kirgistanit</b>	6.1	0.3	5.8						6.1
<b>Rusia</b>	2.9	0.6	2.3	0.4	1.5	0.5	0.5	0.5	4.9
<b>Taxhikistani</b>	3.0	1.9	1.1		0.5	0.5			3.5
<b>Uzbekistani</b>	3.7	0.8	3.0		2.4	2.4			6.1
<b>Në nivel global</b>	<b>7.4</b>	<b>1.0</b>	<b>6.4</b>	<b>1.0</b>	<b>6.1</b>	<b>0.4</b>	<b>4.0</b>	<b>1.6</b>	<b>14.6</b>

**Burimet:** Vlerësimet e stafit të autoriteteve kombëtare dhe FMN-së.

**Shënime:** Vlerësimet deri në fund të muajit dhjetor, 2020. Zbatimi i masave mund të shtrihet përgjatë vitit 2020, 2021, ose më gjerë. Shifrat e shprehura në dollarë amerikanë dhe përqindja e PBB-së bazohen në Raportin e Përditësuar të Perspektivës Ekonomike Botërore të muajit janar 2021, përveç nëse thuhet ndryshe.

Vlerësimi global i mbështetjes fiskale përfshin shpenzimet shtesë dhe të ardhurat e humbura, si dhe detyrimet kontingjente nga garancitë dhe operacionet quasi-fiskale.

## ► 3.2. Vlerësimi paraprak i ndikimit të masave të ndërmarra në përgjigje të situatës

Ende nuk kemi një tablo të plotë të efektit të masave stimuluese të mësipërme në drejtim të ruajtjes së punësimit, mbrojtjes së të ardhurave dhe rimëkëmbjes ekonomike në të ardhmen. Më poshtë gjeni një analizë paraprake të kësaj situatë bazuar në informacionin dhe raportet e vëna në dispozicion nga ekspertët kombëtarë të secilit prej vendeve nën shqyrtim.

### Tregu i punës dhe të ardhurat e krahut të punës

Ndër të shtatë vendet në shqyrtim, Serbia ka miratuar paketën ekonomike më bujare dhe më gjithëpërfshirëse, që përfshin edhe sigurimin e mbështetjes universale në para. Anketa e ndërmarrjeve në Serbi tregon se në përgjithësi bizneset kanë arritur të mbajnë nivelin e largimit nga puna të punëtorëve nën 9 përqind me anën e ndihmës së ofruar nga qeveria, që kapte vlerën e rreth 65 përqind të kostove totale të krahut të punës për punëtorët bazuar në pagën minimale. Vlerësimi i shpejtë i ILO-s ka konstatuar se masat për ruajtjen e punësimit e kanë ulur shkallën e varfërisë me 1.2 pikë përqindje në të gjitha grupet, por kanë ngushtuar vetëm gjysmën e hendekut midis nivelit të varfërisë para dhe pas krizës. Megjithëse këto masa shpëtuan shumë vende pune, ato nuk arritën të mbronin ata persona që ishin në marrëdhënie pune informale, të përkohshme ose me kontratë shërbimi. Kur merret parasysh pagesa universale e njëhershme në para, masat e kombinuara ulin nivelin e varfërisë relative në 22.9 përqind, vlerë kjo në nivelin e varfërisë para krizës.

Në Maqedoninë e Veriut, masat kryesore për ruajtjen e punësimit të ndërmarra nga qeveria erdhën në kohën e duhur, por intensiteti i mbështetjes mund të jetë tejte i ulët për të arritur ndikimet e dëshiruara. Megjithëse masat për ruajtjen e punësimit duken bujare në segmentet më të populluara të shpërndarjes së pagave, intensiteti i tyre bie në mënyrë të ndjeshme gjatë katër muajve të programit. Në Maqedoninë e Veriut, pagesa e papunësisë është mbrojtja e vetme sistemike për ata persona që kanë humbur të ardhurat nga puna, por mbeten të pakualifikueshëm për përfitimin e ndihmës sociale në para (të ardhura minimale të garantuara). Sidoqoftë, mbizotërimi i lartë i informalitetit në tregun e punës e ka zvogëluar rolin e saj mbrojtës. Shumica e punonjësve që kanë humbur punën gjatë kësaj krize janë të angazhuar në forma jo standarde të punësimit ose të punësuar në mënyrë informale, me pak ose aspak qasje tek pagesat e papunësisë.

Siç u përmend më herët, masat në lidhje me sigurimet shoqërore dhe subvencionimin e pagave kanë shërbyer si nxitje për punonjësit që kanë humbur punën për t'u regjistruar pranë shërbimeve publike të punësimit dhe për punëdhënësit për të regjistruar më shumë punonjës si të punësuar formalë. Kjo tregon se edhe paketat stimuluese - nëse janë të mirë-ideuara - mund të kontribuojnë (të paktën përkohësisht) në formalizimin e ekonomisë informale.

Monitorimi i fundit i ILO-s paraqet vlerat e përlogaritura të stimulit fiskal gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2020. Siç tregohet në Tabelën 3.2, vlerat e stimulit fiskal janë të barasvlershme me 4.0 përqind të të ardhurave të krahut të punës në nivel global, gjë që tregon se pa masat stimuluese humbja e të ardhurave të krahut të punës do të kishte qenë 38 përqind më e lartë sesa ajo aktuale. Nga ana tjetër, vlera e stimulit është e barasvlershme me 37 përqind të orëve të humbura të punës. Ndikimi i masave stimuluese duket se ka qenë shumë më i madh në Evropë dhe në rajonin e Azisë Qendrore, veçanërisht në nënrajonin e Evropës Lindore. Stimuli fiskal në nënrajonin e Evropës Jugore duket më i ulët se mesatarja botërore, por kjo ka ardhur më shumë për shkak të numrit më të lartë të orëve të humbura të punës.

► Tabela 3.2. Vlera e stimullit fiskal sipas rajoneve, tre tremujorët e parë të vitit 2020

	Orët e humbura të punës (%)	Humbja e të ardhurave të krahut të punës	Vlera e stimullit fiskal	
		(% e të ardhurave të krahut të punës)	(% e të ardhurave të krahut të punës)	(% e orëve të humbura)
<b>Bota</b>	11.7	10.7	4.0	37.0
<b>Evropa dhe Azia Qendrore</b>	11.1	10.6	5.0	47.0
<b>Evropa Jugore</b>	15.7	n.a.	n.a.	23.0
<b>Evropa Lindore</b>	8.2	8.0	4.3	54.0

Burimi: Monitorimi i ILO-s. ILO (2020a).

## Të ardhurat familjare

Tabela 3.3 tregon ndryshimin në të ardhurat e familjeve nga të dhënat e llogarisë kombëtare në tremujorin e dytë të vitit 2020. Rëniet në konsumin përfundimtar të familjeve ishin më të vogla sesa rëniet e PBB-së në të gjitha vendet, përveç Bosnjës dhe Hercegovinës. Kjo pasqyron pjesërisht ndryshimet në sjelljen e familjeve sa i takon shpenzimeve, por edhe ndikimin e përpjekjeve të qeverisë për të zbutur efektet negative të masave izoluese tek të ardhurat e familjeve. Vendet të cilat kanë zbatuar masat stimuluuese dhe masat lidhur me shëndetin publik në shkallë relativisht të gjerë, si Serbia dhe Maqedonia e Veriut, shfaqin rritje të konsiderueshme të konsumit përfundimtar të qeverisë.

► Tabela 3.3. Ndryshimet në PBB dhe konsumimet në tremujorin e dytë të vitit 2020

	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina		Moldavia	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia	Ukraina
		FB&H	RS					
<b>PBB</b>	-10.2	-9.3	-6.9	-11.0	-20.2	-12.7	-6.4	-11.4
<b>Konsumi përfundimtar i familjes</b>	-7.6	-9.4	n.a.	-9.7	-14.9	-11.6	-7.9	-10.4
<b>Konsumi përfundimtar i qeverisë</b>	-0.7	+0.5	n.a.	n.a.	-3.0	+1.5	+8.9	-1.7

Burimi: Zyrat Kombëtare të Statistikave.

Shënime: % ndryshim krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, e rregulluar sezonalisht aty ku është e mundur. FB&H = Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, RS = Republika Srpska.

Tabela 3.4 paraqet disa të dhëna nga Anketa për të Ardhurat dhe Shpenzimet e Familjeve e zhvilluar në Ukrainë në tremujorin e dytë të vitit 2020. Në Ukrainë, të ardhurat totale të familjeve ranë me 4,5%. Të ardhurat nga pagat ranë me 10,5%, por kjo u kompensua pjesërisht nga rritja e pagesave sociale me 5,4%, ku në veçanti transfertat sociale të parave u rritën me 14,6% për qind. Sa i takon shpenzimeve, familjet shpenzuan 7,8% më pak për mallra dhe shërbime. Si kursime paraprake për shkak të pasigurisë për të ardhmen, familjet vendosën mënjani 81,5% më shumë në formën e depozitave dhe 56,6% më shumë si kursime në valutë të huaj. Ulja e kontributeve shoqërore me 17,4% dhe e tatimit mbi të ardhurat me 4,6% mund të ketë ardhur si rezultat i masave për subvencionimin dhe shtyrjen e tyre. Të ardhurat e mbetura pas zbritjes së tatimit ranë me 5,3% për qind. Modele të ngjashme të ndryshimit të të ardhurave dhe sjelljes së konsumatorit vërehen edhe në vendet e tjera evropiane.

► **Tabela 3.4. Të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve në tremujorin e dytë të vitit 2020, Ukrainë**

	TM 2, 2019 = 100
<b>Të ardhurat totale</b>	<b>95.5</b>
Pagat dhe mëditjet	89.5
Fitimet dhe të ardhurat e përziera	92.7
Të ardhurat nga prona	100.5
Përfitimet shoqërore, nga të cilat:	105.4
Transfertat sociale në para	114.6
Transferta të tjera rrjedhëse në para	98.9
Transfertat sociale në natyrë	96.3
<b>Shpenzimet dhe kursimet</b>	<b>95.5</b>
Mallrat dhe shërbimet	92.2
Pagesa e qirave, kredive etj.	108.9
Taksat dhe të ngjashme me to, prej të cilave:	99.8
Taksa mbi të ardhurat	95.4
Kontributet sociale	82.6
Të tjera	119.5
Rritja e depozitave	181.5
Kursimet në valutë të huaj	156.6
<b>Shpenzimet</b>	<b>93.1</b>
<b>Të ardhurat e disponueshme</b>	<b>94.7</b>

**Burimi:** Shërbimi Shtetëror i Statistikave në Ukrainë. <https://ukrstat.org/uk/express/expr2020/09/122.pdf>.

Të gjitha vendet në rajon janë vende të origjinës së migrantëve, që kanë lëvizur kryesisht drejt vendeve evropiane me të ardhura më të larta. Siç tregohet në Tabelën 3.5, remitancat e dërguara nga punëtorët migrantë në marrëdhënie pune përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave të familjeve në rajon, ndoshta në një masë relativisht më të vogël për Maqedoninë e Veriut.

► **Tabela 3.5. Remitancat si përqindje e PBB-së, 2019**

	Remitancat (% e PBB-së)
Shqipëria	9.4
Bosnja dhe Hercegovina	10.9
Moldavia	16.3
Mali i Zi	25.4
Maqedonia e Veriut	2.5
Serbia	8.1
Ukraina	10.5

**Burimi:** Banka Botërore. Portali i Migracionit: <https://migrationdataportal.org/themes/remittances#key-trends>.

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, remitancat në Evropë dhe në rajonin e Azisë Qendrore vlerësohet që do të bien me rreth 28 përqind në vitin 2020 për shkak të efektit të kombinuar të pandemisë globale të

koronavirusit dhe çmimeve të ulëta të naftës.<sup>16</sup> Kjo nënkupton që humbja e të ardhurave të familjes për shkak të remitancave të reduktuara mund të variojë nga 3 deri në 7 përqind të PBB-së.

### ► 3.3. Vlerësimi paraprak i politikave

Bazuar në rezultatet e vlerësimit paraprak të impaktit, ne analizojmë efektivitetin e masave politike për të ofruar alternativa për marrjen e vendimeve të informuara në lidhje me zgjedhjen dhe prioritizimin e politikave.

#### Subvencionimi ose shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore

Normat e kontributeve të sigurimeve shoqërore në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore janë përgjithësisht më shumë se 20 përqind, dhe të ardhurat vjetore nga kontributet variojnë nga 5 deri në 10 përqind të PBB-së. Kështu, edhe pse Shtetet i subvencionojnë kontributet minimale për punëtorët e prekur nga kjo situatë, ndikimi i lehtësimit të detyrimit për të paguar kontributet nga ana e punëdhënësve mund të jetë i rëndësishëm. Siç tregohet në Tabelën 3.1, të ardhurat e shtyra dhe shpenzimet e përshpejtuara arritën 2.3 përqind të PBB-së në Mal të Zi dhe 2.8 përqind të PBB-së në Serbi, një pjesë e madhe e të cilave ishte për shkak të kontributeve të shtyra të sigurimeve shoqërore, si dhe tatimit mbi të ardhurat e korporatave.

Megjithëse reduktimi i përkohshëm i kontributeve të sigurimeve shoqërore e plotësonte nevojën e menjëhershme të ndërmarrjeve për likuiditet për të vazhduar biznesin e tyre dhe për të mbajtur punonjësit, kjo masë ndikoi drejtpërdrejt në financimin e skemave të sigurimeve shoqërore. Vini re se vendet në Evropën Qendrore dhe Lindore nuk kanë rezerva të konsiderueshme në fondet e tyre të sigurimeve shoqërore,<sup>17</sup> përkundrazi ato (zakonisht fondet e pensioneve) janë me defiçit në shumicën e vendeve. Kështu këto kosto do të zhvendosen tek defiçitet buxhetore. Ndikimi financiar afatgjatë i detyrimeve shtesë të shoqëruara me këtë masë duhet të vlerësohet në mënyrën e duhur dhe masat e ardhshme për rikuperimin e koston duhet të dakordohen përmes dialogut konstruktiv social.<sup>18</sup>

#### Subvencionimi i pagave

Të paktën 40 vende në mbarë botën kanë filluar të zbatojnë masën për subvencionimin e përkohshëm të pagave. Subvencionimi i përkohshëm i pagave ka për qëllim të parandalojë pushimet në masë nga puna, të ndihmojë ndërmarrjet për të mbajtur punëtorët e kualifikuar dhe të mbështesë rikuperimin e prodhimit menjëherë pas përfundimit të periudhës së izolimit. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj mase shtetet në fjalë synuan të garantonin që punëtorët të vazhdonin të merrnin të paktën një pjesë të pagave të tyre të zakonshme, edhe pse disa punëtorë u përballën me reduktimin e pagave. Përvoja ka treguar që, ndërkohë që subvencionimi i pagave ul papunësinë duke i mbajtur të punësuarit të lidhur me punëdhënësit e tyre të hershëm, në planin afatgjatë ai mund të ngadalësojë ndryshimet e nevojshme strukturore për t'iu përgjigjur kërkesës së re dhe për të përshtatur modalitetet e punës.

<sup>16</sup> Shih Ratha et al. (2020).

<sup>17</sup> Disa shtete kanë filluar të zbatojnë skemën e pensioneve të financuara në mënyrë të detyrueshme (e ashtuquajtura shtylla e dytë). Megjithëse këto skema janë jashtë fushës së këtij raporti, analizimi i ndikimit të pandemisë në performancën e këtyre skemave është po aq me interes.

<sup>18</sup> Në kontekstin e krizës globale financiare dhe ekonomike në vitin 2009, Komiteti i Ekspertëve të ILO-s për Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve tërhoqi vëmendjen ndaj «tendencës për të promovuar masat aktive të tregut të punës dhe zhvillimin e ndërmarrjeve me riskun e minimi të qëndrueshmërisë së financave të sigurimeve shoqërore duke dhënë stimuj për ndërmarrjet në formën e reduktimit ose përjashtimit nga kontributet e sigurimeve shoqërore» dhe vërejtje se duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje vlerësimit të ndikimit të masave për të promovuar politikat aktive të tregut të punës duke përdorur burimet e skemave të sigurimeve shoqërore. Shih ILO (2011).

Subvencionimi i pagave është një masë e zbatuar nga të shtatë vendet në shqyrtim. Kryesisht për shkak të kufizimeve fiskale, kjo ndodhi nga muaji mars deri në muajin maj të vitit 2020 dhe shuma ishte fiksuar në nivelin e pagës minimale, pavarësisht nga paga e mëparshme e individëve. Raportet kombëtare tregojnë se këto masa kanë rezultuar relativisht të suksesshme në parandalimin e rritjeve të papunësisë dhe kompensimin e rreth 25-50 përqind të të ardhurave të humbura të krahut të punës gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Nëse vazhdon pandemia dhe nëse situata në tregun e punës nuk do të përmirësohet, atëherë mund të lindë përsëri nevoja për të tilla subvencionime të përkohshme të pagave. Situata kërkon një monitorim nga afër për tremujorët e tretë dhe të katërt të vitit 2020 dhe më gjërë.

## Mbështetja me të ardhura sipas pagesave afatshkurtra

Gjatë fazës së parë të pandemisë, sigurimet shoqërore kanë luajtur një rol të rëndësishëm për zbutjen e të ardhurave të reduktuara ose të humbura dhe mbrojtjen e grupeve më të cënueshme për të përmbytur nevojat e tyre të menjëhershme monetare dhe materiale.

Ofrimi i pagesës në rast sëmundjeje/ për arsye shëndetësore për punonjësit që nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të mbylljes së biznesit ose për shkak të karantinës së detyrueshme nuk është ndjekur plotësisht nga vendet e shqyrtuara. Në të gjitha vendet, punëdhënësit janë përgjegjës për pagesën e disa prej ditëve të para të pushimit për arsye shëndetësore të punonjësit. Ndoshta, ky rregull mund të jetë edhe arsyeja përse pagesat në rast sëmundjeje u mbuluan nga subvencionet e pagave. Në Kroaci dhe Slloveni punonjësit të cilët nuk u paraqitën në punë për arsye shëndetësore kanë marrë kompensimin e pagës që nga dita e parë (rregulli është që punëdhënësit të paguajnë për 30 ditët e para).

Në kohë recesioni, pagesat e papunësisë luajnë një rol jetësor për të siguruar mbështetje me të ardhura për punëtorët që kanë dalë të papunë pa dëshirën e tyre. Pandemia forcoi nevojën e kahershme për të zgjeruar mbulimin me pagesën e papunësisë dhe për të rritur nivelin e përfitimit të saj. Të shtatë vendet nën shqyrtim kanë rritur ndjeshëm pagesat e papunësisë dhe kanë mbuluar më shumë kategori të punonjësve.

Gjatë krizës aktuale, incidenca e papunësisë së pjesshme si rezultat i orëve të reduktuara të punës ose lejeve të pavullnetshme të papaguara ka qenë e lartë. Sidoqoftë, pagesat e papunësisë në shumicën e vendeve përfitojnë vetëm në rastin e papunësisë së plotë, e cila bëri që disa prej vendeve të zgjeronin kriteret e pranueshmërisë për pagesën e papunësisë. Edhe pagesat për arsye shëndetësore nuk përdoren në shkallë të gjerë. Kjo tregon që përqendrimi i ngushtë tek papunësia nuk i përmbush nevojat e reja të tregut të punës. Po ashtu, ky fakt nxjerr në dritë edhe nevojën për shtrirjen e pagesave ekzistuese të papunësisë edhe tek rastet e papunësisë së pjesshme për të kompensuar të paktën pjesërisht humbjet e të ardhurave të punonjësve të cilëve iu janë reduktuar orët e punës pa dëshirën e tyre, pavarësisht nga llojet e kontratave të punës.

Dispozitat ekzistuese në ligjin e punës ose në ligjin e sigurimeve shoqërore në lidhje me marrjen e lejes për t'iu përkushtuar kujdesit ndaj fëmijëve nuk janë të mjaftueshme për rastet kur shkollat dhe institucionet e kujdesit për fëmijët janë të mbyllura për muaj të tërë. Prandaj, lind nevoja për përmirësimin e një dispozite të tillë, e cila do t'i lejonte prindërit të qëndronin në shtëpi dhe të kujdeseshin për fëmijët e tyre në kohë pandemie dhe izolimi.

## Popullsia e pambrojtur në mënyrë të mjaftueshme nga përfitimet ekzistuese të sigurimeve shoqërore

Megjithëse sistemet ekzistuese të sigurimeve shoqërore kanë reaguar mirë për të mbrojtur anëtarët e tyre kontribues, kryesisht punonjësit e rregullt me kohë të plotë në punësim formal dhe të vetëpunësuar, ata nuk rezultuan kaq të suksesshme për një numër në rritje të punonjësve të cilët ishin të përjashtuar ose të mbuluar në mënyrë të pamjaftueshme nga sistemet ekzistuese kontributive të sigurimeve shoqërore. Grupet e punonjësve që nuk mbrohen në mënyrë të mjaftueshme nga sistemet ekzistuese

të sigurimeve shoqërore përfshijnë punonjësit në ekonominë informale dhe punonjësit në forma jo-standarde të punësimit, përfshirë personat e angazhuar në ekonominë e platformave. Në fakt, këta punonjës ishin ndër më të goditurit nga kriza. Disa prej vendeve e shtrinë qasjen tek kujdesi shëndetësor dhe tek e drejta për përfitimin e mbështetjes me të ardhura (pagesat për arsye shëndetësore, pagesat e papunësisë, ndihma sociale) edhe tek ato grupe që nuk ishin mbuluar më parë nga këto shërbime. Sidoqoftë, një mbështetje e tillë synonte grupet e prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë (përveç rastit të pagesës universale në Serbi) dhe përfitimi ishte i një natyre të përkohshme ose vetëm mbështetje e njëhershme me të ardhura. Këto kufizime të sistemeve kontributive mund të çojnë në nevojën për masa të jashtëzakonshme (të kufizuara në kohë) solidariteti të natyrës universale, të organizuara nga Shteti, për të mbështetur jetesën bazë të të gjithë popullsisë në nevojë gjatë gjithë kësaj periudhe të vështirë.

Përveç kësaj, fakti që të gjitha vendet zbatuan masa që kishin të bënin me rritjen e përfitimeve ligjore (pagesat e papunësisë, pagesat për arsye shëndetësore, ndihmën sociale dhe pensionet) dhe ofrimin e pagesave shtesë të përkohshme ose të njëhershme të paktën për grupet e veçanta na bën të kuptojmë që edhe vendet vetë i shohin këto nivele përfitimesh si jo të mjaftueshme dhe të lëvuara vetëm për një periudhë të kufizuar kohe.

Një grup tjetër i prekur nga e gjithë kjo situatë janë punëtorët migrantë. Kjo përfshin punëtorët migrantë të riatdhesuar që kthehen si rezultat i masave izoluese në vendet e destinacionit. Shumë prej tyre e humbën të drejtën që gëzonin për përfitimin e sigurimeve shoqërore gjatë punës jashtë vendit. Pandemia goditi një hendek kritik në mekanizmin ekzistues të koordinimit të sigurimeve shoqërore. Shumica e marrëveshjeve ekzistuese për sigurimet shoqërore nuk lejojnë eksportimin e pagesave të papunësisë për shkak të vështirësive sa i takon verifikimit të kërkesave që kanë të bëjnë me punëkërkimin në një vend tjetër. Për pasojë, punëtorët migrantë që u rikthyen në shtëpitë e tyre për shkak të masave izoluese nuk arritën të merrnin pagesat e papunësisë edhe pse janë të parashikuara në marrëveshjet për sigurimet shoqërore dhe kanë kontribuar në skemat e sigurimit të papunësisë në vendet e destinacionit. Një alternativë e mundshme që duhet të merret në konsideratë për të shmangur këtë padrejtësi është pagesa e një shume fikse - për shembull, një shumë e bazuar në kohëzgjatjen e periudhës së sigurimit - për një punëtor migrant që largohet nga një vend i caktuar përgjithmonë pasi mbetet i papunë.

Ndër grupet e tjera të përjashtuara duhet të përmendet edhe popullata rome që zakonisht janë të përjashtuar nga qasja tek kujdesi shëndetësor dhe shërbimet sociale në shumicën e vendeve në rajon.<sup>19</sup>

## Mbështetja shtesë me të ardhura për pensionistët

Në përgjithësi, pensionistët si përfitues të të ardhurave të vazhdueshme duhet të jenë relativisht të imunituar ndaj efekteve negative të izolimit - të paktën për sa kohë që përfitimet janë në një nivel adekuat dhe rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Nga ana tjetër, shumë shoqëri i shohin pensionistët si persona vulnerabël pasi pensionet janë të ardhurat e tyre të vetme në pothuajse të gjitha rastet, gjë që çoi në ofrimin e mbështetjes për pensionistët gjatë krizës. Sidoqoftë, përveç kësaj duhet theksuar se deficiëti i fondeve të pensioneve në shumicën e vendeve varion nga 1 deri në 5 përqind të PBB-së për shkak të strukturës së dobët të të ardhurave dhe strukturës së pafavorshme demografike. Duke parë këto kufizime, mbështetja për pensionet duhet të përqendrohet në mbrojtjen e pensionistëve me të ardhura të ulëta.

## Mbështetja me sigurime shoqërore për kthimin e sigurt në punë

Pandemia COVID-19 na sjell në vëmendje nevojën për të menduar për një mënyrë të re jetese dhe pune përmes forcimit të masave të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, përshtatjes së modaliteteve të punës, dhe menaxhimit të stresit dhe risqeve të tjera psikosociale.

<sup>19</sup> Në këtë raport nuk e kemi adresuar situatën e veçantë të popullatës rome gjatë krizës COVID-19, por përjashtimi i tyre nga qasja tek kujdesi shëndetësor ka ngritur shqetësime alarmante edhe vite më parë. Shih Instituti i Shoqërisë së Hapur (2007).



Megjithëse parandalimi është më mirë se kurimi ose kompensimi, ky i fundit është një mjet po aq i rëndësishëm për të ofruar siguri në rast infektimi në vendin e punës ose gjatë udhëtimit nga shtëpia në punë apo anasjelltas pasi mundësia e infektimit është duke u rritur dhe dëmtimi mund të jetë serioz ose edhe fatal. Mbulimi i sëmundshmërisë për shkak të COVID-19 nga kompensimi i punonjësve është një masë e rëndësishme jo vetëm për punonjësit thelbësorë, përfshirë punonjësit e kujdesit shëndetësor, por edhe për të gjitha kategoritë e tjera të punonjësve.

Për ta përmbyllur këtë pjesë, Tabela vijuese 3.6 paraqet masat kryesore të ndërmarra në lidhje me sigurimet shoqërore dhe tregun e punës sipas fazave të ndryshme të pandemisë.

► **Tabela 3.6. Reagimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe i tregut të punës në faza të ndryshme të pandemisë**

Reagimi i sigurimeve shoqërore dhe i tregut të punës	Izolimi	Rihapja graduale	Rimëkëmbja dhe më gjerë
Subvencionimi i pagave	Po, mund të parandalojë pushimet në masë nga puna dhe të ruajë fuqinë e kualifikuar punëtore.	(1) Eliminimi gradual dhe përdorimi i tij për të shënjestruar më shumë sektorët në rrezik. (2) Lidhja e qartë e tij me qëllimin për mbajtjen e punonjësve. (3) Ndërtimi i një elementi progresiv që siguron mbështetje më të madhe për punonjësit dhe firmat me nivele të ulëta page.	Zbatimi i politikave aktive të tregut të punës që mbështesin më mirë përshtatjen ndaj ndryshimeve strukturore (p.sh. rikualifikimi).
Shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore	Po, mund të ndihmojë për të përmirësuar fluksin e parave të ndërmarrjeve dhe familjeve.	Përdorimi i saj për të shënjestruar më shumë sektorët në rrezik.	Rivendosja e ekuilibrit financiar të fondeve të sigurimeve shoqërore.
Kujdesi shëndetësor	Ruajtja e qasjes tek kujdesi mjekësor (përfshirë vaksinimin) për trajtimin dhe testimin e COVID-19 gjatë gjithë pandemisë dhe përtej saj.		
Siguria dhe shëndeti në punë	Parandalimi i infeksionit në vendin e punës bazuar në vlerësimin e riskut. Promovimi i punës në distancë/ nga shtëpia (teleworking) dhe i distancimit social. Mbrojtja e shtuar për punonjësit shëndetësorë dhe punonjësit e tjerë të shërbimeve thelbësore.		Përshtatja me normalin e ri në punë.
Pagesat e papunësisë	Lehtësimi i kushteve të kualifikueshmërisë, rritja e nivelit të përfitimit dhe kohëzgjatjes.	(1) Fillimi i punës për vendosjen e kufizimeve ndaj përfitimeve të mëdha për sektorët në rrezik. (2) Përqendrimi tek grupet e cënueshme të popullsisë, si për shembull rinia. (3) Marrja e masës për zbatimin e kompensimit në rast papunësie dhe lidhja e saj me masat e aktivizimit që synojnë përshtetimin e ri-hyrjes së të papunëve ose të personave joaktivë në tregun e punës.	Krijimi i një sistemi që kombinon si pagesat e papunësisë ashtu edhe kompensimin në rast papunësie. Rritja e mbulimit për të gjitha llojet e punësimeve.

Mbështetje të tjera me të ardhura	Ofrimi i mbështetjes me të ardhura për të gjithë të prekurit gjatë gjithë periudhës së fatkeqësisë. Shtrirja e mbulimit tek grupet e reja të të varfërve dhe grupet e reja të cënueshme që nuk janë të mbuluara nga sistemet aktuale të sigurimeve shoqërore.	Krijimi dhe ruajtja e dysHEMEVE gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale, të përcaktuara si grupe të garancive themelore të sigurimeve shoqërore në nivel kombëtar, që garantojnë qasjen e të gjithë personave në nevojë tek kujdesi shëndetësor thelbësor si dhe sigurinë e të ardhurave bazë.
-----------------------------------	---	---

Burimi: Përmbledhje e stafit të ILO-s. Përshtatur pjesërisht nga Figura 1.1 e Zyrës së ILO-s për Evropën Qendrore dhe Lindore (2020a) dhe Tabela 1.3 e FMN-së (2020a).

## ► 3.4. Problemet me financimin

Kriza e shkaktuar nga COVID-19 nuk ka mbaruar ende. Sidoqoftë, masat stimuluuese dhe masat në lidhje me sigurimet shoqërore i kanë vënë në provë të vështirë buxhetet qeveritare dhe fondet e sigurimeve shoqërore. Kriza ndikoi në qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemeve të sigurimeve shoqërore, veçanërisht të sistemeve pensionale tashmë të brishta. Pa dyshim që këto masa do të çojnë në një akumulim të madh të borxhit publik për të gjitha vendet. Shih Tabelën 3.7. Në planin afatgjatë, deficieti buxhetor dhe borxhi publik i akumuluar do të përbëjnë një barrë të rëndë për brezat e ardhshëm.

► Tabela 3.7. Parashikimi i FMN-së për treguesit kryesorë fiskalë, 2019-2025

Treguesi	Vendi						
	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Moldavia	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia	Ukraina
<b>Huadhënia/ huamarrja e përgjithshme neto e qeverisë (% e PBB-së)</b>							
2019	-2.0	1.5	-1.4	-2.4	-2.0	0.0	-2.0
2020	-8.4	-5.8	-8.0	-10.4	-7.7	-8.1	-7.8
2021	-4.7	-4.4	-4.3	-4.9	-4.3	-1.6	-5.2
2022	-2.6	-2.9	-3.0	-2.7	-3.4	0.0	-3.5
2023	-2.0	-2.5	-2.6	-1.9	-3.2	-0.2	-2.4
2024	-2.0	-1.8	-2.4	-1.7	-3.1	-0.2	-2.4
2025	-2.0	-1.2	-2.4	-1.6	-3.1	-0.3	-2.4
<b>Borxhi i përgjithshëm bruto i qeverisë (% e PBB-së)</b>							
2019	67.7	32.8	28.4	79.3	40.2	52.8	50.1
2020	83.3	38.9	37.8	90.8	50.3	59.5	65.7
2021	83.2	40.4	39.2	88.1	50.5	57.0	64.3
2022	77.1	40.1	40.4	86.1	50.6	53.1	61.8
2023	74.8	40.4	40.7	84.2	50.8	50.2	58.2
2024	71.9	39.1	39.8	82.2	51.1	47.6	55.0
2025	69.1	37.3	38.9	80.2	51.5	45.0	52.1

Burimi: FMN. Perspektiva Ekonomike Botërore dhe Monitorimi Fiskal (Tetor 2020).

Aktualisht ruajtja e politikave fiskale elastike dhe mbështetëse është absolutisht e domosdoshme. Sidoqoftë, herët apo vonë qeveritë do të përballen me dilemën në lidhje me mënyrën e frenimit të defiçitit fiskal dhe mbajtjes së borxhit publik nën kontroll për të shmangur një krizë të mundshme borxhi. Në veçanti, në lidhje me mënyrën e financimit të pagesave të sigurimeve shoqërore në kushtet e përballjes me defiçitin fiskal dhe borxhin e madh publik.

Megjithëse qëllimi i këtij raporti nuk ka të bëjë me thëllimin e debatit në lidhje me masat rigorozë dhe shtrënguese, gjithsesi ne po iu paraqesim vetëm dy vëzhgime të dala nga vlerësimi i bazuar në fakte e të dhëna në lidhje me krizat e mëparshme ekonomike.

Së pari, masat e gjera shtrënguese, të cilat sollën shkurtime drastike dhe pa kriter të shpenzimeve qeveritare, në shumicën e rasteve të shpenzimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, thjesht i kanë bërë recesionet më të thella dhe më të gjata. Nga ana tjetër, vendet që rritën shpenzimet qeveritare arritën të kenë rimëkëmbje më të shpejtë ekonomike dhe të stabilizojnë defiçitin fiskal si dhe borxhin publik.

Së dyti, shumë studime tregojnë se investimet në shëndetësi, arsim dhe sigurime shoqërore kanë koeficientë fiskalë shumë më të lartë se 1 (një) në vende dhe kohë të ndryshme. Domethënë, çdo 1 \$ i shpenzimeve të qeverisë krijon më shumë se 1 \$ kthim në prodhimin ekonomik. Kështu, investimi në sistemet e sigurimeve shoqërore do të kontribuojë në rritjen ekonomike në planin afatgjatë.

Këto gjetje flasin shumë për faktin se siguri shoqëror është thelbësor për rimëkëmbjen ekonomike dhe se vendet që investojnë më shumë në sistemet e sigurimeve shoqërore janë më rezilientë ndaj goditjeve. Ky është pikërisht rasti me krizën aktuale të shkaktuar nga COVID-19.

Përkundër gjithë kësaj, historitë e përsëritura në krizat e mëparshme financiare dhe ekonomike globale nuk lënë shumë vend për optimizëm. Sfida kryesore e qeverisë është garantimi i burimeve të nevojshme për të ruajtur dhe përmirësuar kapacitetin ofrues të sistemeve të sigurimeve shoqërore gjatë krizës dhe në fazën e rimëkëmbjes. Por hapësira fiskale për ndërhyrjet aktive në tregun e punës dhe ndërhyrjet e sigurimeve shoqërore ekzistojnë në të gjitha vendet, madje edhe në vendet më të varfra. Me qëllim zgjerimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe arritjen e Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm, vendet duhet të hulumtojnë, përmes dialogut efektiv social, të gjitha alternativat e mundshme për të gjeneruar burime për investime publike për të drejtat e njeriut, vendet e punës dhe sigurimet shoqërore.<sup>20</sup>

20 Studimi i fundit i kryer nga ILO, UNICEF dhe UNWOMEN ka identifikuar tetë opsione financimi: (i) Rialokimi i shpenzimeve publike; (ii) Rritja e të ardhurave nga taksat; (iii) Zgjerimi i mbulimit me sigurime shoqërore dhe i të ardhurave kontributive; (iv) Lobimi për ndihmë dhe transferta; (v) Eliminimi i flukseve të paligjshme financiare; (vi) Përdorimi i rezervave fiskale dhe valutore; (vii) Menaxhimi i borxhit: huazimi ose ristrukturimi i borxhit ekzistues; dhe (viii) Miratimi i një kornize makroekonomike më akomoduese. Të gjitha këto mundësi mbështeten nga deklaratat e politikave të Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Shih Ortiz et. al (2017).



## 4. Përfundime - drejt një sistemi gjithëpërfshirës dhe elastik të sigurimeve shoqërore

---

Siç e kemi parë, në të shtatë vendet nën shqyrtim politikat për sigurimet shoqërore përbënin një nga pjesët thelbësore të përgjigjeve të integruara ndaj krizës COVID-19 gjatë fazës së parë të pandemisë. Sidoqoftë, kriza ka zbuluar edhe disa mangësi në sistemet ekzistuese të sigurimeve shoqërore të cilat burojnë nga çështje të qenësishme në botën aktuale të punës, veçanërisht sa i takon rritjes së punësimit të pasigurt dhe zgjerimit të pabarazisë.

Rekomandimet e mëposhtme në lidhje me politikat burojnë nga vlerësimi ynë paraprak i mënyrës së reagimit të sigurimeve shoqërore në fazën e parë të pandemisë COVID-19:

- Sigurimet shoqërore janë shtyllë kryesore kur bëhet fjalë për reagimin e integruar të politikave. Kështu që masat e sigurimeve shoqërore duhet të koordinohen ngushtë me një gamë të gjerë politikash, në veçanti me politikat për tregun e punës dhe politikat fiskale për të mbështetur mbrojtjen e punësimit dhe vazhdimësinë e biznesit.
- Sistemet e sigurimeve shoqërore duhet të garantojnë në mënyrë efektive qasjen tek kujdesi shëndetësor dhe sigurinë e të ardhurave. Qasja tek kujdesi shëndetësor duhet të garantohet për të gjithë popullsinë. Në të njëjtën kohë, për të siguruar shërbimet e nevojshme të kujdesit shëndetësor duhet të alokohen burime të mjaftueshme. Siguria e të ardhurave duhet të garantohet në të gjitha situatat që kanë të bëjnë me humbjen e të ardhurave, përfshirë orët e reduktuara të punës pa dëshirën dhe vullnetin e punonjësve, papunësinë, sëmundjen (përfshirë karantinën) dhe rritjen e përgjegjësive familjare. Siguria e të ardhurave jo vetëm që duhet të parandalojë varfërinë, por të zëvendësojë edhe të ardhurat e humbura në masën e duhur dhe të pranueshme (në varësi të një maksimumi të caktuar).
- Mbulimi me sigurime shoqërore duhet të shtrihet tek punonjësit e angazhuar në të gjitha llojet e punësimit, duke përfshirë edhe format jostandarde të punësimit duke marrë parasysh heterogjenitetin e tyre të madh dhe lëvizshmërinë e lartë të tregut të punës. Përputhshmëria dhe zbatimi duhet të përmirësohen nëpërmjet inkurajimit të formalizimit të punonjësve në ekonominë informale dhe përmirësimit të mbledhjes së kontributeve krahasuar me nënraportimin e pagave kontributive.
- Përfitimet nga programet jo kontributive duhet të integrohen në mënyrë efektive për të plotësuar mungesën e mbulimit me përfitime nga skemat kontributive. Gjithashtu, kriza nxorri në dritë edhe nevojën për të parë mundësinë e rregullimit të arkitekturës ekzistuese të sigurimeve shoqërore dhe gjetjen e një kombinimi më të përshtatshëm të sistemeve kontributive me ato jo kontributive të cilat reagojnë më mirë ndaj transformimit të vazhdueshëm të tregut të punës.<sup>21</sup>
- Garantimi i dialogut social të mirëinformuar si një mekanizëm i rëndësishëm dhe efektiv për formulimin e masave për t'iu përgjigjur krizës së shkaktuar nga COVID-19 me anën e sigurimeve shoqërore është

<sup>21</sup> Si një alternativë e mundshme, është diskutuar mundësia e futjes në përdorim të të ardhurave themelore universale të pakushtëzuara, megjithëse ka ende shumë pyetje të hapura në lidhje me pranueshmërinë dhe realizueshmërinë e tyre. Shih Ortiz et. al (2018).

i rëndësishëm. Dakordimi dhe mbështetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme për pandeminë mund të arrihet vetëm nëse ekziston konsensusi shoqëror në mbarë vendin bazuar në perceptimin e plotë të implikimeve të masave dhe përmes angazhimit të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve përkatës.

Lufta globale kundër koronavirusit të ri COVID-19 nuk ka mbaruar ende. Ende kemi shumë paqartësi të mëdha përpara. Prandaj situata kërkon një monitorim të kujdesshëm. Ky raport mund të konsiderohet si një vlerësim paraprak i mënyrës së reagimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore për të shtatë vendet duke u fokusuar tek përfitimet në para për popullsinë në marrëdhënie pune dhe për familjet e tyre.

Kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka nxjerrë në pah rëndësinë e investimeve proaktive për të ndërtuar sisteme gjithëpërfshirëse dhe reziliente për sigurimet shoqërore që mund të përgjigjen shpejt dhe në mënyrë efektive ndaj goditjeve sa herë që ato shfaqen. Ajo gjithashtu ka evidentuar edhe rolin kritik të ndërhyrjeve të Shtetit përballë një ngjarjeje të pashembullt emergjente.

Rekomandimi i ILO-s Nr. 202 për Dyshemetë e Mbrojtjes Sociale u bën thirrje Shteteve Anëtare të ILO-s që të përcaktojnë dhe të ruajnë dyshemetë e mbrojtjes sociale si një element themelor i sistemeve të tyre kombëtare të sigurimeve shoqërore duke garantuar qasjen tek kujdesi shëndetësor thelbësor dhe siguria bazë e të ardhurave për të gjithë. Ai gjithashtu bën thirrje për zbatimin e dyshemeve të mbrojtjes sociale që garantojnë në mënyrë progresive nivele më të larta të sigurimeve shoqërore për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur, të udhëhequr nga Konventa për Standardet Minimale të Sigurimeve Shoqërore Nr. 102 dhe instrumentet e tjera të ILO-s për sigurimet shoqërore.

Në një kohë kur bota e punës po përballlet me një sfidë të paprecedentë, është e domosdoshme të veprohet me urgjencë për të shfrytëzuar mundësitë dhe për të ndërtuar një sistem sa më të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe mirëfunksionues për sigurimet shoqërore.

# Referencat

## Faqet e Internetit të Zyrave Kombëtare të Statistikave

Shqipëria	<a href="http://www.instat.gov.al/">http://www.instat.gov.al/</a>
Bosnja dhe Hercegovina	<a href="http://www.bhas.gov.ba/">http://www.bhas.gov.ba/</a> <a href="https://www.rzs.rs.ba/">https://www.rzs.rs.ba/</a>
Moldavia	<a href="https://statistica.gov.md/">https://statistica.gov.md/</a>
Mali i Zi	<a href="https://www.monstat.org/">https://www.monstat.org/</a>
Maqedonia e Veriut	<a href="http://www.stat.gov.mk/">http://www.stat.gov.mk/</a>
Serbia	<a href="https://publikacije.stat.gov.rs/">https://publikacije.stat.gov.rs/</a>
Ukraina	<a href="https://ukrstat.org/">https://ukrstat.org/</a>

Instituti i Statistikave. Republika e Shqipërisë (2020). *Quarterly Economic Growth. Second Quarter, 2020. (Rritja Ekonomike Tremujore. Tremujori i Dytë, 2020)* <http://instat.gov.al/en/themes/economy-and-finance/national-accounts-gdp/publication/2020/gross-domestic-product-q2-2020/>

Instituti i Statistikave. Republika e Shqipërisë (2020). *Quarterly Labour Force Survey, Q2-2020. (Anketa Tremujore e Forcave të Punës, Tremujori 2-2020)*. <http://instat.gov.al/en/themes/labour-market-and-education/employment-and-unemployment-from-lfs/publication/2020/quarterly-labour-force-survey-q2-2020/>

Instituti i Statistikave. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (2020). *QUARTERLY GROSS DOMESTIC PRODUCT, II quarter 2020. Expenditure approach. (PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO PËR TREMUJORIN, tremujori II 2020. Qasja e shpenzimeve)*. [http://www.bhas.ba/data/Publikacije/Saopstenja/2020/NAC\\_04\\_2020\\_Q2\\_0\\_BS.pdf](http://www.bhas.ba/data/Publikacije/Saopstenja/2020/NAC_04_2020_Q2_0_BS.pdf)

Zyra Shtetërore e Statistikave. Republika e Maqedonisë së Veriut. *Active Population in the Republic of North Macedonia. Results from the Labour Force Survey, II quarter 2020. (Popullsia Aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rezultatet nga Anketa e Forcave të Punës, tremujori II 2020)*. [http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooptenie\\_en.aspx?rbrxt=98](http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooptenie_en.aspx?rbrxt=98)

## Raporte dhe dokumente në lidhje me vendet e përmendura në raport

Blofield, Merike; Giambro, Cecilia and Filgueira, Fernando (2020). Policy expansion in compressed time: Assessing the speed, breadth and sufficiency of post-COVID social protection measures in ten Latin American countries. (Zgjerimi i politikave në kohë të ngjeshur: Vlerësimi i shpejtësisë, gjerësisë dhe mjaftueshmërisë së masave të mbrojtjes sociale në periudhën pas-kovidiane në dhjetë vende të Amerikës Latine). ECLASC/ CEPAL, seria e Politikave Sociale Nr. 235. [https://repositorio.cepal.org/bitstream/handle/11362/46016/4/S2000593\\_en.pdf](https://repositorio.cepal.org/bitstream/handle/11362/46016/4/S2000593_en.pdf)

Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (2020). Parashikimi Ekonomik Evropian. Vjeshtë 2020. *European Economy*. (Ekonomia Evropiane). Dokument Institucional 136. [https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/autumn\\_20\\_forecast.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/autumn_20_forecast.pdf) (Kapitulli 28 - Shqipëria, Kapitulli 29 - Mali i Zi, Kapitulli 30 - Maqedonia e Veriut, Kapitulli 31 - Serbia)

Gentilini, Ugo et al. (2020). *Social Protection and Jobs Responses to COVID-19: A Real-Time Review of Country Measures (Reagimi i Mbrojtjes Sociale dhe Vendeve të Punës ndaj COVID-19: Shqyrtim në Kohë Reale i Masave Kombëtare) (18 shtator, 2020)*. COVID-19 Dokument Dinamik. Banka Botërore. Botime të ndryshme.

Hirose, K.; Hetteš, M. (2016). Extending Social Security to The Informal Economy. (Shtrirja e Sigurimeve Shoqërore në Ekonominë Informale) Dëshmi nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Republika e Moldavisë. Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë dhe Zyra Kombëtare për Evropën Qendrore dhe Lindore. Budapest

Hirose, K. (2019). Health care financing reform in Ukraine – a progress review, 2016-2019. (Reforma për financimin e kujdesit shëndetësor në Ukrainë - një përmbledhje e progresit, 2016-2019). Shënime me mimografi.

ILO (2011). Social security and the rule of law. (Sigurimet shoqërore dhe sundimi i ligjit). Anketa e Përgjithshme në lidhje me instrumentet e sigurimeve shoqërore në dritën e Deklaratës së vitit 2008 për Drejtësinë Sociale për një Globalizim të Drejtë. Raporti i Komitetit të Ekspertëve për Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve. [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_norm/---relconf/documents/meetingdocument/wcms\\_152602.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---relconf/documents/meetingdocument/wcms_152602.pdf)

ILO (2020a). *ILO Monitor. COVID-19 and the world of work: Impact and policy responses. Updates, estimates and analysis. (Monitorimi i ILO-s. COVID-19 dhe bota e punës: Ndikimi dhe përgjigjet e politikave)*. Përditësime, vlerësime dhe analiza). Botime të ndryshme të njëpasnjëshme. Gjenevë

<b>Tregu i punës</b>	<b>Subvencionimi i pagave</b>	<p>Në datë 9 prill qeveria e RS-së miratoi një sërë dekretesh për të lehtësuar barrën e shkaktuar nga pandemia për bizneset dhe për të parandaluar humbjen e vendeve të punës. Masat përfshijnë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore për gjysmën e dytë të muajit mars dhe kontributin e sigurimeve shoqërore dhe pagën minimale për muajin prill për punonjësit e ndërmarrjeve që ishin të ndaluara të punonin gjatë gjendjes së emergjencës të shkaktuar nga pandemia. Të gjithë punonjësit e institucioneve shëndetësore publike në RS, duke përfshirë punonjësit shëndetësorë të punësuar në institucionet penale, morën një subvencionim të njëhershëm të pagës prej 1,000 BAM, së bashku me pagën e muajit mars. Subvencionimi ishte i paramenduar për punëtorët mjekësorë që kanë punuar të paktën tre javë gjatë periudhës 15 mars -15 prill.</p> <p>FB&amp;H miratoi Ligjin për zbutjen e pasojave ekonomike negative të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit, të quajtur "Ligji për Koronën". Entiteti do të subvencionojë kontributet e sigurimeve shoqërore të punonjësve në masën 244.85 BAM (125 EUR) për periudhën e gjendjes së jashtëzakonshme dhe një muaj më pas, dmth gjatë muajve prill, maj dhe qershor. Kjo ka të bëjë me kompanitë që gjatë periudhës së bllokimit kishin një rënie prej të paktën 20% të xhiros krahasuar me të njëjtin muaj në vitin 2019. Nga kjo do të mund të përfitojnë vetëm kompanitë që nuk kanë detyrime të prapambetura tatimore. Kantonet morën masa që synonin subvencionimin e pagave minimale në mënyrë të plotë ose të pjesshme. Për shembull, në muajin prill 2020 Kantoni Zenica-Doboj vendosi të bashkëfinancojë 50% të pagës neto për muajin mars dhe shumën e plotë të një page minimale për muajin prill për ato kompani të cilave iu ishte ndaluar puna gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Kantoni Hercegovinë-Neretva do të subvencionojë pagat minimale në masë të plotë.</p> <p>Qarku Brčko vendosi të paguajë një pagë minimale bruto (520 BAM ose 266 EUR neto plus kontributet e sigurimeve shoqërore dhe taksat) për muajin mars për kompanitë të cilave iu ishte ndaluar aktiviteti, ndërsa ndërmarrjet e tjera mund të marrin subvencione prej 30% të kontributeve të paguara të sigurimeve shoqërore dhe të tatimit mbi pagat për muajin mars. Në kuadrin e një ligji të miratuar në muajin maj, një pjesë e pagës bruto dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore të mbartura nga punëdhënësi deri në masën 860 BAM ose 440 EUR do të subvencionohen nga buxheti i Qarkut për kompanitë e prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pandemia për muajin prill deri në një muaj pas heqjes së masave për ndalimin e punës, ndërsa ndërmarrjet e tjera të prekura do të marrin subvencione për të paktën 30% të tatimeve dhe kontributeve të paguara të sigurimeve shoqërore mbi pagat.</p>
----------------------	-------------------------------	---

## Moldavia

<b>Situata e COVID-19</b>	Në bazë të Vendimit të Parlamentit nr. 55/2020 në lidhje me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, në Republikën e Moldavisë gjendja e jashtëzakonshme në të gjithë vendin u shtri në periudhën kohore 17 mars - 15 maj 2020.	
<b>Sigurimet shoqërore</b>	<b>Pensionet</b>	<p>Nga data 1 prill deri më 30 qershor 2020, punonjësit e Ndërmarrjes Shtetërore "Posta Moldovei" bënë shpërndarjen e pensioneve, të pagesave sociale shtetërore dhe pagesave të tjera shoqërore në të holla nëpër shtëpitë e të moshuarve. Për këtë periudhë, komisioni i paguar nga Shtëpia Kombëtare e Sigurimeve Shoqërore për Ndërmarrjen Shtetërore "Posta Moldovei" për shpërndarjen e pagesave sociale në shtëpi u rrit nga 0.7% në 1.3% të shumës totale të pagesave të shpërndara.</p> <p>Niveli i aftësisë së kufizuar për personat të cilëve iu skadon vlerësimi gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, u shty nga Këshilli Kombëtar për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar dhe Kapacitetit të Punës deri në heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Pagesa e pensioneve të aftësisë së kufizuar kryhet deri në skadimin e afatit për të cilin përcaktohet aftësia e kufizuar (përshtatja administrative).</p>
	<b>Pagesat e papunësisë</b>	<p>Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, personat e regjistruar në zyrën territoriale të punësimin, duke përfshirë edhe të kthyerit nga jashtë, marrin pagesa mujore të papunësisë në vlerën prej 2,775 MDL (161,61 dollarë amerikanë) nga data e aplikimit. Kërkesa për pagesën e papunësisë mund të dorëzohet në distancë, duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.</p> <p>Personat që kanë humbur punën si rezultat i gjendjes së jashtëzakonshme kur regjistrohen në zyrën territoriale të punësimin dhe aplikojnë për pagesën e papunësisë nuk janë të detyruar të sigurohen në mënyrë individuale në sistemin e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.</p> <p>Personat që nuk plotësojnë periudhën minimale kontributive prej 12 muajsh gjatë 24 muajve të fundit, përfshirë personat që janë kthyer nga jashtë në Republikën e Moldavisë, deri në regjistrimin e tyre si të papunë dhe deri në momentin e aplikimit për pagesën e papunësisë, janë të detyruar të sigurojnë veten në mënyrë individuale në sistemin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor duke paguar masën e sigurimit shëndetësor në një shumë fikse.</p>



<b>Sig-urimet sho-qërore</b>	<b>Kontrib-utet e sigurimeve shoqërore</b>	<p>Nga data 16 maj deri më 30 qershor 2020, ndërmarrjet dhe organizatat jo tregtare, banorë të Republikës së Moldavisë, të cilët janë të detyruar të ndërpresin plotësisht ose pjesërisht aktivitetin e tyre në përputhje me vendimet e Komisionit Kombëtar të Jashtëzakonshëm për Shëndetin Publik dhe/ ose Komisionit për Situatat e Jashtëzakonshme kanë të drejtë të përfitojnë një subvencionim në masën 100% të bazës së llogaritjes (tatimi mbi të ardhurat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe primet e sigurimeve shëndetësore të paguara në lidhje me dëmshpërblimin/ pagën e punonjësve që janë teknikisht të papunë). Subjektet e subvencionit që kanë ndërprerë plotësisht ose pjesërisht aktivitetin e tyre, përveç atyre të përmendur më sipër, kanë të drejtë të përfitojnë një subvencion prej 60% të bazës së llogaritjes.</p> <p>Themeluesit e ndërmarrjeve individuale, noterët, përmbauesit, avokatët, shitësit me pakicë, mbajtësit e licencave të sipërmarrësve kanë të drejtë të përfitojnë një subvencion në masën e shumës fikse të kontributeve të sigurimeve shoqërore shtetërore për periudhën e ndërprejës së veprimtarisë së tyre në përputhje me vendimet e Komisionit Kombëtar të Jashtëzakonshëm të Shëndetit Publik dhe/ ose Komisionit për Situatat e Jashtëzakonshme.</p>
<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Transfertat e rregullta në para</b>	<p>Duke filluar nga muaji prill i vitit 2020, të ardhurat minimale të garantuara mujore për ndihmën sociale janë rritur nga 1,107 MDL (64,5 dollarë amerikanë) në 1,300 MDL (75,7 dollarë amerikanë) dhe shuma e të ardhurave minimale mujore të garantuara për secilin fëmijë u rrit nga 50% në 75%, përfshirë edhe muajin në të cilin u hoq gjendja e jashtëzakonshme.</p> <p>E drejta për ndihmë sociale që skadon gjatë gjendjes së jashtëzakonshme zgjatet deri në përfundim të kësaj të fundit. Për përcaktimin e të drejtës për përfitimin e ndihmës sociale, aplikanti që nuk ka mundësi të paraqesë dokumente konfirmuese në lidhje me të ardhurat, strukturën familjare dhe dokumente të tjera të nevojshme, paraqet deklaratën për përgjegjësinë e tij në lidhje me vërtetësinë e të dhënave të deklaruara (përshtatja administrative).</p>
	<b>Shtyrja e pagesës së shërbimeve komunale</b>	<p>Gjatë periudhës së emergjencës, bankat tregtare që marrin pjesë në programin “Shtëpia e Parë” nuk fillojnë procedurën e ekzekutimit të së drejtës së hipotekës, si rezultat i mospagimit nga përfituesit të shumës kryesore të hipotekës dhe interesit brenda 91 ditëve.</p>
<b>Tregu i punës</b>	<b>Rregullimi i tregut të punës</b>	<p>Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, u vendos një regjim i posaçëm pune për punonjësit e institucioneve publike. Në varësi të specifikës së aktivitetit dhe nevojave, një pjesë e punonjësve ishin të detyruar të paraqiteshin fizikisht në punë, ndërsa pjesa tjetër e personelit punonte në distancë nga shtëpia.</p> <p>Nga data 21 maj 2020, në Kodin e Punës u përfshi edhe Kapitulli i ri “Puna në distancë”.</p> <p>Dispozitat që vendosin kushte, kufizime dhe rregulla pushimi nga puna të parashikuara në Kodin e Punës nuk janë të zbatueshme gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.</p> <p>Për të garantuar funksionimin e duhur të rendit dhe shëndetit publik, personeli punësohet duke përdorur procedurën e thjeshtuar (pa konkurs).</p>
<b>Impli-kimet fiskale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpenzime shtesë për sektorin e shëndetësisë: 1.2% e PBB-së;</li> <li>- Shpenzime shtesë për sektorin jo shëndetësor: 1.1% të PBB-së;</li> <li>- Shpenzimet e përshpejtuara dhe të ardhurat e shtyra: 0.3% e PBB-së;</li> <li>- Detyrimet e kushtëzuara: Garancitë (për huatë, depozitat etj.) dhe operacionet <i>quasi</i> fiskale: 0.1% e PBB-së.</li> </ul>

## Mali i Zi

<b>Situata e COVID-19</b>	<p>Rasti i parë me COVID-19 u raportua me datë 17 mars. Sipas qeverisë malazeze, ata ishin edhe vendi i parë evropian që u ‘çlirua’ nga koronavirusi. Fillimisht, qeveria e nisi punën me organizimin e fushatave për ndërgjegjësimin e popullsisë, mbylli të gjitha shkollat dhe pezulloi të gjitha fluturimet. Në fillim të qershorit, kufijtë u hapën përsëri për disa prej tyre. Sidoqoftë, nga mesi i muajit qershor, Mali i Zi raportoi numrin më të lartë të rasteve të reja për 100,000 qytetarë. Qeveria rivendosi kufizime të mëtejshme.</p>	
<b>Sigurimet shoqërore</b>	<b>Leja e pushimit mjekësor me pagesë, leja e pushimit për kujdesin ndaj fëmijëve, leja e lindjes</b>	<p>Gjatë mbylljes së shkollave dhe kopshteve, njëri nga prindërit e fëmijëve deri në moshën 11 vjeç kishte të drejtë të merrte lejen e pushimit me pagesë nga puna, me përjashtim të punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe punonjësve në institucione të caktuara shtetërore.</p>

<b>Sigurimet shoqërore</b>	<b>Pensionet</b>	Pensionet minimale u rritën nga 125 në 145 Euro. Si pjesë e paketës COVID-19, për personat me pensione të ulëta u ofrua edhe një pagesë shtesë e njëhershme.
	<b>Pagesat e papunësisë</b>	Mbështetje e njëhershme financiare për personat e regjistruar si të papunë që nuk i plotësojnë kërkesat për përfitimin e mbështetjes në bazë të papunësisë, aftësisë së kufizuar personale ose ndihmës sociale.  Ndhimë e njëhershme financiare me një vlerë prej 50.00 Euro për të gjithë ata persona që janë regjistruar si të papunë, nëse nuk kanë të drejtë të përfitojnë mbështetje financiare ose ndihmë sociale për familjet.
	<b>Kontributet e sigurimeve shoqërore</b>	Shtyrja e kontributeve mbi fitimet e punonjësve.  Shtyrja e ripagimit të huasë për qytetarët, shtyrja e shlyerjes së tatimit mbi fitimin.
<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Transfertat e rregullta në para</b>	Qeveria po shqyrton mundësinë e zgjerimit të së drejtës për përfitimin e pagesës për fëmijët (kohëzgjatje e kufizuar, 3-6 muaj) për ato familje, anëtarët e të cilave kanë humbur vendin e punës gjatë krizës, si dhe mundësinë për të filluar me përdorimin e mekanizmave të ndihmës jo financiare (të përshtatura për moshën e fëmijëve).
	<b>Transfertat e njëhershme në para</b>	Mbështetje e njëhershme për përfituesit e pensioneve dhe ndihmës sociale.  Ndhimë e njëhershme financiare u është dhënë 8,583 familjeve përfituese me 28,953 anëtarë të familjes, në vlerën e 50 Euro për person. Qeveria shpenzoi 429,140 Euro në total. Në muajin mars të vitit 2020, një total prej 569 përdoruesish ushtruan të drejtën e tyre për tu qasur tek shërbimi i ndihmës financiare të njëhershme me vlerë 52,489 Euro.  Mbështetje e njëhershme financiare për personat e regjistruar si të papunë që nuk i plotësojnë kërkesat për përfitimin e mbështetjes në bazë të papunësisë, paaftësisë së kufizuar personale ose ndihmës sociale.  Ndhimë e njëhershme financiare për të gjithë ata persona që janë regjistruar si të papunë në vlerën 50 Euro, nëse nuk kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë financiare ose ndihmë sociale për familjet e tyre.
<b>Tregjet e Punës</b>	<b>Masat e aktivizimit</b>	Shërbime këshillimi për personat e papunë dhe punëkërkuessit e tjerë aktivë. Puna me punëdhënësit, vizita tek punëdhënësit, dhënia e informacionit në lidhje me hapjen e vendeve të punës janë procese të përcaktuara në Marrëveshjen për Procesin e Aktivizimit Social të Përdoruesve të Aftë për Punë, që synojnë aktivizimin shoqëror të përdoruesve të mbështetjes financiare.  Shpërndarja e broshurave dhe manualeve në lidhje me modelet që mund të përdoren për hapjen e një biznesi të vogël për personat që humbën punën gjatë krizës së shkaktuar nga COVID-19. Organizimi i kurseve gjerësisht të aksesueshme në internet ose në televizion me karakter edukativ, që synojnë kryesisht personat e papunë për një periudhë të përkohshme. Organizimi dhe përmirësimi i funksionimit të fondeve për mbështetjen e biznesit dhe sipërmarrjes në nivel lokal. Intensifikimi i punës për promovimin e vullnetarizmit në rradhët e të rinjve dhe lidhja sistematike e vullnetarizmit me arsimin e mesëm dhe të lartë.  Ristrukturimi i programit për formimin profesional të të rinjve për ta kthyer në një program universal dhe të hapur të praktikave profesionale.  Artikulimi i përgjigjeve ndaj nevojave të kategorive të mëposhtme të riskuara: punëtorë atipikë (jo standardë) / informalë / sezonalë; të rinjtë në periudhë tranzicioni nga arsimi në tregun e punës; të papunët afatgjatë që nuk marrin pagesa papunësie; personat me aftësi të kufizuara; familjet me një prind të papunë. Parandalimi i shfaqjes së "gjeneratës së izolimit".
	<b>Rregullimi i tregut të punës</b>	Zbatimi i programit për rehabilitimin profesional. Mbështetja për projektin "Ndhimë në shtëpi - profesion i së ardhmes". Zbatimi i programit "Ndal Ekonomisë Gri". Zbatimi i programit "Programet e Grantit për Vetëpunësim".

<b>Tregjet e Punës</b>	<b>Subvencionimi i pagave</b>	<p>Paketa e dytë stimuluese përfshinte subvencione për pagat në muajt prill dhe maj dhe arriti në vlerën 33 milion EUR. Janë përpunuar mbi 30,000 kërkesa për subvencione, dhe rreth 129,000 EUR janë dhënë në formën e subvencioneve për punonjësit. Subvencionimi në muajt prill dhe maj i 70% të pagës minimale për punonjësit në ato sektorë që janë mbyllur për shkak të pandemisë, punonjësit që nuk janë në gjendje të punojnë sepse iu duhet të kujdesen për fëmijët e moshës nën 11 vjeç, ose personat që duhet të vetë-izolohen dhe karantinohen; dhe një subvencion prej 50% të pagës minimale për punonjësit në sektorët në rrezik për shkak të masave izoluese lidhur me pandeminë. Qeveria subvencionoi edhe 70% të pagës minimale bruto të punëtorëve të sapo punësuar në NVM për gjashtë muaj nëse këta punëtorë regjistroheshin si të papunë.</p> <p>Paketa e dytë përfshinte programin e mbështetjes së biznesit dhe punonjësve për të zbutur efektet negative të koronavirusit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- bizneset të cilëve iu është ndaluar puna (100% e pagës minimale bruto);</li> <li>- sektori i turizmit (100% e pagës minimale bruto);</li> <li>- industrinë e rrezikuara (50% e pagës minimale bruto);</li> <li>- fitimet e punonjësve me leje pushimi me pagesë (70% e pagës minimale bruto);</li> <li>- fitimet e punonjësve në karantinë ose izolim (70% e pagës minimale bruto).</li> </ul>
<b>Implikimet fiskale</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpenzime shtesë për sektorin e shëndetësisë: 0.4% e PBB-së;</li> <li>- Shpenzime shtesë për sektorin jo shëndetësor: 2.3% e PBB-së;</li> <li>- Shpenzimet e përsheptuara dhe të ardhurat e shtyra: 2.3% e PBB-së;</li> <li>- Detyrimet e kushtëzuara: Garancitë (për huatë, depozitat etj.) dhe operacionet <i>quasi</i> fiskale: 0.0% e PBB-së.</li> </ul>

## Maqedonia e Veriut

<b>Situata e COVID-19</b>	Gjendja e jashtëzakonshme në Maqedoninë e Veriut fillimisht u shpall për periudhën 18 mars 2020 deri më 22 qershor 2020.	
<b>Sigurimet shoqërore</b>	<b>Leja e pushimit mjekësor me pagesë, leja e pushimit për kujdesin ndaj fëmijëve, leja e lindjes</b>	Punonjësit me fëmijë nën moshën 10 vjeç, ata me sëmundje kronike dhe gratë shtatzëna u liruan nga puna gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Pushimi i paguar për kujdesin ndaj fëmijëve zgjati gjatë gjithë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme.
<b>Sigurimet shoqërore</b>	<b>Sigurim-ishëndetësor</b>	Për personat e pasiguruar u ofruan shërbime shëndetësore për trajtimin e COVID-19. Për personat me sëmundje kronike u aktivizua sistemi për përshkrimin elektronik të ilaçeve. COVID-19 njihet si një sëmundje profesionale për mjekët dhe personelin tjetër mjekësor. Kontrolli i rregullt vjetor shëndetësor u shty gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.
	<b>Pensionet</b>	Pensionistët mund t'i tërheqin pensionet nga llogaritë bankare një javë më herët se zakonisht, bazuar në udhëzimet e Qeverisë për bankat.
	<b>Pagesat e papunësisë</b>	<p>Pagesat e papunësisë i kalojnë 16,012 qytetarëve me një vlerë totale prej 156.6 milion denarë ose me vlerë mesatare prej 9,783 denarë për muajin maj. Personat që kanë humbur vendin e tyre të punës nga data 11 mars deri më 30 prill kualifikohen si përfitues të pagesës së papunësisë: 50% e pagave mesatare neto për 24 muajt e fundit nëse kanë punuar të paktën 9 muaj më parë, ose 12 muaj me ndërprerje gjatë 18 muajve të fundit, dhe ndihma minimale e garantuar për personat me më pak se 9 muaj punë.</p> <p>Afatet e regjistrimit pranë Agjencisë së Punësimit për personat që kanë paguar kontribute për papunësinë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme shtyhen për 30 ditë nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme. Afatet në rast të të drejtave të gatishmërisë dhe detyrimit nga marrëveshja për punësim ndërpritën gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe shtyhen për 15 ditë nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme</p>
<b>Kontributet e sigurimeve shoqërore</b>	Subvencionet për kontributet e sigurimeve shoqërore në shumën prej 50% të pagës mesatare për vitin 2019 për punonjësit e kompanive në sektorin e turizmit, transportit, hotelierisë dhe në kompani të tjera të prekura nga kriza e shkaktuar nga COVID-19 për muajt prill, maj dhe qershor, 2020.	

<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Transfertat e rregullta në para</b>	<p>Ndihma minimale e garantuar: Baza për t'u kualifikuar për ndihmë të garantuar është ndryshuar. Tani kjo bazë merr parasysh të ardhurat totale të familjes gjatë muajit të fundit dhe jo të tre muajve të fundit. Shuma varet nga numri dhe struktura e familjes: 4,000 denarë për një familje me një anëtar deri në 10,000 denarë për 5 anëtarë të rritur në familje. Familjet do të marrin si shtesë edhe 1,000 denarë për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për muajt prill dhe maj, 2020.</p> <p>Shtyrja deri në fund të muajit shtator e masës për mbështetjen e përdoruesve (30,000 familje) të cilët marrin 1,000 denarë si ndihmë mujore për pagesën e energjisë elektrike.</p> <p>Kriteret e kualifikueshmërisë për ndihmën minimale të garantuar janë lehtësuar, dhe mbulojnë grupet më të cënueshme të qytetarëve që kanë nevojë për mbështetje financiare.</p>
	<b>Transfertat e njëhershme në para</b>	<p>Mbështetje financiare për qytetarët me të ardhura të ulëta në vlerën prej 3,000 denarë e transferuar në kartën për pagesat e brendshme vetëm për blerjen e produkteve dhe shërbimeve vendore. Qytetarët me të ardhura të ulëta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 115,927 përfitues të mbrojtjes sociale, ose persona që janë punëkërkues aktivë dhe janë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit;</li> <li>- 117,144 persona të punësuar me të ardhura të ulëta (pa të ardhura të tjera dhe me pagë jo më të lartë se 60,000 denarë për periudhën janar - prill, 2020);</li> <li>- 87,014 të rinj në moshën 16 deri 29 vjeç që ndjekin arsimin e mesëm zyrtar dhe arsimin e lartë në universitete;</li> <li>- 4,394 punonjës mjekësorë të cilët marrin pjesë në testimin dhe diagnostikimin e qytetarëve me COVID-19.</li> </ul> <p>Përfituesit e mbështetjes financiare, punonjësit me të ardhura të ulëta dhe të rinjtë do të marrin 3,000 denarë. Punonjësit mjekësorë të cilët marrin pjesë në testimin dhe diagnostikimin e qytetarëve me COVID-19 do të marrin 40% të vlerës neto të pagës së tyre individuale më të fundit.</p> <p>Kjo direktivë nuk përfshin disa kategori të qytetarëve: personat që nuk janë regjistruar si të papunë në Agjencinë e punësimit, personat e papunë që nuk janë në kërkim aktiv të punës, pensionistët me të ardhura të ulëta, të rinjtë - studentët në universitetet private.</p> <p>Shtyrja e afatit për zbatimin e së drejtës për përfitimin e shumës së njëhershme, të parashikuar nga Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, për tre muaj pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.</p>

<p><b>Ndihma Sociale</b></p>	<p><b>Pagesa e strehimit, kuponat ushqimorë, të tjera</b></p>	<p>Kupona për turizmin e brendshëm: Mbështetje financiare për qytetarët me të ardhura të ulëta në vlerën prej 6,000 denarë për akomodim dhe shërbime turistike dhe karta debiti bankare prej 3,000 denarë për hotelerinë. Qëllimi i kësaj mase është garantimi i ndihmës financiare për qytetarët e varfër, promovimi dhe mbështetja e blerjes së produkteve dhe shërbimeve lokale, për përfshirjen e subjekteve të ekonomisë informale në ekonominë formale dhe për të ndihmuar edhe turizmin lokal që është një nga sektorët më të prekur nga kriza e shkaktuar nga COVID-19. Kuponat mund të përdoren nga data 15 korrik deri më 15 dhjetor 2020. Qytetarët me të ardhura të ulëta janë persona të punësuar me të ardhura të ulëta (pa të ardhura të tjera, paga totale e të cilëve nga muaji janar deri në muajin prill ishte më pak se 60,000 denarë).</p> <p>Paketa ushqimore: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me Misionin e OSBE-së në Shkup siguruan 658 pako me ushqime për 329 viktime të regjistruara të dhunës në familje për muajt maj dhe qershor. Mensa për të varfërit funksionon duke zbatuar protokollet e përcaktuara për mbrojtjen nga COVID-19.</p> <p>Paketa ushqimore dhe sanitare: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me <i>UN Women</i>, agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe agjencia suedeze për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar kanë ofruar 1,860 paketa ushqimore dhe produkte higjienike për 368 familje me një prind të vetëm, përdorues të ndihmës minimale të garantuar, shumica e të cilëve janë gra (95%); 329 viktime të regjistruara të dhunës në familje; dhe për strehimoret dhe qendrat e krizave për viktimat e dhunës me bazë gjinore.</p> <p>Paketat sanitare: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale përmes qendrave për punë sociale siguron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 600 pako me artikuj mbrojtës dhe sanitar për familjet që jetojnë në kushte nën standardin e nevojshëm;</li> <li>- me mbështetjen e UNICEF, janë shpërndarë 4,300 pako me artikuj mbrojtës dhe sanitar për familjet që jetojnë në kushte nën standardin e nevojshëm dhe 300 pako për personat pa dokumente personale në qytete të ndryshme në mbarë vendin;</li> <li>- me mbështetjen e USAID dhe në bashkëpunim me Kryqin e Kuq 4,300 pako shtesë me produkte ushqimore dhe sanitare do të shpërndahen për përdoruesit e ndihmës sociale, dhe do të garantohet ndihma minimale gjatë muajve maj dhe qershor.</li> </ul> <p>Paketa për fëmijët me nevoja të veçanta: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me UNICEF siguroi 500 pako me materiale edukative për fëmijët me nevoja të veçanta që vizitojnë qendrat ditore në 30 komuna.</p> <p>Pako ushqimore për refugjatët: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me qendrat e punës sociale dhe Kryqin e Kuq kanë shpërndarë disa pako humanitare për 700 persona pa dokumente personale. 117,122 qytetarë me të ardhura të ulëta morën kupona për t'i përdorur në turizmin vendas dhe kartë pagese me vlerë 3,000 denarë.</p> <p>Kartat për qasjen në internet në pajisjet celulare: Ministria e shoqërisë së informatikës ka dhuruar karta për qasjen në internet në pajisjet celulare për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm nga familjet me të ardhura të ulëta. Ekipet e Kryqit të Kuq kanë ofruar ndihmë për qytetarët në vetë-izolim: Ekipet lëvizëse nga organizata e Kryqit të Kuq janë trajnuar për ofrimin e ndihmës bazë mjekësore, për blerjen e ushqimeve, ilaçeve dhe produkteve sanitare për personat në vetë-izolim. Ndihma për të moshuarit dhe kategoritë e tjera të cënueshme: Mbështetje për 1,570 persona me nevoja të veçanta dhe grupe të tjera të cënueshme në partneritet me PNUD-in dhe me mbështetjen e agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim.</p> <p>Linja telefonike për mbështetjen e prindërve dhe kujdestarëve: Këshilla falas dhe konfidenciale për prindërit dhe kujdestarët si pjesë e mbështetjes së ofruar nga UNICEF.</p> <p>Mbështetje aktive kundër dhunës në familje: Janë forcuar shërbimet për mbrojtjen nga dhuna në familje.</p>
	<p><b>Ushqimi në shkollë</b></p>	<p>Ushqimi në shkollë: Tre lloje kuponësh për studentët e universitetit dhe nxënësit e shkollës së mesme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 6,000 denarë maqedonas për nxënësit/ studentët nga familje me të ardhura të ulëta;</li> <li>- 30,000 denarë maqedonas për të rinjtë deri në 29 vjeç për t'u trajnuar në fushën e TI-së dhe për përfitim të aftësive digjitale; dhe</li> <li>- 3000 denarë maqedonas për çdo nxënësit/student për blerjen e produkteve vendore.</li> </ul>

<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Punët publike</b>	Zyra e PNUD-it me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, dhe në bashkëpunim me MPMS dhe Agjencinë e Punësimit kanë përfshirë 50 romë nga disa komuna në punë publike për t'i mbështetur dhe ndihmuar për parandalimin dhe përballimin e COVID-19.  Në kuadrin e programit 'Puna e Dobishme Shoqërore' u zhvilluan disa aktivitete që kishin të bënin me furnizimin me ushqim dhe ilaçe dhe rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për përballimin e COVID-19. Në muajt prill dhe maj, 184 persona në 27 komuna ofruan shërbime për 1,500 përdorues: të moshuar, persona me nevoja të veçanta dhe persona të shprehur për përfshirje sociale.
	<b>Shtyrja e pagesës së shërbimeve komunale</b>	Pagesat e qirasë për apartamentet sociale dhe për qytetarët u shtynë.
<b>Të tjera</b>		Zbatimi i ligjit u pezullua deri në fund të muajt qershor 2020. U hartua rregullorja për shtyrjen e rishlyerjes së kredive bankare.  Kreditë nga kompanitë financiare dhe qiradhënëse u riprogramuan duke ulur kështu në tre muajt e ardhshëm në masën 70% dhe duke shtyrë afatin për minimumi 90 ditë nga data e maturimit.  Tavani i çmimeve të produkteve të caktuara: ushqime, ilaçe, pajisje mbrojtëse personale, produkte të higjienës personale dhe dezinfektues. Zhvillimi i konsultimeve tre-palëshe në lidhje me paketat e dyta qeveritare për krizën e shkaktuar nga COVID-19.
<b>Tregu i punës</b>	<b>Rregullimi i tregut të punës</b>	Rekomandimet e ofruara mbulonin si më poshtë:  - Punonjësit në sektorin e prodhimit; - Punonjësit në sektorin e prodhimit ushqimor dhe në thertore; - Punonjësit në ndërmarrjet e transportit; - Rregullat specifike për kufizimin e lëvizjes për fermerët.  Rekomandimi për masat për mbrojtjen e punëtorëve: rotacioni i punonjësve, rritja e numrit të turneve të punës në më shumë se dy herë, distanca fizike midis punëtorëve, sigurimi i pajisjeve mbrojtëse personale nga punëdhënësit, dezinfektimi i vazhdueshëm i hapësirave të punës, protokollat për nënshkrimin e dokumenteve, takimet, trajnimet e të tjerë.  Miratimi i Protokollit për masat parandaluese për të gjitha vendet e punës për parandalimin e transmetimit të COVID-19.
	<b>Puna nga shtëpia</b>	Është rekomanduar garantimi i punës me turne për punonjësit, (përfshirë punonjësit në institucionet qeveritare), dhe/ ose mundësinë e punës në distancë.
	<b>Subvencionimi i pagave</b>	Ofrimi i shtesave të mëtejshme të pagave për punonjësit mjekësorë dhe punonjësit e tjerë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt në eliminimin e COVID-19 në vlerën prej 20% të pagës bazë për dy muaj.  Mbështetje financiare prej 14,500 MKD për artistët për muajt prill dhe maj 2020.  Mbështetje financiare prej 14,500 MKD për klubet sportive për muajt prill dhe maj 2020.
<b>Implikimet fiskale</b>	<b>Shpenzimet shtesë për sektorin e shëndetësisë</b>	Të ardhurat e humbura/ të perealizuara: u hoq detyrimi doganor për importin e materialeve mjekësore. Në total 0,1% të PBB-së.
	<b>Shpenzimet shtesë për sektorin jo shëndetësor</b>	Shpenzimet shtesë:  Subvencionet e synuara për pagat e sektorit privat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore (për muajt prill, maj dhe qershor të vitit 2020); subvencion për pjesën e ekonomisë informale; kuponat në para për përfituesit e pagave minimale, të papunët, përfituesit e ndihmës sociale dhe të rinjtë; rimbursimi i pjesshëm i tarifave të shkollimit universitar dhe kurseve të TI-së; kreditë me kushte të favorshme dhe skemat e garantimit të kredive për NMVM-të të subvencionuara nga qeveria; mbështetja e synuar për bujqësinë, industrinë tekstile dhe disa sektorë të tjerë.  Të ardhurat e humbura/ të perealizuara:  Ulja e normës së interesit të vonuar për taksat dhe detyrimet publike nga 0,03% në 0,015%.  Ulja e shkallës së ndëshkimit, me 50% d.m.th në 5% për korporatat dhe në 4% për familjet.  Në total: 2% e PBB-së

<b>Implikimet fiskale</b>	<b>Detyrimet kontingjente:</b> <b>Garancitë (për huatë, depozitat etj.) dhe operacionet quasi fiskale</b>	Një sërë kredish pa interes ose me normë të ulët interesi për NVM-të nga bankat e zhvillimit të Maqedonisë të kanalizuar përmes bankave tregtare.
---------------------------	--	---

## Serbia

<b>Situata e COVID-19</b>	Në Serbi, gjendja e jashtëzakonshme u shpall për periudhën 15 mars deri më 6 maj 2020.	
<b>Sigurim shoqëror</b>	<b>Leja e pushimit mjekësor me pagesë, leja e pushimit për kujdesin ndaj fëmijëve, leja e lindjes</b>	<p>Ministria e Punës, Punësimi, Veteranëve dhe Politikës Sociale ka dalë me rekomandime për punëdhënësit për të lejuar prindërit e vetëm, kujdestarët dhe kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara që të punojnë nga shtëpia, aty ku është e mundur.</p> <p>Rekomandimi gjithashtu i udhëzonte punëdhënësit që të lejonin marrjen e lejes së pushimit me pagesë për prindërit e punësuar dhe me fëmijë deri në moshën 12 vjeç, nëse e lejon aktiviteti i punës së punëdhënësit. Punëdhënësi duhet të lejojë njërin prej prindërve me fëmijë nën 12 vjeç të punojë nga shtëpia. Nëse procesi i punës së punëdhënësit nuk mund të zhvillohet duke punuar nga shtëpia, atëherë lind nevoja e organizimit të punës me turne.</p>
	<b>Pensionet</b>	<p>Të gjithë pensionistëve në Serbi iu ofrua ndihma e njëhershme në vlerën prej 4,000 RSD (35 EUR). Pagesa e pensioneve dhe përfitimeve të tjera nga sigurimi i pensionit dhe i aftësisë së kufizuar do të bëhet paraprakisht për të gjithë muajin.</p> <p>Për pagesën e pensioneve, pensionistët mund t'u japin autorizim të veçantë të tjerëve për tërheqjen e pensionit në emër të tyre. Përndryshe, pensionet u shpërndahen pensionistëve me para në dorë dhe kostoja e dërgimit mbulohet nga qeveria.</p> <p>Përveç kësaj, nga Fondi i Sigurimeve të Pensionit dhe Aftësisë së Kufizuar u pagua ndihma e njëhershme në para prej 4,000 RSD për përfituesit që ofrojnë ndihmë dhe për kujdesje për një person tjetër, të cilët ishin kualifikuar para vitit 1992, dhe për përfituesit e ndihmës për aftësinë e kufizuar të kualifikuar para vitit 2003, të cilët kanë ende aftësi të mbetura për punë.</p>
	<b>Pagesat e papunësisë</b>	Një metodë e re për kryerjen e aplikimit për pagesën e papunësisë dhe për regjistrimin pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimi. Aplikantët mund të paraqisnin kërkesat e tyre përmes postës elektronike ose postës normale. Edhe vendimi për kërkesat e paraqitura u shty në kohë.
<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Transfertat e rregullta në para</b>	<p>Përfituesit e ndihmës sociale, të cilëve iu kishte skaduar e drejta e përfitimit me datë 15 mars 2020 dhe më vonë mund të vazhdojnë t'i marrin këto pagesa në bazë të vendimeve të lëshuara më parë për një maksimum prej tre muajsh (d.m.th. gjatë gjendjes së jashtëzakonshme).</p> <p>Sipas rregulloreve në fushën e mbrojtjes sociale dhe mbështetjes financiare për familjet me fëmijë, transfertat në para për programet e mëposhtme u shtynë në kohë: ndihma sociale financiare, pagesa për kujdestarët, pagesa e rritur për kujdestarët, pagesa për fëmijët dhe pagesa e lejes së lindjes me qëllim kujdesin ndaj fëmijëve.</p>
	<b>Transfertat e njëhershme në para</b>	<p>Ndihma universale në para prej 100 EUR u shpërnda për çdo qytetar mbi 18 vjeç, duke përfshirë: të gjithë pensionistët, të gjithë përfituesit e ndihmës sociale, si dhe për ata persona që kanë aplikuar për ndihmë të njëhershme në para në përputhje me rregulloren. Për të zbatuar pagesën e ndihmës monetare të njëhershme, është krijuar një regjistër i përkohshëm i shtetasve në moshë të rritur të Republikës së Serbisë.</p> <p>Për ndihmën universale emergjente në para janë alokuar 60 miliardë RSD (buxheti i planifikuar fillimisht ishte rreth 70 miliardë RSD). 4,325 mijë qytetarë aplikuan, dhe në total bëhet fjalë për një shifër prej rreth 6.2 milion qytetarësh (kur shtohen edhe të gjithë përfituesit e pensioneve dhe të gjithë përfituesit e ndihmës sociale financiare që automatikisht e kishin këtë të drejtë). Ndihma universale në para u lërvua dy javë pas përfundimit të periudhës së izolimit.</p>

<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Pagesat e strehimit, kuponat ushqimorë, të tjera</b>	<p>Organi përgjegjës për Koordinimin e Çështjeve Gjinore, Ministria e Integritimit Evropian dhe Delegacioni i BE-së në Serbi njoftuan me datë 10 prill 2020 se 14,000 gra nga grupet më të cënueshme në 50 komuna do të marrin një ndihmë me vlerë 100,000 EUR në formën e paketave higjienike dhe produkteve ushqimore thelbësore. Fondet për të gjithë projektin u siguruan me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian.</p> <p>UNICEF ofroi pako me produkte higjienike për 19 shtëpi dhe institucione në Serbi, dorëzimi i të cilave filloi në datë 22 prill 2020. Përveç kësaj, ishte planifikuar që në ditët në vazhdim paketat me produkte higjienike të shpërndareshin edhe për më shumë se 4,000 familje kujdestare në Serbi.</p>
	<b>Shtyrja e pagesës së shërbimeve komunale</b>	<p>Pensionistëve iu ofrua mundësia e shtyrjes së pagesës së shërbimeve publike komunale dhe e pagesave të qirasë. Të gjithë qytetarët mund të shtynin pagesat e faturave të energjisë pa gjorbë, dhe për pensionistët, u zbatua edhe një zbritje prej 5%.</p>
<b>Tregu i punës</b>	<b>Subvencionet e pagave</b>	<p>Më 25 mars 2020 qeveria shpalli masat për të mbështetur aktivitetin e sektorit privat dhe punësimin. Këto masa mbuluan më shumë se 900,000 njerëz dhe shuma e pritshme ishte 97.3 miliardë RSD.</p> <p>Për punëtorët e vetëpunësuar dhe personat juridikë të klasifikuar si mikro, të vegjël dhe të mesëm: tre muaj në shumën e pagës minimale.</p> <p>Për ndërmarrjet e mëdha: 50 përqind e pagës minimale për të gjithë punonjësit, kontrata e të cilëve përfundoi në maj, qershor dhe korrik dhe më pas u zgjat deri në gusht dhe shtator.</p>
<b>Implikimet fiskale</b>	<b>Shpenzime shtesë për sektorin shëndetësor</b>	<p>Shpenzimet shtesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 për qind rritje e pagave për sektorin e kujdesit shëndetësor publik (13 miliardë RSD).</li> <li>- Shpenzime më të mëdha për kujdesin shëndetësor (rreth 26 miliardë RSD edhe pse kohët e fundit shifra e raportuar është më e lartë dhe kap vlerën e 60 miliardë RSD).</li> </ul> <p>Në total: të paktën 1.3% të PBB-së.</p>
	<b>Shpenzime shtesë për sektorin jo shëndetësor</b>	<p>Shpenzimet shtesë:</p> <p>Subvencionet e pagave (93 miliardë RSD):</p> <p>(i) Pagesa e 3 pagave minimale për të gjithë punonjësit në NVM dhe sipërmarrësit (rreth 900,000 punonjës)</p> <p>(ii) Pagesa e 50 përqind të pagave minimale për ndërmarrjet e mëdha për punonjësit që nuk janë duke punuar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pagesa e njëhershme për të gjithë pensionistët (7 miliardë RSD)</li> <li>- Kredi të reja për NVM-të nga Fondi i Zhvillimit (24 miliardë RSD)</li> <li>- Transferimi universal i parave prej 100 EUR për çdo qytetar mbi 18 vjeç (rreth 70 miliardë RSD)</li> <li>- Mbështetje për 14,000 gratë më të rrezikuara në 50 komuna në të gjithë Serbinë (12 miliardë RSD) me pako me produkte higjienike dhe ushqime të domosdoshme.</li> </ul> <p>Në total: 4.3% e PBB-së</p>
	<b>Shpenzimet e përshpejtuara dhe të ardhurat e shtyra</b>	<p>Shtyrja e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore (121 miliardë RSD ose 2.2 përqind e PBB-së), të cilat do të shlyhen me 24 kështe duke filluar nga viti 2021:</p> <p>(i) Shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore për të gjitha ndërmarrjet private për tre muaj, pa asnjë interes; (ii) Shtyrja e pagesës së tatimit mbi të ardhurat e korporatave për TM2; dhe (iii) Grantet dhe donacionet e përjashtuara nga pagesa e TVSH-së.</p> <p>Shtyrja e kontributeve të sigurimeve shoqërore për të gjitha ndërmarrjet private u zgjat edhe për një muaj tjetër (30 miliardë RSD).</p> <p>Në total 2.8% të PBB-së.</p>
	<b>Detyrimet kontingjente: Garancitë (për huatë, depozitat etj.) dhe operacionet quasi fiskale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Skema e garancisë shtetërore për kreditë bankare për NVM-të (ekspozim prej 56.5 miliardë RSD). 1% e PBB-së</li> <li>- 200 milion EUR (0.4 përqind e PBB) hua të subvencionuara (1 përqind normë interesi) për NVM-të nga Fondi i Zhvillimit.</li> </ul>



## Ukraina

<b>Situata e COVID-19</b>	Karantina në të gjithë Ukrainën u vendos nga data 12 mars 2020 deri më 22 maj 2020. Më pas hyri në fuqi karantina adaptive e cila filloi më 22 maj 2020 dhe zgjati deri me datë 31 korrik 2020.	
<b>Sigurimet shoqërore</b>	<b>Leja e pushimit mjekësor me pagesë, leja e pushimit për kujdesin ndaj fëmijëve, leja e lindjes</b>	<p>Lista e rasteve të sigurimit për pagesën e aftësisë së kufizuar të përkohshme është zgjatur. Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e marrjes së kompensimit (pagesë për aftësinë e kufizuar të përkohshme) për fitimet e humbura nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore për periudhën e qëndrimit në institucionet e kujdesit shëndetësor, si dhe në vetë-izolim nën mbikëqyrje mjekësore. Shuma e pagesës për aftësinë e kufizuar të përkohshme është në masën 50% të pagës mesatare, pavarësisht nga kohëzgjatja e shërbimit (numri i parashikuar i përfituesve 5.8 milion).</p> <p>Për punëtorët mjekësorë Fondi kompenson fitimet e humbura gjatë izolimit për shkak të COVID-19 në masën 100% të pagës mesatare.</p> <p>Nga data 17 qershor 2020, pagesat e sigurimeve në rast sëmundjeje ose vdekjeje të punonjësve mjekësorë për shkak të COVID-19 ofrohen nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore dhe financohen nga buxheti i shtetit.</p>
	<b>Pensionet</b>	Një ndihmë mujore pensionale prej 500 UAH (19 dollarë) u ofrua për 1.5 milion pensionistë të moshës 80 vjeç e lart dhe për ata persona pensioni i të cilëve nuk i kalon 9,205 UAH (341 \$).
	<b>Pagesat e papunësisë</b>	<p>Pagesat e papunësisë paguhen pa patur nevojë për të shkuar në qendrën e punësimit që nga dita e parë pas regjistrimit. Shuma minimale e pagesës së papunësisë për periudhën e karantinës është rritur nga 650 UAH (24 \$) në 1000 UAH (37 \$) në muaj.</p> <p>Për punëdhënësit e ndërmarryeve të vogla dhe të mesme që kanë ndërprerë ose kanë reduktuar aktivitetin e tyre për shkak të karantinës u ofrua një pagesë e pjesshme papunësie. Pagesa e pjesshme e papunësisë përcaktohet mbi bazën e çdo ore pune të reduktuar për punonjësit. Ajo kap vlerën e dy të tretave të shumës së paguar për orë pune, por jo më shumë se paga minimale (175 dollarë). Pagesa e pjesshme e papunësisë do të ofrohet për periudhën e karantinës, si dhe për 30 ditët pas përfundimit të saj.</p>
	<b>Kontributet e sigurimeve shoqërore</b>	Në harkun kohor 1 mars deri më 31 maj 2020 sipërmarrësit individualë, personat që ndjekin një veprimtari të pavarur profesionale dhe fermerët u përjashtuan nga pagesa e taksës së vetme shoqërore për veten e tyre. Për personat e vetëpunësuar të cilët u përjashtuan nga pagesa e kontributit të vetëm për muajt mars, prill dhe maj, periudha të tilla do të përfshihen në periudhën e sigurimit për qëllime pensioni dhe do të konsiderohen si shuma sigurimi të paguara në masën e kontributit minimal të sigurimit.
<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Transfertat e rregullta të parave</b>	<p>Qeveria vendosi të ofronte një pagesë për të mbështetur fëmijët e sipërmarrësve individualë që i përkasin grupit të parë dhe të dytë të taksapaguesve të vetëm për periudhën e karantinës dhe për një muaj pas datës së heqjes së saj. Nga kjo ndihmë sociale pritet të përfitojnë rreth 300,000 familje. Ajo do të ofrohet për çdo fëmijë deri në moshën 10 vjeç në shumën e minimumit të jetesës (për fëmijët nën 6 vjeç - 1.779 UAH (66 dollarë); për fëmijët e moshës 6 deri në 10 vjeç 2.218 UAH (82 dollarë)).</p> <p>Qeveria ka zgjeruar programin e mbështetjes sociale për njerëzit me të ardhura të ulëta që kanë humbur vendet e punës gjatë karantinës. Rreth 100,000 qytetarë do të marrin një ndihmë të tillë sociale. Shuma mesatare mujore e ndihmës për familjet me të ardhura të ulëta me fëmijë të mitur do të variojë nga 2,800 UAH (104 \$) në 3,020 UAH (112 \$).</p>
	<b>Transfertat e njëhershme në para</b>	Qeveria ofroi një ndihmë të njëhershme në para prej 1.000 UAH (37 \$) për 10 milion pensionistë që kanë një pension deri në 5000 UAH (185 \$) dhe rreth 600,000 përfitues të ndihmës sociale shtetërore si: personat me aftësi të kufizuara që nga fëmijëria dhe fëmijët me aftësi të kufizuara; personat që nuk kanë të drejtë pensioni dhe personat me aftësi të kufizuara; personat që kanë mbushur moshën e pensionit, por nuk kanë të drejtë pensioni.

<b>Ndihma Sociale</b>	<b>Pagesat për strehimin, kuponat ushqimorë, të tjera</b>	<p>Masa e subvencionimit të strehimit është intensifikuar gjatë periudhës së karantinës. Ajo siguron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndalimin e ndërprerjes së sigurimit të subvencioneve të caktuara të strehimit, përveç rasteve kur është e pamundur të sigurohen subvencione për strehimin (transferimi i një familje në një banesë tjetër ose vdekja e një personi të vetëm);</li> <li>- marrjen e masave shtesë sa i takon mbrojtjes sociale të punëtorëve që janë pushuar nga puna për shkak të karantinës (duke marrë parasysh të ardhurat e tyre nga pagesa e papunësisë kur caktohet një subvencion për strehimin në vend të pagës që kanë marrë në punën e tyre të mëparshme); dhe</li> <li>- ofrimin e kompensimit shtesë për kostot e disa shërbimeve të strehimit për përfituesit e subvencioneve të strehimit duke rritur me 50% standardet sociale për energji elektrike, gaz natyror për gatim dhe për ngrohjen e ujit, ujë të ftohtë dhe të nxehtë, sistemin e shkarkimit për shkak të qëndrimit të përhershëm të detyruar në shtëpi dhe rritjen e konsumit të shërbimeve përkatëse.</li> </ul> <p>Nga data 3 deri më 23 prill 2020 filloi zbatimi i një projekti bamirësie i cili synonte ofrimin e ndihmës për grupet e cënueshme në aspektin social. Ministria e Politikave Sociale, së bashku me Rrjetin Kombëtar të Dyqaneve Ushqimore, ka filluar ofrimin e paketave ushqimore për personat e vetëm dhe njerëzit që jetojnë vetëm, të moshës mbi 80 vjeç, të moshuarit që kanë nevojë për përkujdesje dhe personat me aftësi të kufizuara.</p>
	<b>Punët publike</b>	U krijua një platformë informacioni " <i>Dopomoga Poruch</i> " ("Ndihma është afër") ( <a href="https://dopomoga.msp.gov.ua/">https://dopomoga.msp.gov.ua/</a> ) për përfshirjen e organizatave bamirëse, joqeveritare, bizneseve dhe vullnetarëve për të ndihmuar të moshuarit që jetojnë vetëm, personat me aftësi të kufizuara, familjet me fëmijë, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.
	<b>Shtyrja e pagesës së shërbimeve komunale</b>	Vendimi i qeverisë, datë 22 prill 2020, e zgjati afatin për pagesat e prapambetura për shërbimet e strehimit dhe ato komunale nga dy në tre muaj për përfituesit e subvencioneve dhe përfitimeve për strehimin.
<b>Tregu i punës</b>	<b>Rregullimi i tregut të punës</b>	<p>Nuk lejohet të pushohen nga puna punonjësit që punojnë nga shtëpia dhe punonjësit që janë me leje pa pagesë për periudhën e karantinës.</p> <p>Koha e pushimit jo për faj të punonjësit për periudhën e karantinës paguhet jo më pak se dy të tretat e normës tarifore nga paga e përcaktuar e punonjësit.</p>
	<b>Orët e reduktuar të punës / përdorimi i lejes së pushimit</b>	Puna me kohë të pjesshme (me kohë të pjesshme ose javore) lejohet sipas Kodit të Punës të Ukrainës, por vetëm në bazë të aplikimit të punonjësit. Puna me kohë të pjesshme për periudhën e karantinës nuk sjell ndonjë kufizim në fushën e të drejtave të punës së punonjësve.
	<b>Puna nga shtëpia</b>	Është rekomanduar sigurimi i punës me turne për punonjësit, (përfshirë punonjësit e institucioneve qeveritare), dhe/ ose ofrimi i mundësisë për të punuar në distancë në kohë reale përmes internetit. Në Kodin e Punës të Ukrainës u përfshi për herë të parë edhe koncepti i punës në distancë.
	<b>Subvencionimi i pagave</b>	<p>Pagesa shtesë mbi pagat për punonjësit mjekësorë dhe punonjësit e tjerë të përfshirë drejtpërdrejt në eliminimin e COVID-19 në masën 300% të pagave për periudhën e karantinës.</p> <p>Pagesa shtesë mbi pagat për punonjësit e mbrojtjes sociale që ofrojnë drejtpërdrejt shërbime sociale në vendbanimin / vendqëndrimin e përfituesit të shërbimeve sociale (në shtëpi), deri në masën 100% të pagave gjatë periudhës së zbatimit të masave që synojnë parandalimin e COVID-19.</p>
<b>Implikimet fiskale</b>		<p>Shpenzime shtesë për sektorin shëndetësor: 0.9% e PBB-së.</p> <p>Shpenzime shtesë për sektorin jo shëndetësor: 2.5% e PBB-së.</p>



Që nga shpërthimi i saj në fillim të vitit 2020, pandemia COVID-19 ka ndikuar thellësisht në botën e punës. Si përgjigje ndaj saj, shtetet e ndryshme kanë kryer ndërhyrje të menjëhershme në sistemin shëndetësor publik dhe kanë marrë masa me karakter ekonomik për të stimuluar ekonominë.

Ky raport bën një rishikim në mënyrë krahasimore i masave të marra në rang kombëtar sa i takon sigurimeve shoqërore si përgjigje ndaj krizës së shkaktuar nga COVID-19, analizimin e efektivitetit të tyre dhe i pasojave afatgjata, si dhe diskutimi në lidhje me sfidat e ardhshme për përmirësimin e sistemit të sigurimeve shoqërore. Ky raport përfshin shtatë vende në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Lindore: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Moldavinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Ukrainën.

[ilo.org/budapest](https://ilo.org/budapest)

Zyra Qëndrore e ILO për Evropën Lindore dhe  
Qëndrore  
14 Mozsár utca  
H-1066 Budapest  
Hungary